

Vendim nr. 57, datë 25.05.2026
(V- 57/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Asim Vokshi, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 20.05.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 37 (E) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ERION VELIAJ**

SUBJEKT I INTERESUAR:

**PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**, përfaqësuar nga prokurorët
Altin Dumani dhe Ols Dado, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 7, datë 09.02.2025 të Gjykatës së
Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e
Organizuar, vleftësuar përmes vendimit nr. 14, datë 12.02.2025
të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin
dhe Krimin e Organizuar; nr. 13, datë 13.03.2025 të Gjykatës së
Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
nr. 00-2025-1153 (176), datë 08.07.2025 të Kolegjit Penal të
Gjykatës së Lartë.
Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të subjektit të interesuar.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 17, 33, 35, 42, 49, 57 dhe 145 të Kushtetutës së
Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); nenet 5 dhe 6 të
Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr.
8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e**

**Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
(Ligji Organik i Gjykatës).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Asim Vokshi, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit Erion Veliaj (*kërkuari*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari Erion Veliaj është zgjedhur kryetar i Bashkisë së Tiranës për herë të parë në zgjedhjet për qeverisjen vendore të vitit 2015. Ai është rizgjedhur në të njëjtën detyrë edhe dy herë të tjera në zgjedhjet vendore të viteve 2019 dhe 2023. Kërkuari ka kandiduar dhe është zgjedhur si përfaqësues i subjektit politik të shumicës qeverisëse, Partisë Socialiste.

2. Në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), një shtetas i vetidentifikuar si N.A. ka paraqitur një akt në formën e një kallëzimi penal me shkrim, në të cilin referoheshin disa fakte komprometuese për shtetasin E.V., kryetar i Bashkisë së Tiranës. Të dhënat e përmendura në këtë akt janë verifikuar nga hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit (*BKH*), të cilët, në vijim, i kanë përcjellë Prokurorisë së Posaçme një informacion/material për referimin e veprës penale. Mbi bazën e këtij materiali referues, në datën 08.02.2024 Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 27 (*procedimi penal nr. 27/2024*) për veprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal (*KP*).

3. Pas hetimeve të kryera, Prokuroria e Posaçme ka pretenduar se provat e grumbulluara krijojnë dyshimin e arsyeshëm se fondet publike të dala nga institucioni i Bashkisë së Tiranës me nënshkrimin e titullarit të tij (kërkuarit): i) kanë kaluar drejtpërdrejt te bashkëshortja e tij dhe rrethi i saj familjar; ii) kanë kaluar nëpërmjet sponsorizimeve dhe huapërdorjes pa kundërshpërblim të pasurive të paluajtshme në zona të shtrenjta të kryeqytetit, prej subjekteve tregtare, të cilat, nga

ana e tyre, kanë përfituar fonde publike nga Bashkia e Tiranës, tek bashkëshortja e kërkuesit, organizata jofitimprurëse (*OJF*), shoqëri me përgjegjësi të kufizuara dhe persona fizikë të kontrolluar prej saj; iii) kanë kaluar si pasuri të paluajtshme në vlerë të konsiderueshme, të dhëna si përfitim i parregullt nga persona konkretë, të cilët zotërojnë dhe administrojnë subjekte tregtare të lidhura ngushtë me Bashkinë e Tiranës nëpërmjet përfitimit të fondeve publike, si edhe lejeve të ndërtimit, tek familja e kryetarit të saj; iv) janë shpenzuar për blerje me vlera të mëdha nga familjarë të kryetarit të Bashkisë së Tiranës, duke u kamufluar këto blerje përmes personave të tjerë. Po sipas Prokurorisë së Posaçme, faktet dhe provat krijojnë dyshimin e arsyeshëm se bëhet fjalë për një sistem të organizuar korrupsioni dhe shpërdorimi të fondeve publike, të udhëhequr nga kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe bashkëshortja e tij dhe se në qendër të kësaj skeme korrupsioni dhe pastrimi të produkteve që burojnë nga kjo veprë, dyshohet se është kërkuesi, nënshkrimi i të cilit ka qenë përcaktues për shpërndarjen e fondeve publike, prej të cilave ai dhe familjarët e ngushtë të tij dyshohet se kanë përfituar drejtpërsëdrejti në mënyrë të parregullt.

4. Në datën 27.12.2024, pasi janë konstatuar elemente që lidhen edhe me vepra të tjera penale, në regjistrin e njoftimit të veprave penale janë shënuar edhe veprat penale sipas neneve 245, 287, paragrafi i dytë dhe 257/a, paragrafi i dytë, të KP-së dhe në vijim, në datat 16.01.2025 dhe 24.01.2025, edhe veprat penale të parashikuara nga nenet 305/b dhe 301 të KP-së.

5. Në datën 24.01.2025 Prokuroria e Posaçme ka regjistruar në regjistrin e njoftimeve të veprave penale emrin e kërkuesit, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, të parashikuara përkatësisht nga nenet 260 e 25 dhe 287, paragrafi i dytë, të KP-së. Po në atë datë, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit.

6. Me vendimin nr. 7 akti, datë 09.02.2025 (*vendimi nr. 7/2025*), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), si i dyshuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 260 e 25 dhe 287, paragrafi i dytë, të KP-së. Sipas asaj gjykate, nga të dhënat konkrete të grumbulluara deri në këtë fazë të hetimit paraprak, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se kërkuesi

ka kryer veprat penale për të cilat është proceduar penalisht. Kërkuesi dhe bashkëshortja e tij dyshohen se kanë kryer në bashkëpunim veprime të kundërligjshme që konsistojnë në marrjen e përfitimeve të parregullta në disa episode të veçanta, në formë shumash monetare dhe pasurish të paluajtshme nga shtetas ose subjekte tregtare, të cilat kanë pasur interesa të drejtpërdrejta financiarë në Bashkinë e Tiranës.

7. Më konkretisht, dyshohet se kërkuesi dhe bashkëshortja e tij kanë përfituar: pasurinë e paluajtshme vilë e ndodhur në Qerret nga shoqëria “A” sh.p.k. (me administrator personin nën hetim G.S.), e cila ka përfituar fonde publike pasi është shpallur fituese në procedura prokurimi ku kërkuesi ka qenë titullar i autoritetit kontraktor, pasuri që dyshohet të jetë fshehur dhe të mos jetë deklaruar në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit; shpenzimet e udhëtimit jashtë shtetit në muajin dhjetor 2016 dhe disa sponsorizime për eventet e organizuara nga një OJF që dyshohet se kontrollohet nga bashkëshortja e kërkuesit, të financuar prej shoqërisë “K.” sh.p.k. (me administrator personin nën hetim F.B.), e cila ka përfituar disa leje ndërtimi nga Bashkia e Tiranës; përfitimet e shumave monetare nga shoqëria “F.” sh.p.k. (me administrator personin nën hetim Sh.F.), e cila ka përfituar disa leje ndërtimi nga Bashkia e Tiranës dhe është shpallur edhe fituese e disa procedurave të prokurimit publik, përmes një OJF-je që dyshohet se kontrollohet nga bashkëshortja e kërkuesit, shuma që janë faturuar fillimisht si shërbime konsulence ligjore për dy persona fizikë, pjesë e shoqërisë me administratore bashkëshorten e kërkuesit; financimet e OJF-ve që dyshohet se kontrollohen *de facto* nga bashkëshortja e kërkuesit, për organizimin e eventeve të ndryshme, nga shoqëria “P.” sh.p.k. (me përfaqësues personin nën hetim M.P.), e cila ka marrë leje ndërtimi nga Bashkia e Tiranës; përfitime financiare përmes blerjeve të disa veprave të artit nga një shoqëri që dyshohet se kontrollohet nga bashkëshortja e kërkuesit, me diferencë nga çmimi i blerjes fillestare të tyre, nga shoqëria “G.” sh.p.k. (me administrator personin nën hetim S.K.), e cila ka fituar disa procedura prokurimi të zhvilluara nga entet në varësi të Bashkisë së Tiranës dhe ka marrë edhe leje ndërtimi nga kjo e fundit. Skema e përfitimeve në formën e sponsorizimit të eventeve artistike është dyshuar se ka pasur në bazë të saj jo vetëm krijimin e një numri të konsiderueshëm OJF-sh, disa nga familjarë të bashkëshortes së kërkuesit, dhe shoqërisht tregtare, si dhe shfrytëzimin e tyre, por edhe marrjen e përfitimeve të parregullta nga subjekte tregtare që operojnë në mënyrë të pavarur në treg.

Sipas gjykatës, të ardhurat e gjeneruara dyshohet se janë në vlerën prej rreth 110.000.000 lekë, çka tregon për një rrezikshmëri të theksuar të shfaqjes së veprës penale në rastin konkret.

8. Masa e sigurimit është ekzekutuar në datën 10.02.2025. Pas kësaj, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar gjykatës me kërkesë për marrjen në pyetje të kërkuesit dhe verifikimin e kushteve e të kritereve të zbatimit të masës së sigurimit. Me vendimin nr. 14, datë 12.02.2025 (*vendimi nr. 14/2025*), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në burg” për kërkuesin të caktuar me vendimin nr. 7/2025 të po asaj gjykate, duke vlerësuar se nuk janë zbutur nevojat e sigurimit, pasi rrethanat e faktit nuk kanë ndryshuar për sa kohë gjykata ndodhej përpara të njëjtave veprime, sjellje dhe fakte të cilat janë vlerësuar njëherë prej saj. Sipas asaj gjykate, ekziston rreziku i marrjes ose vërtetësisë së provës nëse kërkuesi vijon të mos i nënshtrohet kufizimit të lirisë, i cili është real dhe i vazhdueshëm, duke pasur në konsideratë: ambientin ku ai jeton; funksionin publik që ushtron; njohjet e shumta; lidhjet dhe ndikimin e fortë nga ushtrimi i funksionit, rëndësi që shtohet nisur nga territori që mbulon dhe fondet publike që administrojnë Bashkia e Tiranës; sjelljen e shfaqur nga kërkuesi, i cili u ka dërguar mesazhe me natyrë intimiduese hetuesve të BKH-së, ku u kërkon të ndalojnë me thirrjen e bashkëshortes së tij për të dhënë deklaratime; praninë e një prej vartësve të kërkuesit gjatë takimeve të bashkëshortes me personat e thirrur nga organi procedues dhe gjatë kontrollit të ushtruar nga hetuesit e BKH-së; sjelljen e bashkëshortes së kërkuesit veçanërisht pas kontrolleve të ushtruara sipas vendimit të GJKKO-së të Shkallës së Parë. Në vlerësimin e saj, nëse kërkuesi do të lihej pa masë sigurimi ai mund të largohej për të pamundësuar ose penguar qëllimisht zhvillimin normal të procedimit penal, duke pasur parasysh pasojat e veprës dhe marzhin e dënimit të veprave penale që ai dyshohet se ka konsumuar. Po kështu, ajo gjykatë ka vlerësuar se, duke mbajtur në konsideratë mekanizmin që kërkuesi dyshohet se ka ideuar së bashku me bashkëshorten, i vënë në funksion dhe zbatuar për një kohë të gjatë, sa më tepër të qëndrojë i lirë, aq më i madh është rreziku që të kryejë krime të rënda, të të njëjtit lloj me ato për të cilat po procedohet. Ajo gjykatë ka mbajtur parasysh faktin se kërkuesi vijon të ushtrojë funksione publike dhe ekziston rreziku që ai të abuzojë me detyrën, sikundër edhe pasojat që kanë ardhur në rastin konkret, që kanë të bëjnë me gjenerimin e të ardhurave që dyshohet se vijnë nga burime të paligjshme. Kundër vendimeve të mësipërme ka paraqitur ankim edhe kërkuesi.

9. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 13(87-2025-85), datë 13.03.2025, ka miratuar vendimin nr. 7/2025 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, i verifikuar me vendimin nr. 14/2025 të po asaj gjykate, me cilin është caktuar ndaj kërkuesit masa e sigurimit personal “Arresti në burg”. Sipas asaj gjykate, ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova se kërkuesi ka konsumuar veprat penale që i janë atribuar, pasi, nga të dhënat e grumbulluara në raport me hetimet e kryera deri në atë moment të procedimit, evidentohet se në të paktën nëntë raste, me veprimet e tij, ka konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 260 i KP-së, në bashkëpunim me bashkëshorten, shtetasen A.X., si dhe të veprës penale të parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë, i KP-së në më shumë se një rast, në bashkëpunim me personat e tjerë nën hetim. Ajo gjykatë ka gjetur të drejtë vlerësimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë se asnjë masë tjetër sigurimi nuk do të ishte e përshtatshme për të garantuar nevojat e sigurimit, duke vlerësuar se: kërkuesi dyshohet të ketë konsumuar dy vepra penale, të dyja me rrezikshmëri të lartë shoqërore, ku vepra e parë penale dyshohet se është konsumuar në prani të dy rrethanave rënduese; ai paraqet rrezikshmëri të theksuar shoqërore, duke iu referuar edhe sjelljes së tij pas zbatimit të vendimeve për caktimin e masës, që ka qenë kërcënuese dhe intimiduese ndaj gjykatës dhe prokurorisë; ekzistojnë të tria kushtet e veçanta të nenit 228, pika 3, të KPP-së për caktimin e masës më të rëndë të sigurimit, që janë rreziku i helmimit të provave, rreziku i ikjes, si dhe ai i kryerjes së veprave penale të të njëjtit lloj me atë për të cilën po procedohet. Po sipas asaj gjykate, masa e sigurimit “Garancia pasurore”, sipas nenit 236 të KPP-së, është e papërshtatshme, pasi nuk kënaq shkallën e nevojave të sigurimit, si dhe nuk përputhet me natyrën e veprave që dyshohet të ketë kryer kërkuesi.

10. GJKKO-ja e Apelit ka gjetur të pabazuara edhe shkaqet e ngritura në ankim, të cilat kanë të bëjnë me: fillimin e procedimit penal mbi një kallëzim anonim; se çdo e dhënë e siguruar përtej afatit 15-ditor për regjistrimin e procedimit penal nuk mund të shërbejë si element prove; regjistrimin e emrit të kërkuesit si person të cilit i atribuohet vepra penale rreth 11 muaj pas regjistrimit të procedimit penal, çka ka cenuar të drejtën për t’u mbrojtur dhe i ka dhënë organit të akuzës afate hetimore në mënyrë të padrejtë, duke e vendosur kërkuesin në kushte të disfavorshme; cenimin e së drejtës së mbrojtjes nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, pasi nuk i ka dhënë kohën e mjaftueshme për t’u njohur me volumet hetimore gjatë seancës për marrjen në pyetje, në kundërshtim me nenin 248 të KPP-së; depozitimin e vendimit të gjykatës tej afatit 48-orësh sipas

nenit 248, pika 2, të KPP-së, duke i mohuar mundësinë e kundërshtimit të vendimit në një gjykatë më të lartë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs edhe kërkuesi.

11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1153(176), datë 08.07.2025, në dhomën e këshillimit, bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja “e”, të KPP-së, ka lënë në fuqi vendimin e GJKKO-së së Apelit, duke vlerësuar se ai është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit penal (material dhe procedural). Sipas atij kolegji, gjykata e apelit ka argumentuar mjaftueshëm si në lidhje me ekzistencën e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta për caktimin e masës së sigurimit, ashtu edhe në lidhje me përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e llojit të masës, duke analizuar dhe mbajtur në konsideratë kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal, në raport me rrethanat e faktit dhe provat e marra deri në këtë fazë të hetimit; pasojat e ardhura që dyshohet të kenë një shtrirje të gjatë kohore; rrezikshmërinë e kërkuetit, i cili dyshohet t'i ketë kryer veprat penale duke shpërdoruar funksionin publik; rrezikshmërinë e veprave penale për të cilat ai është proceduar; vendin dhe rrethanat në të cilat dyshohet se janë kryer faktet penale; rrethanat lidhur me natyrën, llojin, mjetet, kohën, vendin e mënyrën e kryerjes së veprave penale; shkallën e dyshuar të fajësisë dhe motivet; rrethanat e tjera individuale, familjare e sociale të kërkuetit. Sipas atij kolegji, gjykatat kanë argumentuar se ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se lënia e lirë e kërkuetit mund të vërë në rrezik marrjen e provave ose të ndikojë në vërtetësinë e provave të tjera, veçanërisht përmes ndikimit mbi dëshmitarët ose personat e tjerë bashkëpunëtorë në kryerjen e veprimtarive të cilësuar të kundërligjshme, fakt që lidhet edhe me rrezikun potencial për të kryer një vepër tjetër penale. Në rastin konkret, sipas Kolegjit Penal, verifikohet të paktën rreziku i ndikimit mbi vërtetësinë e marrjes së provave, ku nga aktet e përfshira në fashikullin përkatës konstatohen përpjekjet e vazhdueshme të kërkuetit për të ndikuar mbi dëshmitarët dhe për të dëmtuar provat, fakte që me të drejtë janë analizuar nga gjykata e apelit për të verifikuar kushtet e veçanta të caktimit të masës së sigurimit, e cila vlerësohet e përshtatshme dhe proporcionale në raport me nevojat e sigurimit.

12. Lidhur me pretendimin se GJKKO-ja e Apelit, në shkelje të përcaktimeve të nenit 425, pikat 1 dhe 3, të KPP-së, ka dhënë mendim se bashkëpunimi mes kërkuetit dhe të hetuarve A.X. dhe E.A. ka tiparet e një bashkëpunimi të posaçëm, të grupit të strukturuar kriminal, sipas Kolegjit Penal pabazueshmëria e këtij pretendimi merr përgjigje në vendimin e po kësaj gjykate, pasi vlerësimi i shfaqur në formën e një “bindjeje” nuk është konsideruar dhe nuk ka ndikuar në

rëndimin e situatës procedurale të kërkuarit për caktimin e llojit të masës së sigurimit. Kolegji Penal ka vlerësuar se gjykatat e faktit kanë respektuar nenin 248 të KPP-së, duke garantuar të drejtën e kërkuarit për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur arsyet e kundërshtitë e tij, si dhe kontradiktoritetin edhe në këtë fazë të procedimit penal. Sipas atij kolegji, në marrjen në pyetje janë verifikuar kushtet e kriteret e parashikuara në nenet 228 dhe 229 të KPP-së. Kolegji Penal ka gjetur të pabazuara edhe pretendimet për: pabazueshmërinë/paprovueshmërinë e akuzës dhe moskzistencën e “dyshimit të arsyeshem”; cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive, për shkak të mosdhënies së kohës së mjaftueshme për t'u njohur me dosjen hetimore; cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe të *reformatio in peius*; marrjen nga gjykata e apelit të provave të paraqitura rishtazi nga prokurorët e çështjes; mënyrën sesi është regjistruar procedimi penal e lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur gjatë hetimeve paraprake; unifikimin e praktikës gjyqësore nga Gjykata e Lartë; standardin e arsyesimit nga gjykatat e zakonshme lidhur me parimet e proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë së masës së sigurimit personal; mënyrën e trajtimit nga gjykatat e zakonshme të pretendimeve të ngritura përpara tyre.

13. Rezulton, gjithashtu, se mbi propozimin e këshillit bashkiak, me vendimin nr. 539, datë 25.09.2025 Këshilli i Ministrave (*VKM nr. 539/2025*) ka vendosur shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë së Tiranës, zotit Erion Veliaj (kërkuarit) për shkak të mosparaqitjes së tij në detyrë. Pas njoftimit nga Këshilli i Ministrave për krijimin e vakancave për kryetarë në gjashtë bashki të vendit, përfshirë Bashkinë e Tiranës, Presidenti i Republikës ka nxjerrë dekretin nr. 350, datë 01.10.2025 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”. Në datat 29.09.2025 dhe 02.10.2025 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit për shkarkimin e tij nga detyra, ashtu edhe të dekretit për caktimin e zgjedhjeve për Bashkinë e Tiranës. Me vendimin nr. 66, datë 03.11.2025 (*vendimi nr. 66/2025*), Gjykata ka vendosur shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën, të VKM-së nr. 539/2025 dhe të dekretit të Presidentit të Republikës për pjesën që ka caktuar datën e zgjedhjeve vendore në Bashkinë e Tiranës.

14. Në datën 21.11.2025 kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore që kanë caktuar ndaj tij masën e sigurimit personal “Arresti në burg”, i cili është regjistruar në datën 25.11.2025. Në datën 11.12.2025 kërkuari ka paraqitur kërkesë për përsheptimin e gjykimit, duke parashtruar se vijimi i paraburgimit bie ndesh

me vetë efektet e vendimit nr. 66/2025 të Gjykatës, pasi funksioni i kryetarit të bashkisë nuk mund të ushtrohet nga ambientet e paraburgimit dhe humbja e ditëve të mandatit është e pariparueshme, si dhe se dëmtohet besimi i publikut e parimi i stabilitetit të institucioneve vendore.

15. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 13.01.2026 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 26.01.2026, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, si dhe pranimin e kërkesës së kërkuarit për përsheptimin e gjykimit.

16. Me vendimin nr. 118, datë 01.02.2026, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” të caktuar ndaj tij, me një masë më të lehtë, si të pambështetur në ligj e në prova. Kjo çështje, referuar të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, është regjistruar në datën 06.05.2026 mbi rekursin e kërkuarit dhe deri në kohën e marrjes së këtij vendimi ishte në pritje për t’u shqyrtuar nga ajo gjykatë.

17. Me vendimin nr. 141, datë 09.02.2026, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme duke dërguar për gjykim procedimin penal nr. 27/2024, me të pandehur edhe kërkuarin, të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 260 e 25 të KP-së, në bashkëpunim, më shumë se një herë, 287, paragrafi i dytë, të KP-së, në bashkëpunim, më shumë se një herë, 324/a, paragrafi i dytë, të KP-së, më shumë se një herë, 257/a, paragrafi i dytë dhe 248 të KP-së.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

18. **Kërkuari**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i është cenuar:

18.1. *Liria personale*, sipas neneve 27 dhe 28 të Kushtetutës dhe 5 të KEDNJ-së, në drejtim të:

18.1.1. *Mosrespektimit të parimit të proporcionalitetit* në caktimin e masës kufizuese të lirisë, duke pasur parasysh se ndikimi në këtë rast është i dyfishtë, pasi, nga njëra anë, prek të drejtat individuale të kërkuarit dhe, nga ana tjetër, ndikon edhe në të drejtat e zgjedhësve. Në kuptim të kushteve, kritereve dhe nevojave të sigurimit, në raport me nevojat konkrete për mbarëvajtjen e procedimit penal, masa më

proporcionale do të ishte “Garancia pasurore”, pasi ajo përmbushte qëllimin e synuar. Gjykatat nuk kanë analizuar masën në raport me të drejtën për t’u zgjedhur, sipas nenit 45 të Kushtetutës, pasi masa e kundërshtuar e pengon kërkuesin në ushtrimin e funksionit të besuar nga qytetarët e Tiranës, si dhe bie ndesh me *parimin e autonomisë vendore* e të drejtën e qytetarëve për t’u qeverisur. Kërkuesi ka më shumë se një vit që pengohet në ushtrimin e detyrës publike, duke sjellë masa pasojat e shkarkimit dhe pezullimit *de facto*, ndërkohë që gjykatat nuk kanë arritur të tregojnë se çfarë prove konkrete rrezikohet, si mund të ndërhyhet mbi të, kush do të urdhërohej nga kërkuesi dhe as përmes cilës hallkë administrative. Në situatën kur vendimi nr. 66/2025 i Gjykatës ka afirmuar mandatin e kërkuesit si kryetar i bashkisë, masa ka prodhuar efektet e një shkarkimi *de facto*, duke bllokuar funksionimin e një organi që duhet të jetë aktiv dhe efektiv deri në fund të mandatit. Nga ana tjetër, pezullimi *de facto* në ushtrimin e detyrës ka sjellë impakt në menaxhimin e qytetit dhe ka vështirësuar jetën e banorëve, ndërhyrje që shkon përtej qëllimit të procedimit penal dhe prek thelbin e përfaqësimit politik, duke deformuar raportin midis pushtetit gjyqësor dhe atij vendor, për sa kohë nuk ka një vendim të formës së prerë që ndalon ushtrimin e funksionit nga kërkuesi. Në kuptim të nenit 242 të KPP-së, masa e sigurimit që cenon aftësinë për të ushtruar mandatin është e ndaluar për funksionarët e zgjedhur, pasi shkel proporcionalitetin, dëmton vazhdimësinë e demokracisë vendore dhe cenon vetë sovranitetin e popullit. Edhe në drejtim të *lirisë së lëvizjes dhe së drejtës për t’u zgjedhur* nuk janë analizuar kriteret për caktimin e masës sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së në raport me nevojat konkrete për mbarëvajtjen e procedimit penal. Referuar prapësimeve të Prokurorisë së Posaçme, për sa kohë kërkuesi vijon të jetë kryetar i bashkisë paraburgimi duhet të vazhdojë për të neutralizuar funksionin e tij publik. Po sipas Prokurorisë së Posaçme, vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq përbën provë të ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm, ndërkohë që ai vendim nuk përbën verifikim të bazueshmërisë së akuzës dhe ekzistencës së fajësisë.

18.2. *E drejta për proces të rregullt*, sipas neneve 42 të Kushtetutës dhe 6 të KEDNJ-së, në drejtim të:

18.2.1. *Së drejtës për mbrojtje efektive*, pasi pas ekzekutimit të vendimit nr. 7/2025 mbrojtjes iu vu në dispozicion kopja e tij prej 365 faqesh, i cili përmbante detaje teknike për nëntë fakte penale në ngarkim të të hetuarve. Në datën 11.02.2025 mbrojtja paraqiti kërkesë për t'u njohur me aktet e fashikullit gjyqësor dhe në seancën e datës 12.02.2025, për verifikimin e kushteve të zbatimit të masës, mbi kërkesën e mbrojtjes, gjykata i la kohë deri në orën 13:30 për njohjen me aktet, kohë që ishte tërësisht e pamjaftueshme në raport me volumin e tyre (66 volume me afro 400 faqe secili). Me rifillimin e seancës gjyqësore (ora 13:30), mbrojtja parashtrroi se ishte njohur pjesërisht me aktet dhe se kjo mënyrë e të proceduarit i kishte pamundësuar paraqitjen e provave për faktet penale objekt hetimi. Provat e dorëzuara në seancën gjyqësore të asaj date vetëm citohen nga gjykata, por nuk analizohen dhe nuk u jepet përgjigje pretendimeve të mbrojtjes. Po kështu, qëndrimi i kërkuesit në kafaz sigurie ka kufizuar mundësinë për të komunikuar lehtësisht me mbrojtësit. Në gjykatën e apelit kërkesa e mbrojtjes për qëndrimin e kërkuesit pranë avokatit u rrëzua me justifikimin se mungonte infrastruktura e përshtatshme. Kjo ka cenuar edhe *dinjitetin e kërkuesit* për shkak të mossigurimit të kushteve dinjitoze për ushtrimin efektiv të të drejtave të tij, duke përbërë trajtim degradues e poshtëruës, por edhe sepse fotot e tij pas hekurave janë publikuar në media, çka ka dëmtuar reputacionin e kërkuesit. Po kështu, në kundërshtim me *parimin e prezumimit të pafajësisë* ekspozimi i kërkuesit në kafaz/kabinë gjatë seancave gjyqësore ka krijuar imazh negativ të tij si person i rrezikshëm dhe një perceptim të gabuar për fajësinë, duke paragjykuar vetë atë proces, për më tepër kur kërkuesi nuk është akuzuar për një vepër penale të dhunshme, ka karakter të mirë, pozitë të lartë në shoqëri etj.

18.2.2. *Parimit "reformatio in peius"*, për shkak të pranimit nga gjykata e apelit të provave të reja të kërkua nga prokuroria në seancën e datës 11.03.2025. Lejimi i paraqitjes së tyre nga pala që nuk ka paraqitur ankim bie ndesh me nenin 425,

pika 3, të KPP-së, si dhe e ka vendosur mbrojtjen në kushtet e pamjaftueshmërisë së kohës për t`u njohur me to dhe për t`u konsultuar me kërkuesin.

18.2.3. *Pavlefshmërisë së veprimeve hetimore dhe papërdorshmërisë së provave*, pasi regjistrimi i procedimit penal nr. 27/2024 është bërë mbi akte të papërdorshme, çka sjell pavlefshmërinë e të gjitha akteve pasuese (parimi i “frutit të pemës së ndaluar”). Shkeljet kanë të bëjnë me: faktin se prokuroria shpalli përfundimin e hetimeve dhe caktoi afatin 10-ditor sipas nenit 327 të KPP-së, duke vënë në dispozicion një dosje prej 160 fashikujsh me materiale voluminoze, çka e bëri të pamundur ushtrimin efektiv të mbrojtjes, ndërkohë që kërkesa për shtyrje u refuzua; regjistrimin e një kallëzimi të falsifikuar, njëfaqësh, i firmosur nga një person që nuk ekziston dhe që nuk plotëson as elementet e hipoteticitetit dhe specificitetit; faktin se prokuroria nuk ka kryer veprime hetimore për identifikimin e kallëzuesit; duke mos shënuar emrin e kërkuesit deri më 24.01.2025 prokuroria ka përfituar padrejtësisht nga afatet hetimore, duke shkelur nenet 323-325 të KPP-së; faktin se mungesa e një vendimi mosfillimi brenda 15 ditëve krijonte detyrimin ligjor që ditën e 16-të të regjistrohej procedimi penal; faktin se çdo veprim hetimor i Policisë Gjyqësore para regjistrimit dhe pa delegim të posaçëm është juridikisht nul, pasi nga data e kallëzimit anonim deri në atë të regjistrimit të procedimit penal, hetuesit e BKH-së kanë kryer veprime që përbëjnë akte tipike procedurale përpara regjistrimit të çështjes, jashtë kompetencës së tyre dhe pa akt delegimi; si dhe me faktin se prokuroria është mbështetur në deklarime vetinkriminuese të disa shtetasve (shtetasit F.B. për motivet e udhëtimit të datës 03.12.2016 në Rotterdam; shtetasit A.V.), çka deformon qëllimin e nenit 37 të KPP-së etj.

18.2.4. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi gjykatat nuk kanë argumentuar ekzistencën e kushteve që lejojnë caktimin e masës ekstreme dhe, në këndvështrim të parimit të proporcionalitetit e nevojshmërisë, përse ajo ishte e vetmja që mund të shmangte rrezikun e pretenduar. Ato nuk pranuan kërkesën për caktimin e masës “Garancia pasurore”, duke presupozuar se pasuritë e kërkuesit janë “të papastra”, për shkak të natyrës së akuzës. GJKKO-ja e Shkallës

së Parë nuk ka arsyetuar mbi fakte konkrete ose prova reale, por mbi perceptime për karakterin, qëllimin ose mundësinë e një sjelljeje të ardhshme. Në lidhje me mesazhet e dërguara nga kërkuesi hetuesve të BKH-së është supozuar sesi mund të sillej ai me dëshmitarët potencialë, pa u identifikuar asnjë fakt për ndërhyrje reale në hetim ose përpjekje për intimidim të dëshmitarëve. Për sa i përket vlerësimit se “nuk është shfaqur pendesë”, nuk ekziston asnjë normë ligjore që e njeh si kriter për caktimin e masës së sigurimit. Përdorimi i sjelljes si tregues për “rrezikun e përsëritjes së veprës” bie ndesh me parimin e proporcionalitetit, pasi ky vlerësim duhet të mbështetet në fakte objektive, si dhe me nenin 32 të Kushtetutës, parimin e barazisë së armëve dhe të drejtën për mbrojtje efektive. Arsyetimi se “mekanizimi që personat nën hetim kanë ideuar duket i vështirë të ndalet edhe prej tyre” përbën spekulim dhe nuk mbështetet në rrethana konkrete.

18.2.5. GJKKO-ja e Apelit e ka lidhur rrezikshmërinë me dispozitat e posaçme që zbatohen ndaj kërkuesit si subjekt i posaçëm, duke mos identifikuar llojin e provave që rrezikohen dhe as mënyrën e supozuar të “dëmtimit” të tyre edhe pse gjatë kohës që kërkuesi ka qenë në detyrë nuk ka ndërhyrë në hetime, nuk ka ndaluar asnjë zyrtar të dëshmojë, nuk ka shkatërruar asnjë dokument dhe nuk ka përdorur asnjë instrument institucional për të penguar drejtësinë. Për sa i përket arsyetimit për rrezikun e ikjes bazuar në mundësitë financiare dhe lëvizjet jashtë vendit, edhe pse kërkuesi ka pasur njohuri për hetimet, nuk është larguar asnjëherë, por ka udhëtuar lirisht jashtë vendit dhe është kthyer, duke qëndruar në dispozicion të drejtësisë. Sipas GJKKO-së së Apelit, bashkëpunimi me të hetuarit e tjerë ka tiparet e një bashkëpunimi të posaçëm, atij të grupit të strukturuar kriminal, duke qenë se përmbushen kriteret e personave të nevojshëm për këtë formë bashkëpunimi etj. Pavarësisht se ajo gjykatë nuk e merr në konsideratë këtë formë bashkëpunimi në këtë fazë të procesit, pasqyrimi i bindjes së saj për të shtuar akuza të reja ndaj personave nën hetim përbën cenim të së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, parimit të prezumimit të pafajësisë dhe përbën rëndim të pozitës së kërkuesit në veçanti, pasi, në thelb, ka rënduar nevojat e sigurimit. Gjykata e Lartë është mjaftuar me vlerësimin e

gjykatave më të ulëta. Ndonëse për “mungesën e pendesës” ka konstatuar se vlerësimi i gjykatës nuk ishte korrekt, Kolegji Penal nuk ka gjetur shkelje të prezumimit të pafajësisë, duke mos riparuar cenimin. Interpretimi se “regjistrimi i emrit në regjistrin e veprave penale është diskrecion i prokurorit” është në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 3, datë 27.09.2022 të asaj gjykate dhe jurisprudencën kushtetuese, që përcaktojnë se nuk ka një diskrecion të pakufizuar të prokurorit në këtë drejtim. Ky interpretim bie ndesh edhe me parimin e sigurisë juridike dhe krijon në praktikë një zonë procedurale të pambrojtur për personin e kallëzuar. Për rrjedhojë, është cenuar edhe e *drejta e aksesit* në atë gjykatë.

18.2.6. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi gjykatat e kanë paragjykuar kërkuesin për rrethin shoqëror, statusin dhe pozicionin e tij. Argumentet për mungesën e pendesës, personalitetin, rrezikun e ikjes ose të ndërhyrjes në prova, për “përfitimet e parregullta”, “pasurimin personal” dhe “shpërfilljen ndaj fondeve publike” etj., shprehin bindje të formuar për fajësinë e kërkuesit. Gjykatat kanë përdorur gjuhën e akuzës si arsytim gjyqësor, duke transferuar barrën e provës te kërkuesi. Ato kanë zëvendësuar analizën e vlerësimit të personalizuar të rrezikut, të lidhur me sjelljen, karakterin, lidhjet familjare, gjendjen ekonomike dhe lidhjet me vendbanimin, me një përfundim abstrakt të nxjerrë nga “pozita e zyrtarit”. Duke u trajtuar komunikimi publik i kërkuesit si provë e “fushatës denigruese dhe intimidimit”, janë nxjerrë përfundime për qëllimin dhe fajësinë e tij, duke i dhënë peshë penale një akti që përbën shprehje të mendimit.

18.3. *Liria e shprehjes*, e sanksionuar në nenin 22 të Kushtetutës, pasi kërkuesi është ndëshkuar për komunikimin me oficerin e BKH-së, për shkak të toneve ose fjalive simbolike që përmbante mesazhi i tij, si dhe për shkak të komunikimeve të përfutuara nga përgjimet e marra si prova në gjykimin në apel. Sjellja e tij nuk përbën provë për rrezik në marrjen ose vërtetësinë e provave, ndërsa arsyetimi i gjykatës krijon një efekt frikësues (*chilling effect*), pasi, në thelb, kriminalizon gjuhën dhe mendimin, ndërkohë që deklaratat publike, reagimet politike ose komunikimet me tone kritike bëjnë pjesë në diskursin publik të mbrojtur nga dispozita kushtetuese.

18.4. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës, pasi gjykatat e kanë vënë kërkesin në pozita diskriminuese në raport me subjektet e tjera të procesit penal, sepse e trajtojnë detyrën shtetërore jo si përgjegjësi, por si barrë penale. Edhe duke mos pranuar kërkesën për caktimin e masës “Garancia pasurore” gjykatat kanë krijuar një standard të dyfishtë ligjor, pasi për qytetarët e zakonshëm ajo është mjet i ligjshëm, kurse për zyrtarin e lartë është konsideruar e papërshtatshme për shkak të statusit të tij.

19. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

19.1. Pretendimi *për cenimin e lirisë personale* në drejtim të *proporcionalitetit* të masës është i pabazuar. Dyshimi i arsyeshëm është bazuar në provat financiare dokumentare, deklaratimet e dëshmitarëve, materialet mbështetëse të ndërthurura, aktet e ekspertimit etj. Çështja ka kaluar në gjyq, çka provon se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se kërkuksi ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar. Kurse rreziku i pengimit të drejtësisë është argumentuar me tentativat e kërkuksit dhe të rrethit të tij të afërt për ndikim të dëshmitarët dhe për shkatërrimin, fshehjen ose fabrikimin e provave dhe akteve shkresore. Është provuar se kërkuksi ka kapacitet real për ndikim në hetimin paraprak, pasi disponon burime financiare të konsiderueshme, rrjete ndikimi të fuqishme me kapacitet të plotë funksional, si edhe aftësi për koordinim veprimesh edhe pas arrestimit dhe izolimit. Fakti që kërkuksi është në detyrë fuqizon arsyet për ndikim të dëshmitarët. Ndërhyrjet procedurale që kanë ndodhur pas arrestimit të kërkuksit janë argumentuar nga gjykatat mbi bazën e provave të mbledhura dhe të paraqitura në seancë gjyqësore nga organi procedues. Çështja penale është ndërtuar në një pjesë të konsiderueshme mbi këto dëshmi dhe duke qenë se këta shtetas duhet të dëshmojnë në seancë gjyqësore, rreziku për integritetin e dëshmimeve është real dhe i prekshëm, duke pasur në konsideratë sjelljen e deritanishme të kërkuksit. Po kështu, kryetari i bashkisë ka akses në dokumentacionin administrativ, arkiva, sisteme elektronike dhe personel teknik. Faktet dëshmojnë për një mekanizëm të mirorganizuar për të ushtruar ndikim mbi autoritetet gjyqësore, për të udhëzuar dëshmitarët, për të orkestruar dhe

ekzekutuar një fushatë mediatike që synon dëmtimin e mbarëvajtjes së drejtësisë dhe punës së funksionarëve të saj, për të udhëzuar persona të caktuar me qëllim shtrembërimin e deklaratave në seancë gjyqësore të përfaqësuesve të akuzës, për të fabrikuar prova shkresore për justifikimin *post factum* të origjinës së paligjshme të pasurive etj. Argumentet e gjykatave nuk janë abstrakte, por mbështeten në një *modus operandi* të ndërtuar dhe vënë në zbatim për marrjen e përfitimeve të parregullta. Gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë shteruese për shkaqet “e rëndësishme” dhe “të mjaftueshme” për caktimin dhe vazhdimin e paraburgimit, siç është rreziku i helmimit të provave dhe se masat alternative janë të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme. “Garancia pasurore” jo vetëm nuk kënaq shkallën e nevojave të sigurimit, por nuk përputhet as me natyrën e veprave penale për të cilat është akuzuar kërkuesi, që lidhen me përfitimin e parregullt të pasurive gjatë ushtrimit të detyrës dhe fshehjen e burimit të tyre.

- 19.2. Të pabazuara janë edhe pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Për pretendimin për të drejtën për mbrojtje efektive është arsyetuar mjaftueshëm për pabazueshmërinë e tij, duke u vlerësuar se edhe pse koha për t'u njohur me aktet ka qenë e pamjaftueshme në shkallë të parë, për shkak të volumit të tyre, kjo e drejtë është garantuar plotësisht në shkallë të dytë. Neni 248, pika 1, i KPP-së parashikon afate të shkurtra (3 ditë) për verifikimin e kushteve të masës së sigurimit nëpërmjet marrjes në pyetje të personit të arrestuar, afate që janë garanci në favor të individit. Mbrojtësit e kërkuesit e kanë marrë dosjen hetimore të plotë, në formë elektronike, që më 24.07.2025 (përfundimi i hetimeve) dhe gjatë seancave kanë pranuar se kanë qenë në gjendje ta studiojnë atë. Ata kanë qenë aktivë gjatë procesit dhe kanë realizuar mbrojtje efektive, kanë paraqitur prova, kanë debatuar për provat e akuzës, kanë ushtuar të drejtën e ankimit në gjykatat më të larta, si dhe kanë paraqitur ankim kushtetues, duke dëshmuar njohje të plotë me aktet e hetimit paraprak. Prokuroria ka treguar gjatë hetimit kujdesin e duhur, duke e përfunduar atë brenda afatit 6-mujor për të gjitha akuzat, kujdes i vërtetuar edhe nga gjykatat. Me përfundimin e hetimeve mbrojtësit kanë marrë një kopje të akteve, kanë kërkuar kryerjen e veprimeve shtesë dhe në seancat paraprake kërkuesi është përfaqësuar

nga mbrojtësit, të cilët kanë qenë aktivë dhe efektivë, duke paraqitur kërkesa, parashtrime etj., si dhe kanë pranuar aksesin dhe njohjen e plotë me aktet. Edhe pretendimi për regjistrimin e emrit të kërkuarit në regjistrin e veprave penale është arsyetuar në mënyrë shteruese në vendimet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë.

19.3. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit *reformatio in peius*, pasi disponimi i gjykatës së apelit është në përputhje me parashikimet e neneve 248, pika 4, 426/a, pika 5 dhe 427, pikat 1, 2 dhe 3, të KPP-së. Si personat nën hetim, ashtu edhe prokurorët, kanë kërkuar marrjen e provave të reja, një pjesë e të cilave ishte bashkëlidhur ankimit dhe apelit kundërshtues, ndërsa një pjesë janë prezantuar rishtazi në seancë. Qëndrimi i gjykatës së apelit është gjetur i drejtë edhe nga Gjykata e Lartë. Kurse pretendimet për shkelje procedurale me pasojë pavlefshmërinë dhe papërdorshmërinë e provave dhe mosrespektimin e ligjit procedural penal nuk mund të jenë objekt i këtij gjykimi dhe kërkuari ka ende mjete efektive në dispozicion.

19.4. I pabazuar është edhe pretendimi për *standardin e arsytimit*, pasi gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë shteruese për përshtatshmërinë e masës në raport me nevojat e sigurimit, rëndësinë e faktit penal, rrezikshmërinë e autorit dhe sanksionin penal, si dhe për ekzistencën e dyshimit të arsyeshem. Ato kanë dhënë përgjigje për nevojën, domosdoshmërinë dhe ashpërsinë e masës në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete dhe në përputhje me parashikimet e KPP-së. Gjykatat kanë arsyetuar për shkaqet “e rëndësishme” dhe “të mjaftueshme” për caktimin e vijimit e zbatimit të masës, siç është rreziku i helmimit të provave, ku rol përcaktues luan edhe tipologjia e tyre. Ky procedim penal ka ndërthurje mes provave “të ftohta” dhe “të gjalla”, ndaj helmimi i tyre është një rrezik eminent edhe gjatë gjykimit në themel. Gjykatat kanë arsyetuar për “rrezikun e ikjes” dhe “rrezikun e përsëritjes së veprës” nëse do të caktohej një masë tjetër. Duke analizuar dyshimin e arsyeshem, që mbetet i pandryshuar, arsyet “relevante” dhe “të mjaftueshme”, shtu edhe faktet e reja që kanë rezultuar nga hetimi për manipulimin e provave dhe sjelljen e kërkuarit, faktori “kohë e kaluar nga zbatimi i masës së sigurimit”, në kuptim edhe të jurisprudencës

së GJEDNJ-së, nuk mund të shërbejë si justifikim për ndryshimin e masës. Për më tepër, vonesat në gjykimin paraprak i atribuohen sjelljeve të kërkuesit, të mbrojtësve dhe bashkëpandehurve të tjerë. Gjykatat kanë arsyetuar edhe se masa “Garancia pasurore” nuk kënaq shkallën e nevojave të sigurimit e as nuk përputhet me natyrën e veprave penale. Kërkuesi, mbi bazën e deformimeve dhe shkëputjes mekanike të togfjalëshave nga arsyetimi i vendimeve gjyqësore ka ndërtuar një linjë mbrojtjeje që duket se kërkon të implikojë dhe komprometojë ndjekjen penale. Për sa i përket arsyetimit të GJKKO-së së Apelit për formën e bashkëpunimit të personave në hetim, një formë e tillë bashkëpunimi nuk u është atribuar ende atyre, për rrjedhojë nuk merret në konsideratë nga gjykata në caktimin e llojit dhe masës së sigurimit. Kurse rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe opinionet e ekspertëve në dokumentin e Këshillit të Evropës nuk kanë efekt në çështjen konkrete.

- 19.5. Të pabazuara janë edhe pretendimet në drejtim të *proporcionalitetit* në raport me të drejtën për t`u zgjedhur dhe *parimin e autonomisë vendore*. Pretendimi se arrestimi ka sjellë “shkarkim” *de facto* nuk u përgjigjet rrethanave konkrete, por as nuk mund të përbëjë argument për rishikimin ose shfuqizimin e masës. Vlerësimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit të masës lidhet vetëm me kriteret e kushtet ligjore dhe nuk kushtëzohet nga statusi institucional i kërkuesit. Nenet 61 e 62 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikojnë rastet e mbarimit të mandatit, ku nuk përfshihet arrestimi në zbatim të një mase sigurimi, ndaj kjo nuk prodhon efektin e ndërprerjes së mandatit as tërthorazi. Nëse zbatimi i masës krijon pamundësi për ushtrimin e përditshëm të detyrës, kjo nuk përbën shkarkim nga pikëpamja juridike. Rendi juridik parashikon mekanizma të vazhdimësisë institucionale edhe kur titullari ndodhet përkohësisht në pamundësi për të ushtruar kompetencat e tij. Një interpretim i ndryshëm do të krijonte një formë imuniteti procedural për funksionarët publikë, që nuk është parashikuar nga Kushtetuta e ligji.
- 19.6. I pabazuar është edhe pretendimi se masa ka sjellë krijimin e një “norme të re pezullimi” dhe “pengesë faktike për ushtrimin e funksionit publik”. Legjislacioni procedural penal dallon masat që kufizojnë lirinë personale nga ato që kufizojnë ose pezullojnë ushtrimin e një detyre a shërbimi publik. Masa e parashikuar nga neni

238 i KPP-së ka për objekt kufizimin e lirisë së individit për qëllime të procedimit penal, ndërsa pezullimi nga ushtrimi i një detyre ose shërbimi publik përbën një masë me natyrë dhe objekt të ndryshëm. Ndaj kërkuesit nuk është caktuar një masë sipas neneve 240-242 të KPP-së, për rrjedhojë nuk pranohet se masa e kundërshtuar ka sjellë *de facto* pezullimin nga detyra, pasi ajo nuk prodhon efekte juridike mbi statusin e funksionarit publik.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

20. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

21. Duke pasur parasysh natyrën kumulative të kriterëve të legjitimitimit dhe jurisprudencën e saj, Gjykata vëren se kriteret *ratione personae* dhe *ratione temporis* janë të përmbushura. Në lidhje me to nuk rezulton të ketë çështje që kërkojnë analizë të mëtejshme, ndërsa as subjektet e interesuara nuk kanë ngritur ndonjë prapësim.

22. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata thekson, *së pari*, se vendimet objekt kërkesë konsiderohen përfundimtare për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, për sa kohë kanë kufizuar lirinë personale të kërkuesit, si edhe në situatën që janë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe janë shqyrtuar nga gjykatat më të larta (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 13.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). *Së dyti*, për sa kohë ky kriter nënkupton edhe që të gjitha pretendimet që ngrihen në Gjykatë të jenë paraqitur më parë në gjykatat e zakonshme, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 40, datë*

14.05.2024; nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, konstaton se kërkuesi i është drejtuar asaj pas përfundimit të procesit gjyqësor në të gjitha shkallët e juridiksionit të zakonshëm gjyqësor. Për sa u përket pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues dhe argumenteve mbi të cilat janë mbështetur ato, rezulton se ai për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* nuk është ngritur më parë në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, as në formë, as në përmbajtje. Për rrjedhojë ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

23. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuesi, në mbështetje të pretendimeve për cenimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese, ka parashtruar edhe disa argumente që lidhen me rrethana faktike dhe zhvillime procedurale të ndodhura pas procesit gjyqësor të kundërshtuar, të tilla si përfundimi i hetimeve, dërgimi i çështjes në gjyq apo kohëzgjatja e mëtejshme e paraburgimit. Megjithatë, objekt i këtij gjykimi janë vendimet gjyqësore që kanë caktuar, vleftësuar dhe lënë në fuqi masën fillestare të sigurimit personal ndaj kërkuesit. Për rrjedhojë, kontrolli kushtetues në këtë çështje kufizohet në vlerësimin nëse, në këtë proces, gjykatat e zakonshme kanë respektuar garancitë kushtetuese të zbatueshme për atë moment të procedimit penal. Në këtë kuptim, edhe kur lidhen me të njëjtat pretendime kushtetuese, argumentet që mbështeten në rrethana faktike dhe zhvillime procedurale të mëvonshme, të cilat nuk kanë qenë pjesë e procesit gjyqësor të kundërshtuar dhe nuk janë shqyrtuar më parë nga gjykatat e zakonshme, nuk mund të paraqiten drejtpërdrejt për herë të parë në këtë gjykim kushtetues. Për ato kërkuesi duhet të shterojë më parë mjetet juridike përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

24. Kërkuesi ka ngritur pretendime edhe për mosrespektimin e ligjit procedural penal dhe shkelje procedurale me pasojë pavlefshmërinë dhe papërdorshmërinë e provave, pasi regjistrimi i procedimit penal nr. 27/2024 është bërë mbi akte të papërdorshme, çka sjell pavlefshmërinë e të gjitha akteve pasuese apo se prokuroria është mbështetur në deklarime vetinkriminuese të disa shtetasve, çka deformon qëllimin e nenit 37 të KPP-së. Gjykata ka theksuar se në këtë fazë të procedimit penal gjykatat bazohen në ato të dhëna, informacione ose fakte objekt prove mbi të cilat organi që procedon mbështet kërkesën për caktimin e masës së sigurimit dhe të cilat, po në konsideratë të kësaj faze, duhet të krijojnë dyshimin e arsyeshëm se personi nën hetim mund të ketë kryer veprën penale. Dyshimi i arsyeshëm nuk është imagjinar edhe pse bazuar në këto të dhëna, informacione apo fakte objekt prove nuk mund të pohohet me bindje të palëkundur

vlefshmëria e akuzës. Për rrjedhojë, të dhënat, informacionet apo faktet objekt prove në këtë fazë të procedimit penal nuk kërkohet që të jenë në të njëjtin nivel provueshmërie me ato mbi të cilat bazohet vendimi i themelit që ka të bëjë me (pa)fajësinë e të pandehurit dhe gjatë të cilit do të formësohen edhe provat që kanë të bëjnë me të provuarit e akuzës penale. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar dallimin midis konceptit të provave të cilat shërbejnë për vërtetimin e fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe atyre të dhënave, informacioneve ose fakteve, objekt prove, të cilat shërbejnë për krijimin e dyshimit të arsyeshëm se personi nën hetim mund të ketë kryer veprën penale. Provat formësohen në procesin penal të themelit në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve dhe garancitë e tjera të një procesi të drejtë që qëndrojnë në themel të procesit gjyqësor penal, ndërsa në verifikimin e këtyre lloj çështjesh (për masat e arrestit) Gjykata verifikon nëse të dhënat, informacionet ose faktet që ishin në dispozicion të organeve proceduese në kohën kur është vendosur masa e sigurimit personal ishin ose jo të tilla që, në tërësinë e tyre, formonin dyshimin e arsyeshëm për të justifikuar në rastin konkret kufizimin e lirisë (*shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këndvështrim të këtyre standardeve, si dhe duke mbajtur në konsideratë se gjykimi në themel i çështjes penale është momenti në të cilin formësohen dhe debatohen provat, Gjykata vlerëson se këto pretendime nuk janë të tilla që të përcaktojnë në mënyrë definitive këtë fazë të procesit penal, pra që të vënë në dyshim formimin e atij dyshimi të arsyeshëm që justifikon kufizimin e lirisë. Për sa kohë që këto pretendime kanë të bëjnë, në thelb, me çështje të vlefshmërisë dhe përdorshmërisë së akteve dhe provave të mbledhura gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe që përbëjnë pjesë të fashikullit të gjyqimit, ato janë të tilla që duhet të parashtrihen përpara gjykatave të zakonshme gjatë procesit të themelit. Për rrjedhojë, në lidhje me këto pretendime kërkuesi ka mjete efektive në dispozicion për kundërshtimin e tyre, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

25. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit në drejtim të nenit 242 të KPP-së, se masa e arrestit ka sjellë edhe pezullimin e tij *de facto* nga ushtrimi i funksionit të zgjedhur, gjë e cila ndalohet për këta funksionarë, Gjykata vëren se, në mënyrën se si është parashtruar, ky pretendim nuk lidhet me një çështje të pavarur të zbatimit të kësaj dispozite. Në thelb, ai ka të bëjë me proporcionalitetin e masës kufizuese të caktuar ndaj kërkuesit, në drejtim të së drejtës për liri personale, të vlerësuar edhe në raport me efektet që kjo masë pretendohet se ka sjellë mbi ushtrimin e mandatit të tij si funksionar i zgjedhur. Kurse për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesit,

ato janë parashtruar më parë, në formë ose substancë, edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, ndërsa, në lidhje me pretendimet për procesin gjyqësor në atë gjykatë, kërkuesi nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion përveç ankimit kushtetues.

26. Në lidhje me kriterin e legjitimitetit *ratione materiae*, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, ai verifikohet në drejtim të përmbajtjes dhe natyrës së pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e *lirisë personale* për shkak të mungesës të kushteve, kritereve e nevojave të sigurimit në rastin konkret, pretendim ky i lidhur edhe me mungesën e arsytimit nga gjykatat e zakonshme në këtë drejtim. Sipas kërkuesit, vendimet gjyqësore nuk arsyetojnë në drejtim të përshatshmërisë së masës së arrestit në raport me masat e tjera të sigurimit, konkretisht me masën “Garancia pasurore” dhe as në drejtim të proporcionalitetit të saj, duke pasur parasysh pasojat e masës së sigurimit në ushtrimin prej tij të funksionit të besuar nga qytetarët, si dhe në të drejtën e qytetarëve të Tiranës për t`u qeverisur nga kryetari i zgjedhur i bashkisë. Kjo, për më tepër, në situatën kur me vendimin nr. 66/2025 Gjykata ka shfuqizuar VKM nr. 539/2025 për shkarkimin e kërkuesit nga detyra, duke afirmuar mandatin e tij. Për rrjedhojë, masa kufizuese e lirisë i ka cenuar edhe *lirinë e lëvizjes* dhe *të drejtën për t`u zgjedhur* për shkak se ka prodhuar efektet e një shkarkimi *de facto*, duke bllokuar funksionimin e një organi që duhet të jetë aktiv dhe efektiv, si dhe ka sjellë pezullimin *de facto* nga detyra, pasojë që ndalohej nga neni 242 i KPP-së për funksionarët e zgjedhur, edhe pse nuk ka një vendim të formës së prerë që ndalon ushtrimin e funksionit nga kërkuesi. Po kështu, është pretenduar edhe cenimi i *lirisë së shprehjes*, pasi kërkuesi është ndëshkuar për komunikimin e tij me mesazhe me oficerin e BKH-së, si dhe për shkak të shkrimeve e postimeve publike që, sipas të dhënave të përfuara nga provat e marra rishtazi në apel, janë konsideruar si “fushatë denigrimi e intimidimi” ndaj autoriteteve të hetimit, të nxitura nga kërkuesi, ndërkohë që ato bëjnë pjesë në diskursin publik të mbrojtur nga neni 22 i Kushtetutës.

27. Kërkuesi ka ngritur pretendime edhe në drejtim të *së drejtës për proces të rregullt*, në disa aspekte të saj. Konkretisht, ai ka pretenduar cenimin e *së drejtës për mbrojtje efektive* dhe të *parimit të barazisë së armëve*, për shkak të kohës së kufizuar, të pamjaftueshme, që iu la mbrojtjes për njohjen me aktet voluminoze të procedimit penal, e cila ishte e pamjaftueshme, si edhe për shkak të mbajtjes së tij në kafaz sigurie/kabinë xhami, duke i kufizuar mundësinë për të komunikuar lehtësisht me mbrojtësit e zgjedhur. Sipas tij, është cenuar edhe *parimi “reformatio*

in peius” për shkak të pranimit për shqyrtim nga gjykata e apelit të provave të kërkuara nga prokuroria, edhe pse kjo palë nuk kishte paraqitur ankim të vlefshëm që të legjitimonte paraqitjen e provave të reja. Kjo, sipas kërkuarit, i ka cenuar edhe *të drejtën e mbrojtjes* dhe *parimin e barazisë së armëve* për shkak të pamjaftueshmërisë së kohës për t`u njohur me këto prova dhe për të debatuar mbi to.

28. Po kështu, kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit*, për shkak të caktimit të një mase ekstreme sigurimi personal që i ka pamundësuar edhe ushtrimin e detyrës, pa u argumentuar nga gjykatat ekzistenca e kushteve që lejojnë caktimin e saj dhe pa u argumentuar se përse kjo masë ishte e vetmja që mund të shmangte rrezikun e pretenduar. Për shkak të mënyrës sesi Gjykata e Lartë ka trajtuar dhe u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit ai ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës së aksesit* në atë gjykatë. Sipas tij, është cenuar edhe *parimi i prezumimit të pafajësisë*, pasi gjykatat e kanë paragjykuar kërkuarin për rrethin shoqëror, statusin dhe funksionin. Sipas tij, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se bashkëpunimi me të hetuarit e tjerë ka tiparet e një bashkëpunimi të posaçëm. Pavarësisht se ajo gjykatë nuk e merr në konsideratë këtë formë bashkëpunimi në këtë fazë të procesit, pasqyrimi i bindjes së saj për të shtuar akuza të reja ndaj personave nën hetim përbën cenim të *së drejtës* për t`u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, parimit të prezumimit të pafajësisë dhe përbën rëndim veçanërisht të pozitës së kërkuarit. Argumentet e gjykatave, vijon kërkuari, si dhe gjuha e përdorur në vendim, përbëjnë gjykim vlerësues të fajësisë përpara se ajo të provohet, duke shprehur një bindje të formuar për fajësinë e kërkuarit, pra duke transferuar barrën e provës nga akuza tek i pandehuri. Ai ka pretenduar se ky parim është cenuar edhe për shkak të vlerësimit në drejtim të rrezikut të marrjes ose vërtetësisë së provave të komunikimeve publike të tij, duke u nxjerrë përfundime për qëllimin dhe fajësinë e kërkuarit nga sjellje (komunikimi i tij me hetues të BKH dhe komunikimi përmes postimeve publike) që përbëjnë shprehje të lirë të mendimit. Po në drejtim të këtij parimi, kërkuari ka parashtruar edhe se mbajtja e tij në kafaz/kabinë xhami gjatë procesit gjyqësor ka paragjykuar fajësinë e tij, pasi krijon imazh negativ të tij si person i rrezikshëm dhe një perceptim të gabuar për fajësinë, për më tepër kur ai nuk është akuzuar për një vepër penale të dhunshme, ka karakter të mirë, pozitë të lartë në shoqëri etj. Për shkak të mbajtjes së tij të izoluar gjatë seancave gjyqësore dhe publikimit të fotove të tij në media, kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e *dinjitetit* të tij, duke

pretenduar se kjo përbën një sjellë poshtëruese dhe degraduese dhe se gjykatat nuk kanë siguruar kushte dinjitoze për ushtrimin efektiv të të drejtave të tij.

29. Gjykata ka theksuar se liria personale ka dy aspekte: atë substancial, që garantohet nga neni 27 i Kushtetutës dhe atë procedural, që garantohet nga neni 28 i lidhur me nenin 42 të Kushtetutës. Në rastet e kontrollit të vendimeve që caktojnë masat e sigurimit personal, ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues në drejtim të të drejtave substanciale, ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar. Në këtë kuptim, Gjykata edhe në jurisprudencën e saj është shprehur se ajo ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete. Kjo sepse garancitë që ofron e drejta për proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, gjejnë zbatim edhe në proceset gjyqësore që vendosin për kufizimin e lirisë personale sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi të lidhura me garancitë e parashikuara nga neni 28 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së. Kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe se këto procedura duhet të sigurojnë garancitë e duhura (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 40, datë 14.05.2024; nr. 19, datë 04.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata, bazuar në natyrën dhe thelbin e pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, vlerëson që ta shqyrtojë çështjen në themel në drejtim të pretendimeve për *lirinë personale* në aspektin procedural dhe atë substancial. Më konkretisht, *në aspektin procedural* do të shqyrtohen pretendimet për: i) *të drejtën e mbrojtjes* të lidhur me argumentet për kohën e pamjaftueshme në dispozicion për njohjen me aktet e dosjes dhe me qëndrimin e kërkuesit në kafaz/kabinën e xhamit gjatë procesit gjyqësor në gjykatat e faktit për aq sa kjo rrethanë pretendohet se ka ndikuar në ushtrimin efektiv të mbrojtjes; ii) *parimin reformatio in peius (mosrëndimit të pozitës)* të lidhur me argumentin për marrjen e provave të reja në GJKKO-në e Apelit, të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme. *Në aspektin substancial* do të shqyrtohen pretendimet për: i) *mungesën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova* për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit të lidhur edhe me *parimin e prezumimit të pafajësisë* për shkak të gjuhës së përdorur në arsyetimin e vendimeve të gjykatave, duke vlerësuar në këtë drejtin nëse arsyetimi konkret i gjykatave ka

mbetur brenda kufijve të dyshimit procedural apo nëse është përdorur një gjuhë që shpreh bindje për fajësinë e kërkuesit. Po në këtë drejtim, Gjykata do të trajtojë edhe pretendimin për vlerësimin e GJKKO-së së Apelit për bashkëpunimin e posaçëm mes personave nën hetim, për sa kohë që, pavarësisht se kërkuesi e ka parashtruar në drejtim të prezumimit të pafajësisë, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe mosrëndimit të pozitës, ai ka të bëjë, në thelb, me mënyrën e vlerësimit nga ajo gjykatë të nevojave të sigurimit në rastin konkret; ii) *proporcionalitetit të masës të lidhur edhe me të drejtën për t'u zgjedhur*. Në drejtim të proporcionalitetit të masës do të shqyrtohet nga Gjykata edhe pretendimi *për lirinë e shprehjes*, për sa kohë që ai, në thelb, është i lidhur me analizën nga gjykatat të *rrezikut të prishjes së provave*. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *dinjitetit për shkak të qëndrimit të kërkuesit në kafaz/kabinën e xhamit gjatë procesit gjyqësor në gjykatat e faktit*, nisur nga natyra dhe argumentet e parashtruara në mbështetje të tij, ai do të trajtohet në vijim si një pretendim i mëvetshëm, në kuptim të nenit 25 të Kushtetutës dhe nenit 3 të KEDNJ-së.

31. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, për shkak të imazhit negativ si person i rrezikshëm, që krijohet nga mbajtja e kërkuesit të izoluar gjatë seancave gjyqësore, Gjykata, për nga mënyra sesi është parashtruar ai, do ta shqyrtojë atë jo si pretendim të mëvetshëm por të lidhur me pretendimin për cenimin e dinjitetit të kërkuesit. Në të njëjtën mënyrë, edhe pretendimi për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimeve gjyqësore* dhe, i lidhur me të, *të së drejtës së aksesit në gjykatë*, për sa kohë që kanë të bëjnë me mënyrën sesi gjykatat e zakonshme kanë trajtuar dhe u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit ose me mungesën e marrjes së një përgjigjeje të arsyetuar në lidhje me pretendimet e parashtruara përpara tyre, do të vlerësohen në vijim në kuadrin e trajtimit të secilit aspekt të lirisë personale, duke verifikuar edhe mënyrën sesi gjykatat e zakonshme kanë vepruar dhe kanë arsyetuar në rastin konkret.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për lirinë personale në aspektin procedural

B.1.1. Për të drejtën e mbrojtjes

32. Gjykata vlerëson të theksojë, fillimisht, se të drejtat dhe garancitë e personit të cilit i hiqet liria janë parashikuar në nenet 28 dhe 31 të Kushtetutës dhe ato janë në funksion edhe të së

drejtës së mbrojtjes, si garanci themelore edhe për realizimin e së drejtës për proces të rregullt, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës, i cili gjen zbatim edhe në proceset gjyqësore që vendosin për kufizimin e lirisë personale, por për aq sa janë të pajtueshme me natyrën e posaçme, urgjencën dhe objektin e këtyre procedurave, pra se garancitë sipas kësaj dispozite nuk zbatohen në të njëjtën shtrirje dhe intensitet sikurse në proceset gjyqësore që vendosin për (pa)fajësinë e individit. Neni 28 i Kushtetutës garanton, mes të tjerash, të drejtat: për t`u njoftuar menjëherë për shkaqet e masës dhe akuzën; për të komunikuar menjëherë me avokatin dhe për t`iu dhënë mundësia për realizimin e të drejtave; për t`u dërguar brenda 48 orëve, në rastet e heqjes së lirisë, sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi “c”, të Kushtetutës, përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim; për t`u ankuar kundër vendimit të gjyqtarit; për t`u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm ose për t`u proceduar i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit; e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit. Pika 2 e kësaj dispozite synon garantimin e së drejtës së personit të cilit i është kufizuar liria personale për t`u dëgjuar nga gjykata në lidhje me pretendimet e tij, si dhe për t`u mbrojtur ndaj çdo kufizimi të padrejtë e arbitrar të kësaj lirie. Kurse neni 31 i Kushtetutës garanton, mes të tjerash, të drejtën për të pasur kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen (shkronja “b”), ashtu edhe të drejtën për t`u mbrojtur vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, si dhe për të komunikuar lirisht dhe privatisht me të (shkronja “ç”).

33. Në kuptim të nenit 5, pika 4, të KEDNJ-së, që përbën edhe *habeas corpus*-in e KEDNJ-së, një person i arrestuar ose i ndaluar ka të drejtën e shqyrtimit gjyqësor të ligjshmërisë së masës, nën dritën jo vetëm të kërkesave ligjore kombëtare, por edhe të KEDNJ-së, parimeve të përgjithshme të shprehura në të dhe qëllimit të kufizimeve të lejuara nga paragrafi 1 i nenit 5 të saj. Shqyrtimi duhet të shtrihet mbi ato kritere të cilat janë thelbësore për vlerësimin e ligjshmërisë, sipas llojit të masës së caktuar, si dhe duhet të garantojë parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, duke i dhënë mundësi efektive për të kundërshtuar dyshimet ose akuzat. Mundësia që një i ndaluar të dëgjohej personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi është një nga garancitë themelore të procesit, i cili duhet të jetë kontradiktor dhe të garantojë “barazinë e armëve” ndërmjet palëve (*shih vendimet nr. 86, datë 30.12.2024; nr. 83, datë 05.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Gjykata, bazuar në standardet e mësipërme dhe duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve të kërkuarit çmon që të analizojë pretendimin e kërkuarit për sigurimin e një mbrojtjeje efektive gjatë procesit gjyqësor të caktimit të masës së arrestit veçmas për secilin aspekt, konkretisht: i) në drejtim të kohës për t`u njohur me aktet e dosjes; ii) në drejtim të së drejtës për të komunikuar lirisht me mbrojtësit, për shkak të qëndrimit në kafaz/kabinën e xhamit.

B.1.1.1. Për kohën për t`u njohur me aktet e dosjes

35. Sipas kërkuarit, pas ekzekutimit të vendimit nr. 7/2025 të GJKKO-së së Shkallës së Parë në datën 10.02.2025, mbrojtjes i është vënë në dispozicion një kopje e vendimit gjyqësor prej 365 faqesh, në përmbajtje të të cilit ka detaje teknike për nëntë fakte penale në ngarkim të të hetuarve. Sipas tij, në seancën e datës 12.02.2025 në gjykatën e shkallës së parë, mbi kërkesën e mbrojtjes për t`u njohur me aktet e hetimit, gjykata u ka lënë kohë deri në orën 13:30, tërësisht e pamjaftueshme në raport me volumin e akteve, çka i ka pamundësuar paraqitjen e provave në mbështetje të pretendimeve. Ndërkohë, edhe provat e paraqitura në atë seancë nga kërkuari vetëm janë cituar nga gjykata, por nuk janë analizuar dhe nuk u është dhënë përgjigje atyre. Po sipas kërkuarit, GJKKO-ja e Apelit ka lejuar pranimin e provave të reja të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme, çka e ka vendosur atë edhe në kushtet e pamjaftueshmërisë së kohës së nevojshme për t`u njohur dhe konsultuar me ato prova.

36. Sipas subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme, edhe pse në shkallë të parë koha për t`u njohur me aktet ka qenë e pamjaftueshme për shkak të volumit të tyre, kjo e drejtë është garantuar në shkallë të dytë, ku kërkuari është njohur me aktet dhe ka pasur të gjitha mundësitë për të paraqitur pretendimet dhe kundërshtimet për hetimet e kryera dhe vlerësimet e organit të akuzës. Sipas subjektit të interesuar, mbrojtësit e kërkuarit kanë qenë aktivë gjatë gjithë procesit, kanë përfaqësuar atë dhe kanë realizuar mbrojtje efektive, duke paraqitur prova gjatë seancës së verifikimit të kushteve të masës dhe në gjykatën e apelit. Ata kanë marrë pjesë dhe kanë debatuar për provat e mbledhura nga autoriteti procedues, kanë kundërshtuar të gjitha vendimet në gjykatat më të larta, si dhe kanë paraqitur ankim kushtetues, duke dëshmuar njohje të plotë me aktet e hetimit paraprak.

37. Bazuar në parashikimet e neneve 28 dhe 42 të Kushtetutës, neni 248 i KPP-së parashikon marrjen në pyetje nga gjykata të personit ndaj të cilit është vendosur masa e arrestit në

burg ose në shtëpi, jo më vonë se tri ditë nga zbatimi i asaj mase. Gjykata ka vlerësuar se ndonëse procedurat gjyqësore që lidhen me masat e sigurimit, veçanërisht ato të arrestit, duhet të sigurojnë për individin garancitë e parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës, këto garanci nuk mund të zbatohen të plota në këtë fazë të procesit. Kufizimi i disa prej këtyre garancive, veçanërisht në drejtim të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, diktohet nga natyra urgjente e kontrollit gjyqësor të heqjes së lirisë dhe afatet e shkurtra dhe prekluzive të parashikuara nga KPP-ja për shqyrtimin e kërkesës për caktimin e masave të sigurimit. Në këtë fazë të procesit, debati mbi provat është i ndryshëm nga ai në procesin e themelit, pasi qëllimi i saj është të verifikojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm dhe të nevojave të sigurimit që lejojnë caktimin ose vazhdimin e një mase kufizuese të lirisë (*shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Për sa i përket aksesit dhe njohjes me aktet e dosjes, Gjykata ka theksuar se edhe pse e drejta për të disponuar provat përkatëse nuk është një e drejtë absolute, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes, aksesit në dokumentacion nënkupton të gjitha aktet mbi të cilat është bazuar dyshimi i arsyeshëm që ka justifikuar caktimin e masës së sigurimit. Ky akses përfshin si standard minimal njohjen me këto akte dhe mbajtjen e shënimeve mbi përmbajtjen e këtyre akteve edhe në rastet përjashtimore kur aksesit përmes marrjes së kopjeve të këtyre akteve është kufizuar për ruajtjen e sekretit të hetimit (*shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Bazuar në sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh përmbajtjen e neneve 28 dhe 42 të Kushtetutës, vëren se në procedurat që lidhen me kontrollin gjyqësor të heqjes së lirisë duhet të ruhet një ekuilibër i drejtë ndërmjet kërkesës për shpejtësinë e këtij kontrolli dhe së drejtës për mbrojtje efektive. Afatet e shkurtra që karakterizojnë këtë procedurë nuk përbëjnë thjesht një kufizim objektiv të mundësive të mbrojtjes, por janë, në vetvete, garanci për lirinë personale, pasi synojnë të sigurojnë kontrollin e menjëhershëm gjyqësor të heqjes së lirisë dhe parandalimin e çdo kufizimi arbitrar të saj. Megjithatë, kjo garanci duhet të jetë në ekuilibër të drejtë me të drejtën e të arrestuarit për mbrojtje efektive, e cila kërkon që ai dhe mbrojtësi i tij të kenë akses të mjaftueshëm në aktet thelbësore të procedimit penal dhe kohë të arsyeshme për t'i shqyrtuar ato, edhe kur janë voluminoze, në funksion të kundërshtimit të masës së caktuar. Për rrjedhojë, gjykata e zakonshme duhet të sigurojë akses efektiv në aktet e procedimit dhe kohë të arsyeshme për shqyrtimin e tyre, për aq sa kjo është e pajtueshme me natyrën urgjente dhe afatet kushtetuese dhe

ligjore të kontrollit gjyqësor të heqjes së lirisë. Gjykata vëren se aksesit në dokumentacion ka natyrë funksionale, pasi shërben për garantimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes përpara gjykatës që vlerëson ligjshmërinë dhe nevojën e kufizimit të lirisë personale. Në këtë kuptim, pretendimi për cenim të së drejtës së mbrojtjes për shkak të mungesës së aksesit në çdo dokument ose akt të procedimit penal nuk mund të merret në konsideratë nëse individit nuk provon se si dhe në çfarë mase mungesa e aksesit e ka penguar ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes, deri në cenimin e vetë thelbit të saj.

40. Në këtë këndvështrim, Gjykata do të verifikojë nëse gjatë kësaj faze të procedurës kërkuesit dhe mbrojtësve të tij u është garantuar koha e mjaftueshme për t'u njohur me aktet e dosjes në funksion të përgatitjes së mbrojtjes së tij dhe në funksion të paraqitjes së pretendimeve dhe argumenteve për kundërshtimin e masës së sigurimit. Ky pretendim duhet të vlerësohet në kontekstin e natyrës urgjente të kontrollit gjyqësor të heqjes së lirisë sipas nenit 248 të KPP-së, afateve të shkurtra që e karakterizojnë atë, si dhe të garancive të ofruara në tërësinë e procesit të kontrollit gjyqësor të masës.

41. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar, si dhe aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues, vëren se me vendimin nr. 7/2025 GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit “Arrestit në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP-së. Kjo masë është ekzekutuar në datën 10.02.2025 dhe Prokuroria e Posaçme i është drejtuar gjykatës për verifikimin e kushteve e të kriterëve të zbatimit të masës së sigurimit. Në datën 11.02.2025 avokati i kërkuesit ka paraqitur kërkesë për t'u njohur me aktet e fashikullit hetimor. Në datën 12.02.2025, në orën 09:05, ka filluar në GJKKO-në e Shkallës së Parë seanca gjyqësore për marrjen në pyetje të personave të arrestuar nën hetim dhe verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit. Mbrojtësi i kërkuesit ka paraqitur si kërkesë paraprake njohjen me aktet e fashikullit hetimor, referuar edhe kërkesës së paraqitur një ditë më parë, duke kërkuar nga gjykata që t'i lihej në dispozicion afati maksimal i mundshëm. Kësaj kërkesë gjykata i është përgjigjur se numri i fashikujve është 66 dhe se kjo seancë ka qëllim të identifikojë personat ndaj të cilëve është caktuar masa në mungesë, ndërkohë që vendimi i arsyetuar i gjykatës për caktimin e saj u është vënë në dispozicion palëve. Sipas gjykatës, është prokuroria që ka detyrimin ligjor për të vënë në dispozicion aktet e prodhuara prej saj dhe se për shkak të numrit të fashikujve ato nuk mund të konsultoheshin brenda ditës, pasi afatet procedurale për shqyrtimin e kërkesës për vleftësimin e

masës janë të ngutshme. Pyetjes së gjykatës nëse ishte njohur me vendimin për caktimin e masës, avokati i kërkuesit i është përgjigjur pozitivisht, por ka parashtruar se ai vendim nuk jepte të dhëna për mënyrën sesi janë marrë provat dhe burimin e tyre. Përfaqësuesi i Prokurorisë së Posaçme në lidhje me këtë kërkesë paraprake është shprehur se pranë këtij institucioni nuk është paraqitur ndonjë kërkesë për vënien në dispozicion të akteve të fashikujve hetimorë, të cilat prokuroria ishte e gatshme t'i vinte në dispozicion në çdo moment edhe në version të skanuar. Po ashtu, ai është shprehur që mbrojtësve t'u lihen në dispozicion disa orë për këtë qëllim, duke pasur parasysh afatet procedurale që duhet të respektohen për shkak të natyrës së këtij gjykimi.

42. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, në kushtet kur kjo kërkesë është mbështetur edhe nga përfaqësuesit e të pandehurve të tjerë, në orën 09:28 ka vendosur që t'u lërë atyre kohë deri në orën 13:30 për njohjen, në sallën e gjyqit, me aktet e fashikujve hetimorë, afat për të cilin nuk rezulton të ketë pasur ndonjë kundërshtim. Për rrjedhojë, seanca është ndërprerë dhe është riçelur në orën 13:33. Me rifillimin e seancës gjyqësore avokati i kërkuesit është shprehur se është njohur pjesërisht me aktet, për shkak të volumit të madh të tyre, por edhe për shkak të afateve procedurale është shprehur se do të vijonte me parashtrimet e tij. Në vijim, mbrojtësi i kërkuesit ka parashtruar përpara gjykatës argumentet e tij dhe ka paraqitur prova në mbështetje të pretendimeve, të cilat janë administruar nga gjykata. Po kështu, gjykata ka dëgjuar edhe vetë kërkuesin, i cili ka parashtruar qëndrimin e tij. Në përfundim, mbrojtësi i kërkuesit ka kërkuar caktimin e një mase sigurimi të përshtatshme, më të butë se ajo e arrestit. GJKKO-ja e Shkallës së Parë në përfundim të seancës, me vendimin nr. 14/2025, ka vendosur vazhdimin e masës së sigurimit “Arrest i burg” të caktuar ndaj kërkuesit me vendimin nr. 7/2025 të po asaj gjykate.

43. Mbi ankimin edhe të kërkuesit, çështja është shqyrtuar në GJKKO-në e Apelit. Në seancën gjyqësore të datës 11.03.2025, pas hapjes së shqyrtimit gjyqësor, avokatët e kërkuesit kanë paraqitur parashtrimet e tyre, bashkë me provat përkatëse, të cilat janë administruar dhe janë bërë pjesë e fashikullit gjyqësor. Përfaqësuesi i Prokurorisë së Posaçme ka paraqitur parashtrimet dhe provat të cilat, sipas tij, përforconin ekzistencën e nevojave të sigurimit dhe justifikonin masën e caktuar, çka është kundërshtuar nga mbrojtja me pretendimin se kjo palë ka paraqitur vetëm apel kundërshtues. Ajo gjykatë, bazuar në nenet 248, pika 4, 426/a, pika 5 dhe 427, pikat 1, 2 dhe 3, të KPP-së, ka vlerësuar se gjatë seancës së marrjes në pyetje mund të merren prova me përjashtim të provës me dëshmitarë dhe se ajo mund të pranojë provat që i bashkëlidhen ankimit ose prova të

reja, duke vendosur administrimin e tyre. Në këto kushte, për shkak të paraqitjes së provave voluminoze nga ana e prokurorisë, seanca është shtyrë ditën e nesërme. Në seancën e datës 12.03.2025 mbrojtësi i kërkuesit ka paraqitur kundërshtime për provat e prokurorisë, duke parashtruar se koha kishte qenë e pamjaftueshme dhe duke kërkuar shtyrjen e gjyqimit për një afat 10-ditor, sipas nenit 427 të KPP-së, dispozitë për të cilën gjykata është përgjigjur se zbatohet në gjykimin në themel. Në përfundim të seancës gjyqësore, pas dëgjimit të palëve, përfshirë kërkuesin, seanca është shtyrë për ditën e nesërme për shkak të pamundësisë së shpalljes së vendimit, duke pasur parasysh provat e reja të paraqitura, numrin e ankimeve, kompleksitetin e çështjes, si dhe parashtrimet dhe pretendimet e palëve. Në seancën e datës 13.03.2025 GJKKO-ja e Apelit ka shpallur vendimin, duke vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë për kërkuesin.

44. Në lidhje me këtë pretendim të kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka gjetur të drejtë vlerësimin e GJKKO-së së Apelit. Sipas atij kolegji, edhe nëse gjatë gjyqimit në gjykatën e shkallës së parë koha për t'u njohur me aktet ka qenë e pamjaftueshme për shkak të volumit të madh të tyre, kërkuesi është njohur me aktet e dosjes hetimore dhe gjatë gjyqimit (kontrollit) të masës së sigurimit në gjykatën e apelit, duke pasur të gjitha mundësitë, siç ka vepruar, për të paraqitur çdo pretendim dhe kundërshtim në lidhje me hetimet e kryera dhe vlerësimet e organit të akuzës. Natyra urgjente e këtij gjykimi, në këtë fazë të procesit, ka orientuar ligjvënësin që të përcaktojë afate të shkurtra për organet proceduese, të cilat duhen respektuar rigorozisht, me qëllimin e vetëm, atë të garantimit/mosçenimit të lirisë së personit nga veprimet arbitrare të organeve shtetërore. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, garantimi i një të drejte më të madhe, siç është liria personale, mund të sjellë përkohësisht cedim në garantimin e plotë të një të drejte tjetër procedurale në një moment apo fazë të caktuar të procesit, e cila është e kurueshme dhe garantohet në një fazë të mëvonshme të tij, siç dhe ka ndodhur në rastin konkret, gjatë shqyrtimit të çështjes në GJKKO-në e Apelit, ku kërkuesit i është dhënë hapësira e nevojshme për t'u mbrojtur dhe për të ushtruar të drejtat e tij procedurale.

45. Bazuar në sa më sipër, rezulton se masa e sigurimit është caktuar ndaj kërkuesit në datën 09.02.2025 dhe është ekzekutuar në datën 10.02.2025, moment në të cilin atij i është dorëzuar kopja e vendimit gjyqësor për caktimin e masës së sigurimit. Ky vendim tregonte shkaqet e caktimit të masës dhe aktet kryesore ku bazoheshin ato shkaqe, dhe në zbatim të nenit 248 të

KPP-së, brenda afatit ligjor 3-ditor nga zbatimi i masës, është proceduar me marrjen në pyetje të kërkuarit, si person nën hetim dhe verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në burg” ndaj tij. Në seancën gjyqësore të datës 12.02.2025 GJKKO-ja e Shkallës së Parë u ka lënë mbrojtësve disa orë kohë për t`u njohur me aktet e fashikullit hetimor duke mbajtur në konsideratë se në datën 13.02.2025, ora 14:00, përfundonte afati ligjor për shqyrtimin e masës. Ky afat nuk rezultoi të jetë kundërshtuar, ndërkohë që kërkesa është mbështetur në nevojën për t`u njohur me mënyrën e marrjes së provave dhe burimin e tyre. Po kështu, rezultoi se mbrojtja kishte përgatitur paraprakisht parashtrimet e saj dhe provat mbështetëse për kundërshtimin e vendimit për caktimin e masës. Rezultoi, gjithashtu, se përpara asaj gjykate kërkuarit i është dhënë mundësia të parashtojë qëndrimin e tij në lidhje me masën dhe të kundërshtojë qëndrimin e prokurorisë.

46. Në datën 04.03.2025, mbi ankimin edhe të kërkuarit, çështja është regjistruar në GJKKO-në e Apelit dhe është shqyrtuar nga ajo gjykatë në seancat gjyqësore të datave 11-13.03.2025. Në këto seanca kanë marrë pjesë kërkuari dhe mbrojtësit e tij dhe ata janë dëgjuar dhe kanë paraqitur parashtrimet dhe provat në mbështetje të ankimit, të cilat janë administruar nga ajo gjykatë.

47. Gjykata, në kuptim të ruajtjes së ekuilibrit që duhet të ekzistojë ndërmjet shpejtësisë së kontrollit gjyqësor të heqjes së lirisë dhe së drejtës për mbrojtje efektive, vëren se në rastin konkret bëhet fjalë për një çështje me akte voluminoze, duke pasur parasysh numrin e personave nën hetim dhe natyrën e veprave penale për të cilat ata dyshohen. Këto akte dhe të dhënat e përfuara prej tyre kanë gjetur pasqyrim edhe në vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë për caktimin e masës së sigurimit ndaj kërkuarit, për sa kohë përbëjnë elementet thelbësore të arsyetimit të asaj gjykate. Kërkuari dhe mbrojtësit e tij janë vënë në dijeni të këtyre shkaqeve me njoftimin e vendimit të caktimit të masës së sigurimit, duke pasur që nga ky moment mundësinë për të kërkuar njohjen me aktet e hetimit dhe pajisjen me kopje të tyre. Në vijim, me kërkesën e tyre në seancë gjyqësore, gjykata u ka dhënë afat shtesë me qëllim konsultimin me aktet. Duke pasur parasysh urgjencën që shoqëron këto procedura, si dhe afatet e shkurtra kushtetuese dhe ligjore brenda të cilave duhet të realizohet kontrolli gjyqësor i heqjes së lirisë, Gjykata vlerëson se kufizimet që, për këtë shkak, mund të lindin në drejtim të disa garancive të nenit 42 të Kushtetutës, nuk kanë cenuar, në rastin konkret, ekuilibrin e drejtë ndërmjet kësaj garancie dhe së drejtës së kërkuarit për mbrojtje efektive.

48. Megjithëse koha e lënë nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka qenë e kufizuar në raport me volumin e akteve, Gjykata vëren se nuk rezulton që mbrojtja të jetë vënë në pamundësi reale për të parashtruar kundërshtimet e saj, për të paraqitur prova dhe për të ushtruar ankimin ndaj masës. Bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar rezulton se kërkuesi është dëgjuar si në shkallë të parë, ashtu edhe në gjykatën e apelit, si personalisht ashtu edhe përmes mbrojtësve të tij, duke parashtruar pretendime në lidhje me mungesën e kritereve dhe kushteve për zbatimin e masës së sigurimit, si dhe për papërshtatshmërinë e saj. Gjykata, duke pasur parasysh se e drejta e mbrojtjes efektive është në funksion edhe të së drejtës së ankimit efektiv në gjykatë, vëren se kërkuesi, përmes mbrojtësve të tij, e ka ushtruar këtë të drejtë, çka është konsideruar se përbën një element rikuperues të kufizimit objektiv në tërësinë e kësaj procedure (*shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesit, nëpërmjet mbrojtësve të tij, brenda afateve kushtetuese dhe ligjore për kontrollin gjyqësor të heqjes së lirisë, i është siguruar akses efektiv në aktet e procedimit dhe kohë e arsyeshme për shqyrtimin e tyre, për aq sa lejonte natyra urgjente e procedurës dhe pa cenuar thelbin e së drejtës së mbrojtjes. Në këtë mënyrë, është ruajtur ekuilibri i drejtë ndërmjet shpejtësisë së kontrollit gjyqësor të heqjes së lirisë dhe së drejtës për mbrojtje efektive.

50. Po kështu, për sa i përket pretendimit të kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes për shkak të mospasjes së kohës së mjaftueshme për t'u njohur dhe për të debatuar në lidhje me provat e paraqitura nga Prokuroria e Posaçme në GJKKO-në e Apelit, Gjykata vlerëson se ai është, gjithashtu, i pabazuar. Mbrojtësit e kërkuesit janë njohur me apelin kundërshtues të Prokurorisë së Posaçme dhe aktet bashkëlidhur atij, si dhe me provat e paraqitura rishtazi nga organi i akuzës përpara asaj gjykate. Në këtë mënyrë, ata kanë pasur mundësinë të kundërshtojnë si administrimin e tyre nga gjykata dhe mënyrën e zbatimit të dispozitave procedurale penale të zbatueshme në këtë drejtim, ashtu edhe të debatojnë në lidhje me përmbajtjen e tyre. Për më tepër, kërkuesi ka pasur mundësi t'i parashtrorë këto pretendime edhe në Gjykatën e Lartë, e cila i ka gjetur të pabazuara, duke dhënë argumentet e saj në këtë drejtim.

51. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e së drejtës së mbrojtjes në drejtim të kohës për t'u njohur me aktet dhe provat është i pabazuar.

B.1.1.2. Për të drejtën për të komunikuar lirisht me mbrojtësin

52. Sipas kërkesit, në gjykimin në shkallë të parë dhe në apel ai ka qëndruar i izoluar në kafaz sigurie/kabinë xhami, duke i kufizuar ndjeshëm mundësinë për të komunikuar lehtësisht me mbrojtësit e zgjedhur. Ai ka pretenduar se në seancën e datës 11.03.2025, në gjykatën e apelit, mbrojtja ka kërkuar largimin e tij nga kabina e xhamit dhe lejimin e kërkesit që të qëndronte pranë mbrojtësve, kërkesë që është rrëzuar me justifikimin se kjo ishte praktikë në ato gjykata dhe se mungonte infrastruktura e përshtatshme.

53. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme*, nuk ka paraqitur prapësime në lidhje me këtë pretendim të kërkesit.

54. Gjykata vëren se sipas GJEDNJ-së, një masë izolimi në sallën e gjyqit mund të ndikojë në drejtësinë e procesit gjyqësor, duke cenuar të drejtën e të pandehurit për të marrë pjesë efektivisht në të (*shih Svinarenko dhe Slyadnev kundër Rusisë [DHM], datë 17.07.2014, § 134*). Shqetësimet për sigurinë në një seancë gjyqësore penale mund të justifikojnë, veçanërisht në një çështje me shtrirje të gjerë ose delikate, përdorimin e rregullimeve të veçanta, përfshirë kabinat prej xhami. Megjithatë, duke pasur parasysh rëndësinë që ka e drejta e mbrojtjes, çdo masë që kufizon pjesëmarrjen e të pandehurit në proces ose vendos kufizime në marrëdhënien e tij me mbrojtësit duhet të vendoset vetëm në masën e nevojshme dhe të jetë në përpjesëtim me rreziqet në një rast specifik. GJEDNJ-ja ka konsideruar shkelje pamundësinë e aplikantit për të pasur shkëmbime konfidenciale me avokatin e tij gjatë procesit për shkak të vendosjes së tij në një kabinë xhami, si dhe dështimin e gjykatës për të vlerësuar ndikimin e këtyre rregullave të sallës së gjyqit në të drejtën e mbrojtjes (*shih Yaroslav Belousov kundër Rusisë, datë 04.10.2016, §§ 150, 151-154*).

55. Sipas GJEDNJ-së, në kuptim të së drejtës së mbrojtjes “lehtësitë” që i ofrohen një të pandehuri përfshijnë edhe mundësinë për t`u konsultuar me avokatin e tij (*shih Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 28.06.1984, § 99; Goddi kundër Italisë, datë 07.12.1984, § 31*), i cili është thelbësor për përgatitjen e mbrojtjes (*shih Bonzi kundër Zvicrës, vendimi i Komisionit, datë 12.07.1978; Can kundër Austrisë, raport i Komisionit, datë 12.07.1984, § 52*). Kështu, në kuptim të së drejtës për të pasur kohën dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se mund të ngrihet një çështje sipas nenit 6, pika 3, shkronja “b”, të KEDNJ-së, nëse vendosja e një të pandehuri në një kabinë xhami gjatë seancës dëgjimore

pengon konsultimin e tij efektiv me një avokat (*shih Yaroslav Belousov kundër Rusisë, datë 04.10.2016, §§ 148-153*).

56. Gjykata, në këndvështrim të këtyre standardeve, si dhe duke ritheksuar se garancitë që ofron e drejta për proces të rregullt ligjor, gjejnë zbatim edhe në proceset gjyqësore që vendosin për kufizimin e lirisë personale, do të vlerësojë nëse qëndrimi i kërkuesit i izoluar në një kabinë xhami gjatë procesit gjyqësor në gjykatat e faktit ka sjellë pamundësinë e tij për të komunikuar me mbrojtësit, me qëllim garantimin e një mbrojtjeje efektive.

57. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar, vëren se në seancën gjyqësore të datës 12.02.2025 në GJKKO-në e Shkallës së Parë, gjatë vleftësimit të masës, kërkuesi është njohur me të drejtën për t`u pyetur dhe është ftuar të konsultohet me avokatin nëse do të japë shpjegime, për të cilën kërkuesi është përgjigjur se është konsultuar dhe se mezi pret të japë deklaratën e tij pasi të flasë mbrojtësi. Gjatë atij procesi nuk rezulton të ketë pasur pretendime nga kërkuesi ose mbrojtja në lidhje me qëndrimin e kërkuesit të izoluar ose në drejtim të pamundësisë për të komunikuar me mbrojtësin. Në gjykimin në GJKKO-në e Apelit, në seancën e datës 11.03.2025, gjatë parashtrimit të kërkesave paraprake, njëri nga mbrojtësit e kërkuesit ka kërkuar që ai të qëndronte pranë tyre, bazuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, duke e konsideruar këtë si trajtim çnjerëzor, për sa kohë ai prezumohet i pafajshëm deri në dhënien e një vendimi gjyqësor të formës së prerë për fajësinë e tij. Përfaqësuesi i Prokurorisë së Posaçme është shprehur përpara gjykatës se kjo nuk ishte kërkesë paraprake dhe se një praktikë e tillë ndiqej edhe në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, pa ndikuar në pjesëmarrjen aktive në proces. Në përgjigje të kësaj kërkesë të mbrojtjes, gjykata e apelit është shprehur se kjo është praktikë e ndjekur nga GJKKO-të e Shkallës së Parë e të Apelit dhe lidhej me infrastrukturën e gjykatës, prandaj gjykimi do të vijojë në këto kushte për personat me masë sigurimi “Arresti në burg”.

58. Gjykata, duke e vlerësuar këtë pretendim, në kuadër të kësaj nënçështjeje vetëm në drejtim të garantimit të së drejtës së mbrojtjes efektive, vëren se nuk rezulton që gjatë procesit kërkuesi të jetë vënë në pamundësi për të komunikuar ose për t`u konsultuar me mbrojtësit e zgjedhur, me qëllim realizimin e një mbrojtjeje efektive në procesin penal. Po ashtu, nuk rezulton që ai të ketë ngritur një shqetësim të tillë konkret për pamundësinë e komunikimit me mbrojtësit. Pretendimi i mbrojtësve është paraqitur kryesisht në drejtim të trajtimit çnjerëzor dhe cenimit të dinjitetit, i lidhur edhe me prezumimin e pafajësisë, çështje që do të trajtohet në vijim si pretendim

i mëvetshëm. Kërkuesi ka kërkuar dhe është lejuar nga gjykata, si në shkallë të parë ashtu edhe në apel, që të deklarojë dhe parashtojë qëndrimin e tij në lidhje me verifikimin e kriterëve ligjore që justifikojnë masën kufizuese të lirisë të caktuar ndaj tij. Po kështu, gjykata e apelit ka marrë në shqyrtim edhe kërkesën për qëndrimin e kërkuesit pranë mbrojtësit të tij gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore, duke parashtruar edhe arsyet se përse kjo kërkesë nuk mund të pranohej. Nga aktet e dosjes gjyqësore nuk rezulton ndonjë rast konkret kur kërkuesit t'i jetë refuzuar konsultimi, kur ai nuk ka dëgjuar mbrojtësin, nuk ka mundur t'u japë udhëzime ose i është mohuar e drejta për të pasur një pushim ose kohë për t'u konsultuar me ta. Për rrjedhojë, nuk rezulton që mënyra e vendosjes së kërkuesit në sallën e gjykimit ta ketë vënë atë në pamundësi reale për të dhënë udhëzime, për t'u konsultuar me mbrojtësin, pra për të ushtruar efektivisht të drejtën e mbrojtjes.

59. Gjykata, duke pasur parasysh se procesi i gjykimit kushtetues është i natyrës argumentuese, çka nënkupton se u takon palëve të parashtrajnë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre (*shih vendimet nr. 57, datë 25.07.2017; nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 45, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*), vlerëson se për sa kohë që nuk konstatohet, në këndvështrimin kushtetues, se në ç'mënyrë kjo formë e zhvillimit të seancës gjyqësore e ka vënë kërkuesin në pamundësi objektive për të komunikuar lirisht me mbrojtësin gjatë seancës apo për t'u konsultuar me të me qëllim ushtrimin e një mbrojtjeje efektive, edhe ky pretendim konsiderohet i pabazuar. Gjykata çmon të theksojë se kërkuesi ka qenë i pranishëm në seancat e zhvilluara, është lejuar të deklarojë dhe të parashtojë qëndrimin e tij dhe nuk rezulton të ketë treguar ndonjë pengesë konkrete që e ka bërë komunikimin me mbrojtësit objektivisht të pamundur ose joefektiv.

60. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes edhe për këtë argument është i pabazuar.

B.1.2. Për parimin reformatio in peius (mosrëndimi i pozitës)

61. Sipas kërkuesit, ky parim është cenuar për shkak të pranimit për shqyrtim nga gjykata e apelit të provave të reja të kërkuara nga prokuroria në seancën e datës 11.03.2025, që konsistonin në disa komunikime mes kërkuesit dhe personave të tjerë, të përgjuara me autorizimin e GJKKO-së në periudhën shkurt-mars të vitit 2025, pas vendosjes në paraburgim të kërkuesit, edhe pse kjo

është kundërshtuar nga mbrojtja. Sipas tij, lejimi i paraqitjes së këtyre provave të reja nga pala që nuk kishte ushtruar ankim, bie ndesh edhe me nenin 425, pika 3, të KPP-së.

62. Sipas subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme, ky pretendim është i pabazuar, pasi gjykata e apelit ka arsyetuar se disponimi i saj është në përputhje me parashikimet e KPP-së, ndërkohë që si personat nën hetim, ashtu edhe prokurorët kanë kërkuar marrjen e provave të reja, një pjesë e të cilave bashkëlidhur ankimit dhe apelit kundërshtues dhe një pjesë u kërkuar rishtazi në seancë. Për sa u përket provave bashkëlidhur mjetit origjinal/apelit dhe mjetit të prejardhur/apelit kundërshtues, gjykata e apelit ka zbatuar pikën 1 të nenit 427 të KPP-së, ndërsa për provat e reja, parashikimet e pikës 2 të këtij neni. Sipas këtij subjekti, qëndrimi i gjykatës së apelit është gjetur i drejtë edhe nga Gjykata e Lartë.

63. Parimi *reformatio in peius* (i mosrëndimit të pozitës të të pandehurit) parashikohet në legjislacionin procedural penal dhe konkretisht në nenin 425, pika 3, të KPP-së, sipas të cilit: “Kur apelu është vetëm i pandehuri, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë ... dhe as t’i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë.”. Ky parim është i lidhur me garancinë e aksesit në gjykatë si element i procesit të rregullt dhe zbatimi i tij është një garanci më shumë për të gjykuarin, me qëllim që ai të realizojë në mënyrë efektive të drejtën për t’iu drejtuar me ankim gjykatës. Ekzistenca e këtij parimi u jep mundësi të gjykuarve që të mos heqin dorë nga garancitë që ofron Kushtetuta vetëm nga frika se mund të dëmtohen rëndë interesat e tyre (*shih vendimin nr.15, datë 22.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndalimi i *reformatio in peius* (mosrëndimi i pozitës) është, gjithashtu, një çështje e *favor defensionis* (garanci në favor të mbrojtjes) dhe për këtë arsye konsiderohet i lidhur ngushtë me parimin e mbrojtjes në procesin penal.

64. Pas shqyrtimit të këtij pretendimi, në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje në lidhje me (pa)bazueshmërinë e tij në themel, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

65. Sipas një qëndrimi¹, disponimi i gjykatës së apelit për marrjen e provave të reja në atë gjykim, të paraqitura nga prokuroria si subjekt joapelues, është në përputhje me nenin 248, pika 4, të KPP-së, që parashikon se gjatë seancës së marrjes në pyetje të personit, palët kanë të drejtë të paraqesin prova, me përjashtim të atyre me dëshmitarë. Kjo dispozitë është e zbatueshme në të

¹ Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini dhe Asim Vokshi.

njëjtën mënyrë edhe gjatë seancës që zhvillohet në gjykatën e apelit, pasi edhe gjykata e apelit, njësoj si ajo e shkallës së parë, është gjykatë që shqyrton çështjen si për aspektet ligjore, ashtu edhe për ato faktike, që lidhen me kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit. Sipas nenit 249, pika 6, të KPP-së gjykata e apelit mund të vendosë, ndër të tjera, edhe miratimin e vendimit për arsye të ndryshme nga ato që janë parashtruar ose nga ato që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit të ankimuar. Kjo nënkupton se, për sa kohë mund të miratohet vendimi edhe për arsye të tjera ligjore ose faktike, të papërmendura nga gjykata e shkallës së parë, kjo mund të bëhet edhe për të njëjtat arsye që ka dhënë shkalla e parë, veçse të para në dritën e rrethanave (provave) të reja të dala gjatë gjykimit në apel. Nga ana tjetër, sipas neneve 425, pika 3 dhe 244, pika 3, të KPP-së, parimi i mosrëndimit të pozitës të të pandehurit në rastin e masave të sigurimit ka të bëjë vetëm me pamundësinë e gjykatës që të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori, por jo edhe për arsyet ligjore apo faktike mbi të cilat mbështetet arsyetimi i gjykatës së apelit për miratimin e masës së sigurimit të caktuar nga gjykata e shkallës së parë.

66. Në rastin konkret, prokuroria kishte kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” dhe gjykata e kishte pranuar atë duke dhënë edhe arsyet përkatëse, një ndër të cilat ishte rreziku i “helmimit” të provave. Meqë në ankim personi nën hetim kishte ngritur pretendime para gjykatës së apelit në lidhje me këtë element, prokuroria, si paraqitëse e një apeli kundërshtues, ka prapësuar duke kërkuar marrjen e provave të dala pas seancës në shkallë të parë, që lidhen me disa komunikime të personit nën hetim, që provonin se mundësia e “helmimit” të provave ishte e vërtetë dhe jo thjesht një hipotezë. Në këtë kontekst, marrja e provave dokumentare të sjella në apel nga prokuroria në mbështetje të qëndrimit të vet, është realizuar konform parashikimeve të KPP-së dhe nuk ka sjellë rëndim të pozitës për kërkuesin. Ato lidheshin me nevojat e sigurimit të trajtuara në shkallë të parë, ndonëse për arsye faktike të ndryshme nga ato të parashtruara dhe treguara në pjesën arsyetuese të atij vendimi, pasi faktet (përgjimi i komunikimit të personit nën hetim) janë dokumentuar në periudhën kohore pas vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë dhe para shqyrtimit të ankimit në apel. Neni 249, pika 6, i KPP-së ia njeh shprehimisht të drejtën gjykatës së apelit që të vendosë në lidhje me ankimin edhe duke u bazuar në arsye (të cilat nga ana e tyre bazohen në fakte të caktuara) të ndryshme nga ato që janë parashtruar ose nga ato që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndaj pretendimi për rëndimin e pozitës së kërkuesit është i pabazuar.

67. Gjykata ka pranuar se ekzistenca e shkaqeve që lejojnë kufizimin e lirisë duhet të argumentohet nën dritën e rrethanave të çështjes, historikut dhe personalitetit të të dyshuarit, duke parashtruar argumente thelbësore dhe arsyetimi i gjykatave në këtë drejtim nuk mund të jetë abstrakt, i përgjithshëm ose stereotip (*shih vendimin nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto standarde, me qëllim vlerësimin dhe verifikimin e individualizuar të ekzistencës së shkaqeve të heqjes së lirisë dhe të nevojave të sigurimit, nuk ka asnjë ndalim procedural për palët që kur vijnë në dijeni të rrethanave që mund të ndikojnë në vlerësimin e gjykatës që po shqyrton çështjen në apel, ta informojnë atë duke paraqitur edhe provat e lejueshme mbi të cilat bazohet një pretendim i tillë. Për më tepër, ky pretendim ka gjetur përgjigje të arsyetuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka vlerësuar se secila nga palët në proces ka kërkuar marrjen e provave të reja, si bashkëlidhur ankimeve, ashtu edhe në seancë, për marrjen e të cilave gjykata e apelit ka vepruar në zbatim të parashikimeve të pikave 1 dhe 2 të nenit 427 të KPP-së. Ky arsyetim i gjykatave në lidhje me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të dispozitave procedurale nuk është alogjik ose i paarsyeshëm, pra nuk vë në dyshim vetë thelbin e së drejtës për gjykim të drejtë. Për rrjedhojë, sipas këtij qëndrimi, pretendimi i kërkuesit në këtë drejtim është i pabazuar.

68. *Sipas një qëndrimi tjetër²*, gjykata e apelit ka marrë provat e paraqitura rishtazi nga Prokuroria e Posaçme në seancë gjyqësore, edhe pse ky subjekt nuk kishte paraqitur ankim ndaj vendimit të shkallës së parë por ka paraqitur vetëm ankim kundërshtues ndaj atij të paraqitur nga personat nën hetim. Fakti i pranimit të provave të paraqitura rishtazi nga organi i akuzës, si pala që nuk kishte investuar gjykatën e apelit për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, në dukje mund të mos vërë në dyshim vetë thelbin e parimit *reformatio in peius*, për sa kohë që masa e arrestit për kërkuesin është lënë në fuqi, pra nuk është ndryshuar me efekt përkeqësues. Megjithatë rezulton se është mbi bazën e këtyre provave të reja, me të cilat kërkuesi është njohur gjatë atij procesi, pavarësisht kohës së lënë në dispozicion për këtë qëllim, që gjykata e apelit ka vlerësuar, në drejtim të ekzistencës së kushteve dhe kritereve për caktimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit, disa elemente të rëndësishme siç janë ato për rrezikun e kërkuesit, rrezikun e ndikimit të tij në prova apo edhe bashkëpunimin e tij me personat e tjerë në hetim. Është mbi bazën e këtyre provave të marra rishtazi që GJKKO-ja e Apelit ka arritur në përfundimin se nevojat e sigurimit jo vetëm që vijnë në të njëjtën masë, por, për më tepër, ka një rrezik

² Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahimimi.

të shtuar veçanërisht në drejtim të ndikimit dhe helmimit të provave, për shkak të dyshimit se kërkuesi mund të ndikojë në mbi personat që kishin dijeni për rrethanat e çështjes. Për rrjedhojë, të dhënat e rezultuara nga këto prova janë marrë parasysh si faktorë në vlerësimin e rrezikut të ndikimit negativ të kërkuesit në proces.

69. Në lidhje me këtë pretendim të kërkuesit konstatohet se ai është analizuar nga Gjykata e Lartë, e cila e ka gjetur të pabazuar, duke vlerësuar se e drejta e palëve për të paraqitur prova edhe në gjykimin në apel (përveç provës me dëshmitarë) është e garantuar nga pikat 3 dhe 4 të nenit 248 të KPP-së, pra se kjo e drejtë mund të ushtrohet edhe gjatë debatit gjyqësor për verifikimin e kushteve dhe kritereve të masës së sigurimit në atë shkallë gjykimi. Nga ana tjetër, në analizë të përmbajtjes së nenit 423 të KPP-së, sipas Gjykatës së Lartë ligji procedural penal nuk ndalon në mënyrë të shprehur ushtrimin e kësaj të drejte të palëve gjatë gjyimit të masave të sigurimit personal, duke mbajtur ajo në konsideratë edhe natyrën e këtyre lloj procesesh, që karakterizohen nga natyra dinamike e hetimeve paraprake dhe urgjenca e gjyimit.

70. Sipas këtij qëndrimi, edhe pse Gjykata e Lartë e ka marrë në shqyrtim këtë pretendim të kërkuesit duke e rrëzuar atë, vlerësimi i saj ka qenë formal, duke mos ushtruar ajo gjykatë funksionin e saj në interpretimin përfundimtar të dispozitave ligjore nga gjykatat e zakonshme dhe raportin mes tyre, pra duke mos i dhënë përgjigje shteruese raportit mes nenit 248 të KPP-së dhe dispozitave të përgjithshme që janë të zbatueshme në gjykimin në apel. Kjo duke pasur parasysh këtu edhe qasjen e vetë gjykatës së apelit, e cila për këtë aspekt të procesit gjyqësor të gjyimit të masave të sigurimit ka gjetur se janë të zbatueshme disa dispozita të KPP-së që rregullojnë gjykimin e themelit (nenet 426/a, pika 5 dhe 427, pikat 1, 2 dhe 3), kurse për aspekte të tjera, siç ishte kërkesa e mbrojtjes për shtyrje të seancës, ka gjetur se këto dispozita (neni 427, pika 5, i KPP-së) nuk janë zbatueshme. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim kishte të bënte me ushtrimin nga Gjykata e Lartë të funksionit të saj kushtetues si gjykatë e ligjit dhe mbartte nevojën për të sqaruar në mënyrë përfundimtare mënyrën e zbatimit të dispozitave të KPP-së që rregullojnë gjykimin e themelit në gjykatën e apelit edhe ndaj masave të sigurimit, në raport me regjimin e posaçëm të nenit 248 të KPP-së. Në këto kushte, sipas këtij qëndrimi kërkuesit i është cenuar edhe e drejta për të pasur një vendim të arsyetuar nga Gjykata e Lartë.

71. Sipas qëndrimit tjetër³, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit *reformatio in peius* nuk lidhet thjesht me faktin se gjykata e apelit ka arsyetuar për nevojat e sigurimit, por me pranimin për shqyrtim të provave të reja të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme në gjykimin në apel. Sipas kërkuesit, këto prova nuk duhet të ishin marrë nga gjykata e apelit, pasi prokuroria nuk kishte ushtruar ankim që të legjitimonte paraqitjen e tyre, ndërsa pranimi dhe përdorimi i këtyre provave ka sjellë përkeqësimin e pozitës së tij procedurale.

72. Në këtë drejtim, sipas këtij qëndrimi, duhej mbajtur parasysh se parimi *reformatio in peius* është, në radhë të parë, parim i së drejtës procedurale penale. Ai nuk parashikohet shprehimisht si parim i mëvetshëm në Kushtetutë ose në KEDNJ. Megjithatë, në përmbajtjen e tij substanciale, ky parim lidhet ngushtë me të drejtën e ankimit, si e drejtë kushtetuese, dhe me efektivitetin e ushtrimit të saj. Qëllimi i tij është të garantojë që personi që ushtron ankim të mos dekurajohet nga frika se, vetëm për shkak të vënies në lëvizje të gjykatës më të lartë, pozita e tij mund të rëndohet në mungesë të një ankimi të vlefshëm nga pala tjetër. Në këtë kuptim, sipas këtij qëndrimi, ndonëse pretendimi i kërkuesit nuk paraqitet si rast tipik i *reformatio in peius*, për sa kohë masa e sigurimit nuk është rënduar formalisht, ai lidhet me logjikën mbrojtëse të këtij parimi dhe me efektivitetin e ankimit ndaj masës së sigurimit. Kjo pasi kërkuesi pretendon se, në kuadër të gjykimin të vënë në lëvizje nga ankimi i tij dhe apeli kundërshtues i prokurorisë, gjykata e apelit ka pranuar dhe përdorur prova të reja të paraqitura nga organi i akuzës, të cilat, sipas tij, kanë përkeqësuar pozitën e tij procedurale. Për pasojë, ky pretendim, në thelb, ngre çështje që lidhen me kufijtë e shqyrtimit në apel, bazën ligjore për pranimin e provave të reja në këtë fazë, si dhe garancitë e mbrojtjes efektive, kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve.

73. Gjykata e Lartë, në shqyrtimin e këtij pretendimi të ngritur në rekursin e kërkuesit, ka arsyetuar se neni 248, pikat 3 dhe 4, i KPP-së u njeh palëve, pra edhe organit të prokurorisë, të drejtën për të paraqitur prova gjatë debatit gjyqësor për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të masës së sigurimit, me përjashtim të provave me dëshmitarë, dhe se kjo mundësi nuk përjashtohet as në gjykimin në shkallë të dytë. Po ashtu, ajo i është referuar nenit 423 të KPP-së për apelin kundërshtues, duke vlerësuar se edhe pse në lëndën e masave të sigurimit ligji procedural nuk e parashikon në mënyrë të drejtpërdrejtë këtë mjet, ai nuk e ndalon ushtrimin e tij. Mbi këtë bazë, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se, për shkak të natyrës dinamike të hetimeve paraprake dhe urgjencës

³ Votoi sipas këtij qëndrimi gjyqtari Ilir Toska.

që karakterizon gjykimin në lëndën e masave të sigurimit, palët mund të paraqesin prova edhe përpara gjykatës së apelit, pavarësisht nëse kanë ushtruar ose jo ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

74. Megjithatë, sipas këtij qëndrimi, ky arsyetim nuk i jep përgjigje të plotë dimensionit kushtetues të pretendimit të kërkuarit. Gjykata e Lartë duhej të kishte vlerësuar, së pari, nëse marrja e provave të reja nga gjykata e apelit kishte bazë të qartë ligjore, pavarësisht natyrës së apelit kundërshtues dhe raportit ndërmjet nenit 248 të KPP-së dhe dispozitave të përgjithshme për gjykimin në apel. Së dyti, nëse pranimi i këtyre provave konsiderohej i lejueshëm, ajo duhej të kishte vlerësuar nëse mbrojtjes së kërkuarit i ishte dhënë mundësi reale dhe efektive për t'u njohur, për t'u konsultuar dhe për t'i kundërshtuar ato, veçanërisht nëse këto prova ishin përdorur në mënyrë përcaktuese për lënien në fuqi të masës së arrestit. Kjo ka qenë veçanërisht e nevojshme për sa kohë, në pranimin e provave të paraqitura nga prokuroria, gjykata e apelit u ishte referuar edhe neneve 426/a, pika 5 dhe 427, pikat 1, 2 dhe 3, të KPP-së, ndërkohë që kërkesën e mbrojtjes për shtyrjen e seancës, me qëllim njohjen me këto prova, e kishte rrëzuar me arsyetimin se neni 427, pika 5, i KPP-së zbatohet në gjykimin e çështjes në themel (*shih paragrafin 43 të vendimit*).

75. Për rrjedhojë, sipas këtij qëndrimi, Gjykata e Lartë duhej të kishte sqaruar nëse dhe në çfarë mase dispozitat KPP-së për ankimin dhe shqyrtimin në apel, të cilat për nga vendosja sistematike duket se lidhen me gjykimin e çështjes në themel, janë të zbatueshme edhe në gjykimin e masës së sigurimit, ose nëse pranimi i provave të reja mbështetet vetëm në regjimin e posaçëm të nenit 248 të KPP-së. Po ashtu, ajo duhej të kishte vlerësuar nëse përdorimi i këtyre dispozitave vetëm për pranimin e provave, por jo edhe për garantimin e kohës së nevojshme të mbrojtjes për t'u njohur me to, ishte i pajtueshëm me parimet e kontradiktoritetit, barazisë së armëve dhe mbrojtjes efektive. Në këtë kuadër, Gjykata e Lartë duhej të kishte vlerësuar nëse pranimi dhe përdorimi i provave të reja të paraqitura nga prokuroria në apel, pas vendosjes së kërkuarit në paraburgim dhe në kushtet kur prokuroria nuk kishte ushtruar ankim fillestar ose të pavarur, ka sjellë ose jo përkeqësim të pozitës së tij procedurale në kuptim të garancive të mbrojtjes. Ajo duhej të kishte vlerësuar, gjithashtu, nëse mbrojtjes i ishte garantuar mundësi reale dhe efektive për t'u njohur, për t'u konsultuar dhe për të debatuar për këto prova, veçanërisht në kushtet kur kërkesa për shtyrjen e seancës për këtë qëllim ishte rrëzuar.

76. Për sa më sipër, sipas këtij qëndrimi, duke mos i dhënë përgjigje të plotë dhe të mjaftueshme këtij pretendimi thelbësor të kërkuesit, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Për këtë arsye, në respektim edhe të parimit të subsidiaritetit, vendimi i saj duhet të shfuqizohej dhe çështja t'i dërgohej asaj për shqyrtim, me qëllim që pretendimi i kërkuesit të vlerësohej në përputhje me standardet kushtetuese të aksesit, arsytimit të vendimit gjyqësor dhe garancive të mbrojtjes në procesin penal.

77. Për sa më sipër, në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, ky pretendim, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, konsiderohet i rrëzuar.

B.2. Për lirinë personale në aspektin substancial

78. Gjykata ka theksuar se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, konkretisht me lirinë personale (*shih vendimet nr. 51, datë 18.10.2023; nr. 19, datë 04.04.2023; nr. 40, datë 18.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas GJEDNJ-së, nëse gjykatat e brendshme nuk japin arsye të duhura ose japin vendime stereotipe të përsëritura që nuk japin përgjigje për argumentet e kërkuesit, kjo mund të passjellë cenimin e garancive të nenit 5, paragrafi 4, të KEDNJ-së. Për këtë arsye, ajo gjykatë (GJEDNJ-ja) duhet të sigurohet që argumentet e gjykatave të brendshme *pro* dhe *kundër* lirisë nuk duhet të jenë “të përgjithshme dhe abstrakte”, por të përmbajnë referenca për fakte specifike dhe rrethanat personale që justifikojnë masën e sigurimit (*shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, për të vlerësuar nëse masa e sigurimit plotëson kriteret kushtetuese, Gjykata verifikon nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në vendimet e tyre kanë arsyetuar për ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të nevojshme për kufizimin e lirisë personale.

79. Gjykata, sikurse u theksua më sipër, duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve të kërkuesit për cenimin e lirisë personale në aspektin substancial, vlerëson t'i shqyrtojë ato në vijim në dy aspekte: i) në drejtim të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova të lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë, në kuptim të mënyrës sesi ky standard është arsyetuar në raport me këtë

parim; ii) në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit, të lidhur edhe me ndikimin e saj në të drejtën për t'u zgjedhur.

B.2.1. Për dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova të lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë

80. Sipas kërkesit, gjykatat nuk kanë analizuar kriteret për caktimin e masës së sigurimit, në kuptim të nenit 228, pika 3, të KPP-së, në raport me nevojat konkrete për mbarëvajtjen e procedimit penal dhe argumentet e tyre përbëjnë gjykim vlerësues për fajësinë përpara se ajo të provohet, për më tepër kur ai nuk është akuzuar për një vepër penale të dhunshme, ka karakter të mirë, pozitë të lartë në shoqëri etj. Gjykatat kanë zëvendësuar, sipas kërkesit, analizën e individualizuar të rrezikut, të lidhur me sjelljen e personit, karakterin, lidhjet familjare, gjendjen ekonomike dhe lidhjet me vendin e banimit, me një përfundim abstrakt të nxjerrë nga “pozita e zyrtarit”. Po sipas tij, përdorimi i gjuhës së fajësisë në një fazë paraprake ka shndërruar analizën e rrezikut në një akt dënimi të parakohshëm dhe ka transferuar barrën e provës te kërkuesi, duke iu kërkuar të provojë se nuk është i prirur të përsërisë një krim të paprovuar ende. Vlerësimi i GJKKO-së së Apelit se bashkëpunimi me të hetuarit e tjerë ka tiparet e një bashkëpunimi të posaçëm, atij të grupit të strukturuar kriminal, pavarësisht se nuk merret në konsideratë në këtë fazë të procesit, përbën pasqyrim të bindjes së asaj gjykate dhe rëndim të nevojave të sigurimit. Gjykatat, vijon kërkuesi, i kanë kufizuar lirinë pa ligj, e kanë trajtuar fajtor pa dënim, kanë parashikuar rrezikun mbi baza imagjinare dhe kanë përdorur gjuhën e akuzës si arsytim gjyqësor. Sipas tij, kur gjykata flet për “ambientin ku banon”, “përfitimet e parregullta të titullarit të Bashkisë”, “pasurimin personal”, “shpërfilljen ndaj fondeve publike” etj., ajo shpreh një bindje të formuar për fajësinë, gjuhë që i atribuon atij sjellje dhe qëllime kriminale pa vendim gjyqësor të formës së prerë. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat nuk kanë verifikuar në mënyrë konkrete ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, por janë mbështetur në supozime të organit procedues, në vlerësime të përgjithshme për statusin dhe pozicionin e tij publik. Kërkuesi ka kundërshtuar edhe bazueshmërinë faktike të episodeve konkrete mbi të cilat është ndërtuar dyshimi për kryerjen e veprave penale, duke pretenduar se gjykatat e zakonshme nuk kanë analizuar provat për rolin e tij në projektet artistiko-kulturore, për udhëtimin në Rotterdam, për pasurinë në Qerret dhe për të dhënat e tabulateve telefonike. Këto rrethana, sipas tij, tregojnë se dyshimi i arsyeshëm

nuk mbështetet në një bazë objektive faktike, por në interpretime të njëanshme dhe të papërshtatshme për të justifikuar masën ekstreme të arrestit në burg.

81. Sipas subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme, gjykatat kanë konkluduar se dyshimi i arsyeshëm bazohet në provat financiare dokumentare, deklaratimet e dëshmitarëve, materialet mbështetëse të ndërthurura, aktet e ekspertimit etj. Çështja penale ndaj kërkuesit ka kaluar tashmë në gjyq, çka provon, më së paku, ekzistencën, edhe aktualisht, të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se ai ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar. Sipas këtij subjekti, gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë shteruese për ekzistencën e “dyshimit të arsyeshëm”, si dhe shkaqet e “rëndësishme” dhe “të mjaftueshme” për justifikimin e kufizimit të lirisë personale të kërkuesit dhe argumentet e tyre nuk janë abstrakte, por të mbështetura në një *modus operandi* që kërkuesi dhe bashkëshortja e tij veçanërisht kanë ndërtuar dhe vënë në zbatim me qëllim marrjen e përfitimeve të parregullta. Ndërhyrjet procedurale që kanë ndodhur pas arrestimit të kërkuesit nuk janë argumentuar nga gjykatat në mënyrë abstrakte, por mbi bazën e provave të mbledhura dhe të paraqitura në seancë gjyqësore nga organi procedues. Sipas subjektit të interesuar, kërkuesi emërton si kategori ekstra ligjore ato pjesë të vendimeve të gjykatave të cilat i përkasin arsytimit të tyre dhe që shërbejnë për të arritur në përfundimin se plotësohen kushtet e ligjit procedural penal pasi ekzistojnë rrethanat: (i) që tregojnë për rrezikun e marrjes ose vërtetësisë së provës, i cili duhet të bazohet në rrethana fakti dhe të tregohen posaçërisht në arsytimin e vendimit; (ii) që dëshmojnë për rrezikun e largimit; (iii) të personalitetit të kërkuesit që tregojnë se ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose e të njëjtit lloj me atë të cilin procedohet; (iv) ato rënduese sipas 50 të KP-së, që merren parasysh në caktimin e masës sipas nenit 229, pika 2, të KPP-së. Kërkuesi, mbi bazën e deformimeve dhe shkëputjes mekanike të togfjalëshave nga arsytimi i vendimeve gjyqësore ka ndërtuar një linjë mbrojtjeje që duket se kërkon të implikojë dhe komprometojnë ndjekjen penale. Po sipas subjektit të interesuar, sjellja e kërkuesit, që dëshmon për intimidim drejtpërdrejt të oficerit të BKH-së, tregon se për të adresuar pakënaqësitë për veprimet e një punonjësi shtetëror kërkuesi nuk ka zgjedhur rrugën institucionale, por kontaktin personal intimidues, e veshur kjo me lirinë e shprehjes. Për sa i përket arsytimit të GJKKO-së së Apelit për formën e bashkëpunimit të personave në hetim, subjekti i interesuar ka prapësuar se një formë e tillë bashkëpunimi nuk u është atribuar ende atyre, për rrjedhojë nuk merret në konsideratë nga gjykata në caktimin e llojit dhe masës së sigurimit.

82. Neni 27 i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (paragrafi 1), ndërsa liria e personit mund të kufizohet kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale (paragrafi 2, shkronja “c”). Qëllimi kryesor i kësaj dispozite është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një “shoqëri demokratike”. Kërkesa “dyshime të arsyeshme” për kryerjen e veprës penale që justifikon kufizimin e lirisë personale të individit, nënkupton ekzistencën e fakteve ose të informacioneve që arrijnë të bindin edhe një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale, të cilat nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato për të cilat nevojitet ngritja e akuzës ose justifikimi i dënimit penal, që i përkasin një shkalle të mëvonshme të procesit të hetimit penal (*shih vendimin nr. 7, datë 28.01.2026 të Gjykatës Kushtetuese*).

83. Po sipas Gjykatës, në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, rastet dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar nga KPP-ja, ku në rastin e caktimit të masës së sigurimit, neni 228, pika 1, i saj, në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, përcakton si kusht të domosdoshëm (*sine qua non*) ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individi ka kryer një veprë penale (*shih vendimet nr. 86, datë 20.12.2024; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 19, datë 04.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

84. Mosbërja e një hetimi të vërtetë nga ana e autoriteteve për faktet e çështjes, për të verifikuar nëse kufizimi i lirisë është bërë mbi bazën e një dyshimi të arsyeshëm, do të përbënte cenim të nenit 27 të Kushtetutës. Për të vlerësuar nëse është respektuar standardi i dyshimit të arsyeshëm që kërkohet për arrestimin e një individi, mbahet në konsideratë konteksti i përgjithshëm i fakteve të çështjes, duke përfshirë këtu edhe statusin/personalitetin e kërkuesit, kronologjinë e ngjarjeve, mënyrën në të cilën është kryer hetimi dhe sjelljen e autoriteteve (*shih vendimet nr. 7, datë 28.01.2026; nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

85. Ndërsa në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë, si nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor, Gjykata ka theksuar se gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza.

Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Prezumimi i pafajësisë, i sanksionuar në nenin 30 të Kushtetutës dhe nenin 6, pika 2, të KEDNJ-së, është njëkohësisht një parim themelor i procesit penal dhe një e drejtë kushtetuese e konventore individuale për çdo individ, për të mos u paragjykuar si fajtor përpara dhënies së një vendimi gjyqësor përfundimtar në gjykimin për themelin e çështjes. Në reflektim të këtyre parimeve, neni 4, pika 1, i KPP-së parashikon se i pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. Sipas pikës 2 të këtij neni, gjykata jep vendim fajësie kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

86. Për sa i përket së drejtës për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradikcion të hapur ose të fshehtë dhe duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 48, datë 22.09.2025; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

87. Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur

gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka theksuar se Gjykata e Lartë, në kuadër të parimit të subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në shqyrtimin e pretendimeve të natyrës kushtetuese të ngritura në rekurs dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimin nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

88. Referuar thelbit të argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Gjykata do të analizojë faktin nëse gjykatat e zakonshme, nëpërmjet arsytimit të vendimit, kanë respektuar kriterin kushtetues të dyshimit të arsyeshëm si kusht *sine qua non* për justifikimin e kufizimit të lirisë personale të kërkuesit. Gjykata, bazuar në natyrën e pretendimeve të kërkuesit, do të vlerësojë nëse të dhënat, informacionet ose faktet që ishin në dispozicion të autoriteteve proceduese në kohën kur ndaj kërkuesit u vendos masa e sigurimit personal ishin ose jo të tilla që, në tërësinë e tyre, formojnë dyshimin e arsyeshëm për të justifikuar në rastin konkret kufizimin e lirisë së tij me masën “Arresti në burg”. Gjykata thekson, gjithashtu, se garancitë e nenit 27, pika 2, të Kushtetutës duhet të gëzohen të plota nga subjekti i procedimit penal pikërisht në kohën e caktimit të masave të sigurimit personal dhe çdo qëndrim i ndryshëm do të çonte në heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë personale. Nga ky vlerësim i Gjykatës do t’i jepet përgjigje edhe pretendimit të kërkuesit se gjykatat, përmes gjuhës së përdorur në vendimet e tyre, kanë paragjykuar fajësinë e tij përpara se ajo të vendoset me një vendim të formës së prerë.

89. Gjykata vëren se në datën 24.01.2025 Prokuroria e Posaçme ka kërkuar caktimin e masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues, ndër të tjera, edhe ndaj kërkuesit si person nën hetim. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 7/2025, ka vendosur caktimin ndaj kërkuesit të masës “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP-së. Sipas asaj gjykate, nga analiza e provave dhe fakteve ekziston dyshimi i arsyeshëm se kërkuesi dhe familjarët e tij kanë përfituar, në mënyrë të parregullt, për shkak të funksionit të tij, pasuri dhe të ardhura nga disa individë dhe shoqëri tregtare të cilat kanë përfituar leje zhvillimi e ndërtimi dhe kontrata publike nga Bashkia e Tiranës, konkretisht një vilë në një resort turistik, shpenzimet e udhëtimit në Roterdam, Holandë, financime të OJF-ve dhe personave fizikë që dyshohet se kontrollohen efektivisht nga bashkëshortja e kërkuesit, të cilat kalojnë në buxhetin e familjes në mënyrë indirekte sipas një skeme të organizuar prej tyre etj. Gjykata ka pasqyruar në vendim edhe provat

dhe aktet e mbledhura gjatë fazës së hetimit, të paraqitura nga akuza, mbi të cilat ka bazuar qëndrimin e saj. Pas verifikimit të kushteve e të kriterëve të zbatimit të masave, me vendimin nr. 14/2025, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka konfirmuar masën e sigurimit të caktuar për kërkuesin, duke vlerësuar se nuk janë zbutur nevojat e sigurimit, pasi rrethanat e faktit nuk kanë ndryshuar, sepse janë po ato veprime, sjellje dhe fakte që janë vlerësuar njëherë prej saj dhe se vazhdimi i zbatimit të masës “Arresti në burg” është i lidhur me garantimin e interesit publik për ushtrimin e ndjekjes penale.

90. GJKKO-ja e Apelit, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe përmbajtjen e vendimeve objekt ankimi, ka miratuar për kërkuesin vendimin e GJKKO-së së Shkallës të Parë nr. 7/2025, i verifikuar me vendimin e po asaj gjykate nr. 14/2025, duke vlerësuar se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se ai ka konsumuar veprat penale që i atribuohen nga organi i akuzës, pasi nga të dhënat e grumbulluara në raport me hetimet e kryera deri në këtë moment të procedimit, evidentohet përgjegjësia e kërkuesit në disa episode të veçanta (*shih paragrafin 7 të vendimit*), ku me veprimet e tij ka konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 260 i KP-së, të kryer në bashkëpunim me bashkëshorten. Kurse Kolegji Penal i ka gjetur të pabazuara shkaqet e rekursit, duke vlerësuar se gjykatat e faktit kanë argumentuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm referuar fakteve, rrethanave, provave e në tërësi akteve të verifikuara deri në këtë fazë të procedimit penal, në raport me të gjithë të hetuarit, përfshirë edhe kërkuesin.

91. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata vëren se kufizimi i lirisë personale të kërkuesit është vendosur me vendim gjyqësor dhe mbi bazën e dyshimit se ai mund të ketë kryer veprat penale për të cilat procedohet. Nga arsyetimi i vendimeve të gjykatave të zakonshme rezulton se dyshimi i arsyeshëm nuk është mbështetur në vlerësime të përgjithshme ose abstrakte, por në të dhëna, informacione dhe akte konkrete të administruara në atë fazë të procedimit, të cilat, në tërësinë e tyre, janë vlerësuar si të mjaftueshme për të krijuar një lidhje objektive midis kërkuesit dhe veprave penale për të cilat dyshohet. Gjykata nuk zëvendëson gjykatat e zakonshme në çmuarjen e provave dhe as nuk shprehet për fajësinë ose pafajësinë e kërkuesit, por verifikon nëse përfundimi i tyre për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm është haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar. Në rastin konkret, pavarësisht pretendimeve të kërkuesit për mënyrën e krijimit dhe përdorimit të bazës provuese, nuk rezulton që gjykatat e zakonshme të kenë vendosur masën e sigurimit në mungesë të çdo baze faktike ose mbi dyshime thjesht hipotetike. Gjykata vlerëson se në çështjen

penale ndaj kërkuesit duket se ka informacione që do të bindnin një vëzhgues të paanshëm se ai mund të ketë kryer veprat penale për të cilat është i dyshuar, ndaj nuk mund të konkludohet se ai është arrestuar në mungesë të dyshimit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 27, paragrafi 2, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenit 5, pika 1, shkronja “c”, të KEDNJ-së. Arsyetimi i gjykatave të zakonshme në këtë drejtim nuk është abstrakt, por ato gjykata kanë shpjeguar në mënyrë konkrete dhe të mjaftueshme praninë e kritereve dhe kushteve që lejojnë kufizimin e lirisë personale.

92. Për sa u takon pretendimeve të kërkuesit për cenimin e prezumimit të pafajësisë në procesin e caktimit të masës së sigurimit, Gjykata vëren se ato janë ngritur në dy drejtime: *së pari*, në drejtim të përdorimit të një gjuhe fajësuese (paragjykuese për fajësinë e të pandehurit) në arsyetimin e gjykatave për përmbushjen e kushteve dhe kritereve që justifikojnë kufizimin e lirisë dhe, *së dyti*, në drejtim të arsyetimit të gjykatave lidhur me sjelljet/veprimet e kërkuesit pas caktimit dhe konfirmimit të masës së sigurimit “Arresti në burg”, të cilat, gjithnjë sipas arsyetimit të gjykatave, përforcojnë argumentet në favor të kufizimit të lirisë.

93. Në lidhje me *drejtimin e parë* të pretendimeve të kërkuesit, Gjykata vëren se, sipas GJEDNJ-së, prezumimi i pafajësisë quhet se është shkelur edhe nëse, pa u përcaktuar ende fajësia e një të akuzuari, një vendim gjyqësor (paraprak) lidhur me të (të akuzuarin) reflekton mendimin se ai është fajtor. Dallim duhet bërë mes një deklarimi se personi është thjesht i dyshuar apo se ai e ka kryer veprën penale në fjalë, ndaj, në këtë drejtim, GJEDNJ-ja ka theksuar rëndësinë e zgjedhjes së fjalëve nga zyrtarët publikë në deklaratimet e tyre. Mjafton, edhe në mungesë të ndonjë konstatimi formal, që të ketë një arsyetim që sugjeron se gjykata e konsideron të akuzuarin si fajtor (*shih Gutsanovi kundër Bullgarisë, datë 15.10.2013, §§ 202-203*). Për më tepër, mungesa e qëllimit për të shkelur prezumimin e pafajësisë nuk mund të përjashtojë një shkelje të nenit 6, pika 2, të Konventës (*shih Avaz Zeynalov kundër Azerbajxhanit, 22.04.2021, § 69*). Megjithatë, është e rëndësishme të merret parasysh kuptimi i vërtetë i deklaratimeve dhe jo forma/përmbajtja e tyre literale (*shih Lavents kundër Letonisë, datë 28.11.2002, § 126*). Po sipas GJEDNJ-së, gjykatat më të larta mund të korrigjojnë deklaratimet e gjykatave më të ulëta, duke rregulluar formulimin e tyre, në mënyrë që të përjashtojnë çdo sugjerim paragjykuës të fajësisë (*shih Benghezal kundër Francës, datë 24.03.2022, § 36*).

94. Përkundrejt këtij pretendimi të kërkuesit dhe argumenteve të sjella prej tij, nga njëra anë, dhe kuadrit kushtetues, konventor dhe ligjor, të sipërpërmendur, nga ana tjetër, Gjykata do të

verifikojë gjuhën e përdorur nga gjykatat e posaçme, në arsyetimin që ato kanë bërë për të treguar ekzistencën e kushteve dhe kritereve që, sipas tyre, justifikojnë kufizimin e lirisë së kërkuesit në fazën e hetimeve paraprake. Thënë ndryshe, Gjykata do të verifikojë nëse në rastin konkret mënyra sesi kanë arsyetuar gjykatat e posaçme lidhur me ekzistencën e kushteve dhe kritereve kushtetuese e ligjore që justifikojnë kufizimin e lirisë personale të kërkuesit në fazën e hetimit paraprak reflekton, në një mënyrë apo një tjetër, paragjykim lidhur me fajësinë e kërkuesit.

95. Gjykata vëren se në ilustrim dhe argumentim të pretendimit të tij kërkuesi ka nxjerrë në pah disa fragmente nga vendimet e gjykatave, të cilat arsyetojnë si më poshtë: “... (nga kërkuesi) nuk është shfaqur asnjë pendesë për veprimet e kryera në shkelje të ligjit...”; “... në kundërshtim me provat evidente këta shtetas (lexo kërkuesi dhe bashkëshortja) kanë mohuar çdo përgjegjësi...”; “...mekanizmin që personat nën hetim kanë ideuar, vënë në funksion dhe zbatuar për një kohë të gjatë...”; “... mënyra si është vepruar për kryerjen e veprave penale ... shpërfillja prej titullarit të bashkisë ndaj fondeve publike ..., të cilat ... kanë përfunduar ... në pasurimin personal të tij ...” “...përfitimet e parregullta të titullarit të bashkisë, të marra drejtpërdrejt apo tërthorazi... kanë vijuar pa u ndalur...”; “... argumentet ... edhe për mungesë dijenie, si dhe mungesë memorie... dëshmojnë më së paku për një qasje aspak bashkëpunuese...”; “...duke pasur në konsideratë ambientin ku jetojnë... ekziston rreziku real që disa prova të mos merren apo të merren në një formë “të helmuar”; “... nuk është një gjendje e cila mund të neutralizohet nëpërmjet izolimit të përkohshëm të personit nën hetim...”; “... rreziku i helmimit të provave të gjalla do të jetë gjithnjë i pranishëm...”; “...prirjen normale dhe natyrore të çdokujt për gëzimin e lirisë personale...” etj.

96. Gjykata thekson se, në parim, arsyetimi i vendimeve gjyqësore që synon të vërtetojë ekzistencën e kushteve dhe kritereve të cilat justifikojnë kufizimin e lirisë së individit gjatë fazës të hetimit paraprak, në vetvete, nuk përbën cenim të së drejtës për të mos u prezumuar fajtor për veprat penale në ngarkim të tij. Megjithatë, ky pohim nuk do të thotë se parimi i prezumimit të pafajësisë nuk zbatohet në këtë fazë të procesit penal dhe se ai (parimi) nuk mund të cenohet nga përdorimi i një gjuhe të tillë në vendimin e gjykatës së masës së sigurimit që duket paragjyqese në raport me fajësinë e të pandehurit. Duke iu referuar fjalëve dhe fjalive të cituara nga kërkuesi në ankimin kushtetues individual, Gjykata vëren se kjo gjuhë e përdorur nuk duket të jetë plotësisht në linjë me standardet kushtetuese e konventore të sipërpërmendura, për sa kohë që ajo (gjuha), në pamje të parë, në leximin e një vëzhguesi të jashtëm, duket sikur nënkupton se kërkuesi është fajtor

për veprat penale që i atribuohen. Megjithatë, Gjykata, referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore që kanë caktuar e konfirmuar vendosjen e masës së sigurimit ndaj kërkuesit, vëren se këto fjalë e fjali janë veçuar dhe interpretuar nga kërkuesi në mënyrë të izoluar, duke prodhuar kështu një rezultat që në dukje, nuk përputhet me prezumimin e pafajësisë.

97. Përtej kuptimit literal të disa fjalëve e fjalive, duke mbajtur parasysh faktin se vendimet e kundërshtuara janë tejet voluminoze (*vendimi nr. 7/2025 i GJKKO-së së Shkallës së Parë 368 faqe; vendimi nr. 14/2025 i GJKKO-së së Shkallës së Parë 356 faqe; vendimi i GJKKO-së së Apelit 114 faqe; vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë 78 faqe*), si dhe duke i vendosur pasazhet e kontestuara në kontekstin e gjerë të vendimeve dhe të kësaj faze të procesit, Gjykata vlerëson se pavarësisht dyshimeve në dukje, në tërësinë e tyre arsyetimet e gjykatave të masës së sigurimit janë qartësisht të fokusuara te vërtetimi i ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm të bazuar mbi prova se i akuzuari (kërkuesi) mund t'i ketë kryer veprat penale të cilat i atribuohen nga organi i akuzës, si dhe te vërtetimi i kushteve dhe kritereve të tjera të parashikuara nga ligji për kufizimin e lirisë në këtë fazë të procesit penal. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se shprehjet gjuhësore të përdorura në tekstin e vendimit gjyqësor nuk mjaftojnë, në këndvështrimin kushtetues, për të vënë në dyshim garantimin e prezumimit të pafajësisë së kërkuesit nga mënyra e arsyetimit të vendimeve për caktimin dhe konfirmimin e masës së sigurimit.

98. Në lidhje me *drejtimin e dytë* të pretendimeve të kërkuesit, që u referohet arsyeve të gjykatave lidhur me rrezikshmërinë e tij, duke marrë shkas nga komunikimet e kërkuesit me një hetues të BKH-së, nga postimet dhe deklaratat publike të kërkuesit, si dhe bashkëpunimi me të hetuarit e tjerë, veprime që janë konsideruar se kanë tiparet e një bashkëpunimi të posaçëm, atij të grupit të strukturuar kriminal, Gjykata vëren se këto arsyeve janë shtuar nga GJKKO-ja e Apelit, që ka shqyrtuar ankimin e kërkuesit, pra pas caktimit fillestar të masës së sigurimit “Arresti në burg”. Gjykata vëren se, si mënyra e komunikimit të kërkuesit (me oficerin e BKH-së dhe publikisht) ashtu edhe veprimet që konsiderohet se përbëjnë bashkëpunim të posaçëm mes disa të hetuarve, janë vlerësuar nga gjykata e apelit në këndvështrim të analizës së saj për verifikimin e ekzistencës së kushteve dhe kritereve të tjera që lejojnë kufizimin e lirisë personale, duke u konsideruar ato si rrethana që provojnë rrezikun për ndërhyrje në procesin gjyqësor dhe atë të veprave penale, për rrjedhojë justifikojnë vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal. Gjykata vëren se pavarësisht deklarimeve të GJKKO-së së Apelit në këtë drejtim, ato nuk janë të

tilla që të përbëjnë shprehje/deklarim të fajësisë së kërkuesit përpara se ajo të vendoset me vendim të formës së prerë. Për më tepër edhe Kolegji Penal, si gjykata më e lartë, në vlerësimin e këtij pretendimi ka arsyetuar se ai ka marrë përgjegje në vendimin e vetë gjykatës së apelit, e cila i ka parashtruar këto rrethana në këndvështrim të rrezikshmërisë së shfaqjes së veprave penale, duke u shprehur se një formë e tillë bashkëpunimi nuk i është atribuar ende personave në hetim, për rrjedhojë, nuk merret në konsideratë në këtë moment të procedurës, pra në caktimin e llojit të masës së sigurimit, pasi në të kundërt do të cenohet parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit. Madje, sipas Kolegjit Penal, për njërin nga këta persona nën hetim që dyshohet të ketë marrë pjesë në këtë formë bashkëpunimi, gjykata e apelit ka caktuar një masë më të butë sigurimi (*shih paragrafin 33 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Në këto kushte, Gjykata vlerëson se arsyetimi i gjykatave të zakonshme nuk reflekton qëndrimin se kërkuesi është fajtor dhe se qëllimi e mënyra e vlerësimit të këtyre rrethanave nga GJKKO-ja e Apelit, duke marrë në konsideratë përmbajtjen dhe thelbin e arsyetimit të saj, duket se përjashton çdo sugjerim paragjykes të fajësisë.

99. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuesit për cenimin e dyshimit të arsyeshëm të lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë është i pabazuar.

B.2.2. Për parimin e proporcionalitetit të lidhur edhe me të drejtën për t'u zgjedhur

100. Sipas kërkuesit, gjykatat e zakonshme nuk kanë argumentuar ekzistencën e kushteve që lejojnë caktimin e masës së kundërshtuar dhe, në këndvështrim të nevojshmërisë, përse ajo ishte e vetmja që mund të shmangte rreziqet pretenduara për mbarëvajtjen e procedimit penal. Sipas tij, masa proporcionale do të ishte “Garancia pasurore”, pasi ajo do të përmbushte qëllimin e synuar pa sjellë të njëjtën ndërhyrje në të drejtat kushtetuese. Po ashtu, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e zakonshme nuk kanë individualizuar rreziqet që justifikojnë vendosjen e masës “Arresti në burg”, pra çfarë prove konkrete rrezikohej dhe as mënyrën e supozuar të dëmtimit të saj, duke u mbështetur në një prezumim të përgjithshëm dhe abstrakt. Në këtë drejtim, ai ka parashtruar se nuk ka ndërhyrë në hetime, nuk ka ndaluar asnjë zyrtar të dëshmojë, nuk ka shkatërruar dokumente dhe nuk ka përdorur ndonjë instrument institucional për të penguar drejtësinë, duke ekzistuar kështu një provë pozitive për mungesën e një rreziku të tillë. Arsyetimi i gjykatave për rrezikun e ndërhyrjes në prova ose të ndikimit të dëshmitarët, sipas kërkuesit, është

mbështetur në perceptime për pozitën, karakterin, qëllimin ose mundësinë e një sjelljeje të ardhshme, pa u mbështetur në fakte konkrete për ndërhyrje reale në hetim ose përpjekje për intimidim të dëshmitarëve. Për sa i përket rrezikut të ikjes, sipas kërkuesit, gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë abstrakte dhe jo mbi veprime konkrete që tregonin synimin e tij për t'iu shmangur drejtësisë. Sipas tij, edhe pse ka pasur dijeni për hetimin, ai nuk është larguar për t'iu shmangur procedimit penal, por ka qëndruar në dispozicion të drejtësisë. Po sipas kërkuesit, ekzistenca e rrezikut për kryerjen e veprave penale të tjera ose të të njëjtit lloj, është mbështetur në vlerësime spekulative për sjelljen e tij të ardhshme.

101. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se përshtatshmërinë e masës gjykatat e zakonshme e kanë justifikuar me rrezikshmërinë e tij, duke e lidhur këtë me statusin si subjekt i posaçëm dhe me funksionin publik që ushtronte, pa e individualizuar në raport me sjelljen e tij konkrete dhe pa treguar sesi ky status bënte të domosdoshëm caktimin e kësaj mase. Po sipas kërkuesit, gjykatat nuk kanë analizuar proporcionalitetin e masës në raport me të drejtën për t'u zgjedhur, të garantuar nga neni 45 i Kushtetutës, pasi masa e pengon në ushtrimin e funksionit të kryetarit të bashkisë, duke sjellë ndikim jo vetëm mbi të drejtat e tij individuale, por edhe mbi interesin e zgjedhësve për t'u qeverisur nga përfaqësuesi i zgjedhur prej tyre. Në këtë kuptim, sipas tij, gjykatat duhet të kishin kryer një balancim ndërmjet nevojave konkrete të procedimit penal, nga njëra anë, dhe pasojave të masës mbi ushtrimin efektiv të funksionit publik të fituar përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta, parimit të autonomisë vendore dhe përfaqësimit demokratik, nga ana tjetër.

102. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme*, ka prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi gjykatat e zakonshme kanë argumentuar jo në mënyrë abstrakte, por mbi bazën e provave të mbledhura nga autoriteti procedues dhe të paraqitura në seancë gjyqësore, për ekzistencën e kushteve dhe kriterëve që lejojnë caktimin e masës së sigurimit. Rreziku i pengimit të drejtësisë është argumentuar me tentativat e kërkuesit dhe të rrethit të tij të afërt për ndikim të dëshmitarët, si dhe për shkatërrimin, fshehjen ose fabrikimin e provave dhe akteve shkresore. Sipas këtij subjekti, është provuar se kërkuesi ka kapacitet real për ndikim në hetimin paraprak, për shkak të burimeve financiare, rrjeteve të ndikimit dhe aftësisë për koordinim veprimesh edhe pas arrestimit dhe izolimit. Fakti që kërkuesi është në detyrë, si dhe aksesit i tij në dokumentacion administrativ, arkiva, sisteme elektronike dhe personel teknik, rrisin rrezikun e ndërhyrjes në prova

dhe të ndikimit të dëshmitarët, nëse do të caktohej një masë më e butë. Faktet dëshmojnë për një mekanizëm të mirorganizuar për të ushtruar ndikim mbi autoritetet gjyqësore, për të udhëzuar dëshmitarët, për të orkestruar dhe ekzekutuar një fushatë mediatike që synon dëmtimin e mbarëvajtjes së drejtësisë, si dhe për të fabrikuar prova shkresore për justifikimin *post factum* të origjinës së paligjshme të pasurive. Gjykatat, sipas këtij subjekti, kanë arsyetuar për shkaqet “e rëndësishme” dhe “të mjaftueshme” për caktimin dhe vijimin e masës, për rrezikun e helmimit të provave, të ikjes dhe të përsëritjes së veprës nëse do të caktohej një masë tjetër.

103. Po sipas subjektit të interesuar, gjykatat e zakonshme kanë dhënë përgjigje për nevojën, domosdoshmërinë dhe ashpërsinë e masës në kontekstin e rrethanave konkrete të çështjes dhe në përputhje me parashikimet e KPP-së. Masa “Garancia pasurore” jo vetëm nuk kënaq shkallën e nevojave të sigurimit, por nuk përputhet as me natyrën e veprave penale për të cilat është akuzuar kërkuesi, që lidhen me përfitimin e parregullt të pasurive gjatë ushtrimit të detyrës dhe fshehjen e burimit të tyre. Po sipas këtij subjekti, vlerësimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit të masës nuk kushtëzohet nga statusi institucional i kërkuesit. Arrestimi në kuadër të një mase sigurimi personal nuk përfshihet në rastet e mbarimit të mandatit sipas neneve 61 dhe 62 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ndaj nuk prodhon efektin e ndërprerjes së mandatit, as në mënyrë të tërthortë. Po ashtu, sipas Prokurorisë së Posaçme, masa e parashikuar nga neni 238 i KPP-së ka për objekt kufizimin e lirisë së individit për qëllime të procedimit penal, ndërsa pezullimi nga ushtrimi i një detyre ose shërbimi publik sipas nenit 242 të KPP-së është masë me natyrë dhe objekt të ndryshëm. Ndaj, nuk mund të pranohet se masa ka sjellë *de facto* pezullimin nga detyra ose ka prodhuar efekte juridike mbi statusin e kërkuesit si funksionar publik.

104. Gjykata, në jurisprudencën e saj në lidhje me caktimin e masave të sigurimit personal që kufizojnë lirinë personale, ka pohuar se ato duhet të jenë në përpjesëtim me qëllimin legjitim të ndjekur dhe se justifikimi i tyre nga gjykatat duhet të mbështetet në arsye “relevante dhe të mjaftueshme”. Me fjalë të tjera, kufizimi i lirisë personale është i justifikueshëm vetëm për atë sa ai ndihmon në arritjen e qëllimit legjitim të synuar. Në drejtim të proporcionalitetit të ndërhyrjes, Gjykata analizon aspektet e nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masës në raport me parashikimet e neneve 228, 229 e vijues të KPP-së. Gjithashtu, në bazë të parimit të subsidiaritetit, Gjykata bazohet në arsyetimin e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, duke qenë se u takon atyre që, përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysht edhe

jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit (*shih vendimet nr. 7, datë 28.01.2026; nr. 1, datë 17.01.2025; nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

105. Gjykata vëren se KPP-ja, në nenin 228, pika 3, përcakton kushtet e veçanta, alternative, për vendosjen e masave të sigurimit personal dhe konkretisht: kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit (shkronja “a”); kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet (shkronja “b”); kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet (shkronja “c”). Neni 229 përcakton kriteret e përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit personal, duke parashikuar se gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës masë me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret (pika 1) dhe ato duhet të jenë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete, duke mbajtur parasysh edhe vazhdimësinë, përsëritjen, si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese të parashikuara nga KP-ja (pika 2). Kurse neni 230 përcakton kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg, duke parashikuar, ndër të tjera, se një masë e tillë mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të të pandehurit (pika 1).

106. Gjykata vëren, gjithashtu, se në rastin konkret pretendimi për proporcionalitetin e masës lidhet jo vetëm me lirinë personale, por edhe me të drejtën për t’u zgjedhur, për sa kohë kërkuesi ka pretenduar se masa e kundërshtuar ka sjellë pasoja mbi ushtrimin efektiv të funksionit publik të kryetarit të bashkisë, të fituar në zgjedhjet vendore të vitit 2023. E drejta për t’u zgjedhur garantohet nga neni 45 i Kushtetutës, ndërsa sipas nenit 109, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, organi ekzekutiv i bashkisë është kryetari, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë. Gjykata ka theksuar se e drejta për t’u zgjedhur shtrihet jo vetëm mbi të drejtën për të kandiduar, por edhe mbi të drejtën për të ushtruar funksionin publik të besuar nga zgjedhësit (*shih vendimin nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

107. Gjykata mban parasysh edhe vlerësimet e Komisionit të Venecias, sipas të cilit ndikimi i paraburgimit të kryetarëve të bashkive në qeverisjen demokratike vendore është i

dyfishtë: nga njëra anë, ai mund të prekë të drejtat individuale të tyre dhe, nga ana tjetër, të shtrihet përtej sferës individuale, duke prekur edhe të drejtat e votuesve, për sa kohë zgjedhja e shprehur prej tyre në zgjedhje demokratike mund të cenohet përmes zëvendësimit të kryetarit të zgjedhur me një kryetar që nuk përputhet me atë zgjedhje. Komisioni ka vënë në dukje se ndërsa paraburgimi krijon, në shumicën e rasteve, një situatë *de facto* në të cilën kryetari i bashkisë nuk është në gjendje të ushtrojë mandatin e tij, pezullimi krijon një situatë *de jure* në të cilën ai pengohet nga ushtrimi i këtij mandati. Po sipas Komisionit të Venecias, si çështje parimi, kryetarët e bashkive janë përgjegjës për çdo veprimtari penale të mundshme në të njëjtën mënyrë si çdo qytetar tjetër dhe rregullat e zakonshme për paraburgimin janë të zbatueshme ndaj tyre. Megjithatë, paraburgimi dhe pezullimi i përkohshëm i përfaqësuesve vendorë të zgjedhur në mënyrë demokratike, përfshirë kryetarët e bashkive, duhet të trajtohen me kujdes të veçantë. Në këtë drejtim, edhe kur kryetarët e bashkive trajtohen si qytetarë të zakonshëm për qëllime të caktimit të masës së paraburgimit, duke pasur parasysh edhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, duhet t'u kushtohet vëmendje e posaçme pasojave të mundshme mbi të drejtat që lidhen me ushtrimin efektiv të funksionit të zgjedhur dhe me pjesëmarrjen politike efektive. Komisioni ka theksuar, gjithashtu, rëndësinë e zbatimit të testit të proporcionalitetit si standard i përbashkët evropian në rastet kur masat e marra prekin ushtrimin e mandatit të zgjedhur. Sipas tij, kufizimet që zbatohen ndaj së drejtës për të ushtruar funksionin si person i zgjedhur duhet të shoqërohen me garanci të përshtatshme procedurale, duke përfshirë të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe kontrollin gjyqësor ose administrativ të masës (*shih Raportin e Komisionit të Venecias CDL-AD(2025)045, datë 24.10.2025 "Për ndikimin e paraburgimit të kryetarëve të bashkive në ushtrimin e qeverisjes demokratike vendore"*).

108. Për sa më sipër, si dhe referuar thelbit të pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Gjykata, pa rënë në përsëritje të fakteve në lidhje me proceset gjyqësore që çuan në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit dhe konfirmimin e vijimit të zbatimit të saj, sikurse ato janë parashtruar më lart, çmon të evidentojë në vijim, në mënyrë të përmbledhur, arsyet e veçanta mbi të cilat gjykatat e posaçme kanë justifikuar paraburgimin e kërkuesit, përtej ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, për atë që lidhen me pretendimin për proporcionalitetin e masës dhe me kontrollin e ushtruar nga Gjykata e Lartë mbi këto pretendime. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm përbën kusht të

domosdoshëm për caktimin e masës së sigurimit, por nuk mjafton, në vetvete, për të justifikuar caktimin ose vijimin e masës më të rëndë të sigurimit personal. Për këtë arsye, në vijim do të evidentohet arsyetimi i gjykatave të posaçme për ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, për rrezikun e largimit të kërkuesit, si dhe për rrezikun që, për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit, ai të kryejë krime të tjera ose të të njëjtit lloj. Po ashtu, do të evidentohet arsyetimi i tyre për përshtatshmërinë, domosdoshmërinë dhe ashpërsinë e masës së arrestit në burg, si dhe për papërshtatshmërinë e masave më pak të rënda, për aq sa këto elemente lidhen me pretendimet e kërkuesit dhe kontrollin e ushtruar nga Gjykata e Lartë mbi to.

109. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se, përtej ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, në rastin konkret ekzistonte rrezik real dhe i vazhdueshëm për marrjen ose vërtetësinë e provave, nëse ndaj kërkuesit nuk do të zbatohesh një masë kufizuese e lirisë personale. Sipas asaj gjykate, ky rrezik lidhej me nevojën për të shmangur pengimin, ngadalësimin ose devijimin e procesit të të provuarit, duke mbajtur parasysh funksionin publik të kërkuesit si kryetar i Bashkisë së Tiranës, njohjet, lidhjet dhe ndikimin që buronte nga ushtrimi i këtij funksioni, si dhe rëndësinë e institucionit që ai drejtonte, për shkak të territorit që mbulon dhe fondeve publike që administron. Ajo gjykatë ka mbajtur parasysh, gjithashtu, sjelljen e kërkuesit ndaj hetuesve të BKH-së, të vlerësuar si intimiduese, praninë e vartësve të tij në kontakte me persona të thirrur nga organi procedues ose gjatë veprimeve hetimore, si dhe kontaktimet e pretenduara me deklarues të thirrur nga Prokuroria e Posaçme, të cilat, sipas saj, dëshmonin rrezikun që prova të mos merrej ose të merrej në formë të “helmuar”. Po ashtu, duke qenë se një pjesë e hetimit lidhej me veprimtari të Bashkisë së Tiranës, gjykata ka vlerësuar se mundësia për të rrezikuar marrjen e provave nga ky institucion ishte e prekshme, për shkak të natyrës hierarkike të administratës dhe varësisë funksionale të personave që mund të kishin dijeni për rrethanat e çështjes. Në vijim, sipas asaj gjykate, duke pasur parasysh sanksionin e veprave penale dhe prirjen normale të çdo personi për të gëzuar lirinë personale, ekzistonte frika, mendimi dhe dyshimi i arsyeshëm se kërkuesi mund të largohej për të pamundësuar ose penguar zhvillimin normal të procedimit penal. Në këtë drejtim, gjykata i është referuar edhe vendimit unifikues nr. 7, datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke theksuar se rreziku i ikjes dhe

rreziku për marrjen ose vërtetësinë e provës nuk kufizohen vetëm në fazën e hetimeve paraprake, por mund të ekzistojnë edhe gjatë gjykimit.

110. Në lidhje me rrezikun e kryerjes së veprave penale të tjera ose të të njëjtit lloj, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se mekanizmi i dyshuar, i ideuar, i vënë në funksion dhe i zbatuar për një kohë të gjatë, dukej i vështirë të ndalej edhe prej vetë personave nën hetim. Sipas saj, sa më gjatë që këta persona të qëndronin të lirë, aq më i madh ishte rreziku për kryerjen e krimeve të rënda ose të të njëjtit lloj me ato për të cilat procedoheshin. Në këtë drejtim, gjykata ka mbajtur parasysh edhe faktin se kërkuesi vijonte të ushtronte funksione publike dhe se, për shkak të këtij funksioni, ekzistonte rreziku i abuzimit me detyrën. Në kuadër të vlerësimit të proporcionalitetit, gjykata ka mbajtur parasysh edhe rëndësinë e faktit penal, sanksionet e parashikuara nga ligji për veprat penale të dyshuara, rrethanat rënduese të pretenduara, mënyrën e dyshuar të kryerjes së veprave penale, vijimësinë e tyre, bashkëpunimin, vlerat e larta monetare të dyshuara si të përfituara, si dhe sjelljen e personave nën hetim pas marrjes dijeni për procedimin. Po ashtu, gjykata i është referuar praktikës së Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për subjekte të posaçme dhe funksionarë publikë, duke çmuar se, në rrethanat konkrete, masa “Arresti në burg” ishte masa më e përshtatshme për të garantuar nevojat e procedimit penal, shmangien e largimit, parandalimin e përsëritjes së veprës dhe ekzekutimin e një dënimi të mundshëm.

111. GJKKO-ja e Apelit, ndërsa ka gjetur të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë për kërkuesin, ka theksuar se ndaj tij ekzistonin të tria kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228, pika 3, i KPP-së, konkretisht rreziku i marrjes ose vërtetësisë së provës, rreziku i ikjes dhe rreziku i kryerjes së veprave penale të tjera ose të të njëjtit lloj. Ajo gjykatë ka çmuar se asnjë masë tjetër e ndryshme nga “Arresti në burg” nuk do të ishte e përshtatshme për të garantuar nevojat e sigurimit, për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale të dyshuara dhe të autorit të tyre. Në këtë drejtim, GJKKO-ja e Apelit ka mbajtur parasysh se kërkuesi dyshohej për dy vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, të kryera, sipas akuzës, në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, si dhe vlerat e larta monetare të dyshuara si të përfituara ose të pastruara. Ajo ka theksuar, po ashtu, se rrezikshmëria e kërkuesit përforcohej edhe nga sjellja e tij pas zbatimit të masës, e cila, sipas asaj gjykate, ishte kërcënuese dhe intimiduese ndaj gjykatës dhe prokurorisë dhe lidhej drejtpërdrejt me rrezikun për marrjen ose vërtetësinë e provës. Po sipas saj, duke qenë subjekt i posaçëm dhe i përfshirë në juridiksionin e gjykatave të posaçme, rrezikshmëria e

kërkuesit vlerësohet në mënyrë implicite nga dispozitat që parashikojnë kryerjen e veprave penale nga zyrtarë të këtij niveli.

112. Lidhur me rrezikun e marrjes ose vërtetësisë së provave, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se provat e marra rishtazi në gjykimin në apel tregonin se kërkuesi kishte organizuar një fushatë denigrimi dhe intimidimi të drejtuar ndaj organeve proceduese, me potencial ndikimi edhe mbi personat e thirrur për të dhënë deklaramë. Në këtë kuadër, ajo gjykatë ka mbajtur parasysh komunikimet e përgjuara të kërkuesit, postimet në media dhe orientimet e tij për të ndikuar në qëndrimet publike ose në sjelljen e personave që kishin dijeni për rrethanat e çështjes. Në lidhje me rrezikun e ndikimit në procesin e drejtësisë, duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, ajo ka vlerësuar se pozita publike e një zyrtari të lartë dhe rrjetet e tij të ndikimit mund të merren parasysh si faktorë në vlerësimin e rrezikut të ndikimit negativ në proces. Sipas asaj gjykate, sa më i fuqishëm ose i lidhur të jetë personi, aq më i madh konsiderohet potenciali i tij për të minuar hetimin ose për të ushtruar trysni të papërshtatshme, çka mund ta bëjë paraburgimin një masë të nevojshme për të ruajtur integritetin e procesit gjyqësor. Në rastin konkret, sipas GJKKO-së së Apelit, rreziku i helmimit të provave përforcohej nga fakti se kërkuesi vijonte të ishte në detyrën e kryetarit të Bashkisë së Tiranës dhe kishte pushtetin për të ndikuar mbi vartësit e tij, për të zhdukur ose deformuar përmbajtjen e dokumenteve të ndryshme që mund të shërbejnë si burime prove, si dhe për të ndikuar mbi persona të ndryshëm. Për këtë arsye, ajo ka vlerësuar se rreziku i helmimit të provave do të mjaftonte edhe i vetëm për të justifikuar masën “Arresti në burg”.

113. Në lidhje me rrezikun e ikjes, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se mundësitë financiare të kërkuesit, të marra në harmoni me lëvizjet e tij të shumta jashtë vendit dhe me sanksionin e lartë të veprave penale të dyshuara, e bënin këtë rrezik eminent dhe në nivele të larta, konkluzion që nuk relativizohej as nga fakti se kërkuesi ishte kryefamiljar dhe prind i një fëmije të mitur. Ndërsa për rrezikun e kryerjes së veprave penale të tjera ose të të njëjtit lloj, ajo gjykatë ka mbajtur parasysh të dhënat që, sipas saj, tregonin se vepra penale e pastrimit të produkteve të veprës penale, sipas nenit 287 të KP-së, dyshohej të ishte kryer për një kohë të gjatë dhe në shuma të konsiderueshme, si dhe se ekzistonte mundësia e përpjekjeve për të fshehur origjinën e pasurive ose përfitimeve të dyshuara. Mbi këtë bazë, ajo ka vlerësuar se ekzistonte rreziku i recidivizmit në kryerjen e kësaj vepre penale. Në përfundim, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se masa “Garancia pasurore” ishte krejtësisht e papërshtatshme, pasi jo vetëm nuk kënaqte shkallën e nevojave të

sigurimit, por nuk përputhej as me natyrën e veprave penale të dyshuara, të cilat lidhen me përfitimin e parregullt gjatë ushtrimit të detyrës dhe me fshehjen e burimit të këtyre përfitimeve.

114. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në shqyrtimin edhe të rekursit të kërkuarit, fillimisht ka evidentuar kufijtë e kontrollit të tij në çështjet që lidhen me masat e sigurimit personal. Sipas atij kolegji, Gjykata e Lartë nuk ka kompetencë të rivlerësojë elementet materiale dhe faktike të çështjes, nivelin e provave që mbështesin dyshimin e arsyeshëm, elementet që lidhen me personalitetin e të dyshuarit ose vlerësimin e nevojave të sigurimit në raport me pretendimet për zbutjen e tyre, pasi këto u përkasin gjykatave të faktit. Megjithatë, Kolegji Penal ka pranuar se kontrolli i ligjshmërisë i takon Gjykatës së Lartë, i cili, në rastin e masave të sigurimit, përfshin verifikimin nëse vendimi objekt rekursi përmban arsye juridikisht të rëndësishme, si dhe nëse argumentet e evidentuara janë në përputhje me qëllimin justifikues të caktimit ose vijimit të masës së sigurimit personal. Në këtë drejtim, Kolegji Penal ka theksuar se juridiksioni rishikues i Gjykatës së Lartë nënkupton shqyrtimin e rekurseve për shkelje të ligjit material dhe procedural, duke siguruar zbatimin uniform të ligjit ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, si dhe se, në rastin konkret, pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar KPP-ja, dispozitat që lidhen me kushtet dhe kriteret e masave të sigurimit nuk kanë pësuar ndryshime thelbësore, ndaj vendimi unifikuës nr. 7, datë 14.10.2011 duhej mbajtur në konsideratë nga gjykatat, për sa kohë në të janë arritur konkluzione të rëndësishme për zbatimin e secilit prej kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenet 228, 229 dhe 230 të KPP-së.

115. Duke iu kthyer rastit konkret, Kolegji Penal ka vlerësuar se GJKKO-ja e Apelit kishte analizuar dhe mbajtur në konsideratë kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal, në raport me rrethanat e faktit, provat e marra deri në atë fazë të procedimit, pasojat e dyshuara, rrezikshmërinë e veprave penale dhe të personave nën hetim, rolin dhe pozitën e secilit prej tyre, si dhe rrethanat individuale, familjare e sociale. Sipas tij, GJKKO-ja e Apelit kishte zbatuar parimet e përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit, duke individualizuar masat për secilin prej të hetuarve dhe duke dhënë arsyet përse në rastin e kërkuarit masa “Arresti në burg” ishte masa më e përshtatshme në raport me nevojat e sigurimit, rëndësinë e faktit penal, rrezikshmërinë e autorit dhe sanksionin e parashikuar për veprat penale të dyshuara, në përputhje me rrethanat e çështjes dhe sipas rregullave specifike të KPP-së. Në veçanti, Kolegji Penal ka mbështetur arsyetimin e GJKKO-së së Apelit, për sa ajo ka arsyetuar në lidhje me: rrezikshmërinë e lartë

shoqërore të veprave penale për të cilat dyshohej kërkuesi dhe vlerat kushtetuese që ato mbrojnë; rrethanat rënduese të pretenduara, përfshirë kryerjen në bashkëpunim dhe më shumë se një herë; vlerën e lartë të produktit të veprës penale të dyshuar si të pastruar; rrezikshmërinë e kërkuesit, të lidhur jo vetëm me natyrën e veprave penale, por edhe me sjelljen e tij pas zbatimit të masës së sigurimit; statusin e tij si subjekt i posaçëm dhe funksionar publik; si dhe ekzistencën e të tria kushteve të veçanta të parashikuara nga neni 228, pika 3, i KPP-së, përkatësisht rrezikun e helmimit të provave, rrezikun e ikjes dhe rrezikun e kryerjes së veprave penale të të njëjtit lloj me ato për të cilat procedohej. Po sipas Kolegjit Penal, gjykatat e posaçme u kishin dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit për nevojën, domosdoshmërinë dhe ashpërsinë e masës, si dhe për papërshtatshmërinë e masave më të buta, përfshirë “Arresti në shtëpi” dhe “Garancia pasurore”. Në përfundim, Kolegji Penal e ka vlerësuar si të drejtë dhe të argumentuar vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit, duke e gjetur atë në përputhje me ligjin procedural penal dhe standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

116. Në analizë të sa më sipër, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka përcaktuar drejt kufijtë e kontrollit të saj, duke theksuar se, në çështjet që lidhen me masat e sigurimit personal, kontrolli i ligjshmërisë përfshin verifikimin nëse vendimi objekt rekursi përmban arsye juridikisht të rëndësishme dhe nëse këto arsye janë në përputhje me qëllimin justifikues të caktimit ose vijimit të masës. Megjithatë, në zbatimin konkret të këtij standardi, ndonëse në rekurs ishin ngritur pretendime thelbësore për mungesën e proporcionalitetit të masës më të rëndë të sigurimit personal, Gjykata e Lartë është mjaftuar, në thelb, me miratimin e arsyetimit të GJKKO-së së Apelit, pa verifikuar, në raport me pretendimet konkrete të ngritura në rekurs, nëse ai arsyetim u kishte dhënë përgjigje të mjaftueshme pretendimeve të kërkuesit për nevojën e një arsyetimi të individualizuar, të lidhur me rrethanat konkrete të çështjes, si dhe për pamjaftueshmërinë e formulimeve të përgjithshme në justifikimin e masës më të rëndë të sigurimit personal.

117. Në veçanti, kërkuesi kishte pretenduar se gjykatat e posaçme nuk kishin individualizuar rreziqet dhe nevojat e sigurimit, por ishin mbështetur në vlerësime të përgjithshme për statusin, funksionin publik, mundësitë financiare, lëvizjet jashtë vendit dhe rrezikshmërinë abstrakte të veprave penale, pa i lidhur ato me sjelljen e tij konkrete, provën konkrete që pretendohet se rrezikohej, veprimet konkrete që mund të tregonin rrezik largimi, si dhe me nevojat aktuale të procedimit penal. Ai kishte pretenduar edhe mungesën e arsyetimit për

domosdoshmërinë e masës më të rëndë sipas nenit 230, pika 1, të KPP-së, papërshtatshmërinë e masave më pak kufizuese, veçanërisht “Garancia pasurore”, si dhe proporcionalitetin e masës të lidhur edhe me të drejtën për t’u zgjedhur, në aspektin e ushtrimit efektiv të funksionit publik të kryetarit të bashkisë, të fituar përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta.

118. Gjykata vëren se përballë pretendimeve të kërkuarit se rreziqet ishin mbështetur në vlerësime të përgjithshme, Gjykata e Lartë nuk rezulton të ketë verifikuar nëse këto rrethana, të marra veçmas ose së bashku, ishin individualizuar mjaftueshëm në raport me sjelljen konkrete të kërkuarit dhe me nevojat aktuale të procedimit penal. Po ashtu, nuk rezulton që ajo gjykatë të ketë dhënë një përgjigje të veçantë për pretendimin se rreziku i përsëritjes së veprës ishte mbështetur në parashikime për sjellje të ardhshme dhe jo në të dhëna konkrete që e bënin të domosdoshme masën më të rëndë të sigurimit personal. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk tregon se është verifikuar në mënyrë konkrete nëse gjykatat e posaçme kishin analizuar mundësinë që nevojat e sigurimit të garantoheshin përmes një mase më pak të rëndë ose përmes kufizimeve të tjera më pak intensive. Në veçanti, lidhur me “Garancinë pasurore”, pretendimi i kërkuarit lidhej me nevojën për të shpjeguar përse kjo masë, e vetme ose e kombinuar me kufizime të tjera, nuk mund të përmbushte qëllimet e procedimit penal. Në këtë kuptim, arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk tregon se ajo ka verifikuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e kërkuarit se masat alternative mund të kishin aftësinë të neutralizonin rreziqet konkrete të identifikuara.

119. Gjykata vëren, gjithashtu, se proporcionaliteti i masës ishte lidhur nga kërkuari edhe me pasojat mbi të drejtën për t’u zgjedhur, të garantuar nga neni 45 i Kushtetutës, në aspektin e ushtrimit efektiv të funksionit publik të fituar përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta. Në dritën e standardeve të mësipërme, edhe pse ky pretendim meritonte një përgjigje të posaçme nga Gjykata e Lartë në kuadër të kontrollit të proporcionalitetit, ai nuk rezulton të jetë trajtuar në mënyrë të veçantë. Ajo gjykatë është mjaftuar me pranimin e arsyesimit se statusi i kërkuarit si subjekt i posaçëm dhe funksionar publik përforconte rrezikshmërinë dhe potencialin për ndikim në procedim, pa dhënë një përgjigje të veçantë për pretendimin se masa e arrestit, për shkak të natyrës dhe intensitetit të saj, ndikonte edhe në ushtrimin efektiv të funksionit. Gjykata çmon të theksojë se ky përfundim nuk nënkupton se funksioni i kryetarit të bashkisë, në vetvete, e përjashton zbatimin e masave të sigurimit personal ose se interesi për ushtrimin e këtij funksioni ka përparësi absolute ndaj nevojave të procedimit penal. Megjithatë, kjo nuk e përjashtonte nevojën që Gjykata

e Lartë t'i jepte përgjigje pretendimit se masa e kundërshtuar sillte pasoja edhe mbi ushtrimin efektiv të një funksioni publik të fituar përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta.

120. Në këto kushte, Gjykata çmon se, ndonëse Gjykata e Lartë ka evidentuar standardin e kontrollit të ligjshmërisë së vendimit objekt rekursi dhe ka mbështetur arsyetimin e gjykatave të posaçme për ekzistencën e rreziqeve dhe nevojave të sigurimit, ajo nuk ka ushtruar një kontroll efektiv mbi pretendimet thelbësore të kërkuesit në lidhje me proporcionalitetin e masës "Arresti në burg". Në veçanti, ajo nuk ka verifikuar nëse rreziqet dhe nevojat e sigurimit ishin individualizuar në mënyrë konkrete, nëse masa më e rëndë e caktuar ishte vërtet e domosdoshme, nëse masat më pak kufizuese ishin realisht të pamjaftueshme, si dhe pasojat e kësaj mase mbi të drejtën e kërkuesit për t'u zgjedhur. Në këtë kuptim, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmbush standardin kushtetues të arsyetimit në kontrollin e proporcionalitetit të kufizimit të lirisë personale, të lidhur edhe me të drejtën për t'u zgjedhur.

121. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit *për cenimin e parimit të proporcionalitetit të lidhur edhe me të drejtën për t'u zgjedhur*, në drejtim të arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Lartë, është i bazuar.

B.3. Për dinjitetin e kërkuesit të lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë

122. *Sipas kërkuesit*, qëndrimi në kafaz sigurie/kabinën e xhamit gjatë seancave gjyqësore ka cenuar edhe dinjitetin e tij, për shkak se autoritetet nuk kanë siguruar kushte dinjitoze për ushtrimin efektiv të të drejtave të personit nën hetim, duke përbërë kjo sjellje një trajtim degradues e poshtëruës, por edhe sepse fotot e tij pas hekurave janë publikuar në media, çka ka dëmtuar edhe reputacionin e kërkuesit. Ekspozimi i tij në kafaz/kabinë xhami gjatë seancave gjyqësore, sipas kërkuesit, ka krijuar, gjithashtu, një imazh negativ si një person i rrezikshëm, si dhe një perceptim të gabuar për fajësinë, duke paragjykuar edhe vetë procesin gjyqësor.

123. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme*, nuk ka paraqitur prapësime në lidhje me këto pretendime të kërkuesit.

124. Gjykata ka theksuar se nisur nga rëndësia që dinjiteti i njeriut ka në Kushtetutë, nga trajtimi i tij në aktet ndërkombëtare, si dhe në jurisprudencën kushtetuese, ai është vlera themelore nga e cila burojnë të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut. Në këtë kuptim, ai përbën bazën e katalogut të të drejtave të njeriut. Dinjiteti ka përparësi absolute dhe qëndron në themel të tërësisë së vlerave

të shprehura nga Kushtetuta. Ai ka epërsi ndaj vlerave të tjera, pasi në vetvete përshkon të drejtat e njeriut dhe luan një rol vendimtar në interpretimin e të gjitha parimeve të sistemit juridik dhe rendit kushtetues (*shih vendimin nr. 20, datë 20.04.2021 të Gjykatës Kushtetues*).

125. Neni 25 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës, që, sipas nenit 175, pika 1, të Kushtetutës, nuk mund të kufizohet as gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, çka do të thotë se ka karakter absolut. Gjykata, bazuar në nenin 25 të Kushtetutës, duke pohuar se çdo trajtim poshtëruës është i ndaluar, ka evidentuar se është detyrë e shtetit të ofrojë për këdo mbrojtje nëpërmjet legjislacionit dhe masave të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme kundër veprimeve të ndaluara, pavarësisht nëse shkaktohen nga njerëz që veprojnë në kapacitet zyrtar (*shih vendimin nr. 3, datë 11.02.2004 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas GJEDNJ-së, në interpretim të nenit 3 të KEDNJ-së, i cili ndalon në mënyrë absolute këtë trajtim, konsiderohet trajtim "poshtëruës" kur poshtërohet ose përçmohet një individ, duke treguar mungesë respekti për dinjitetin e tij njerëzor, ose duke e zvogëluar atë, ose kur ngjall ndjenja frike, ankthi ose inferioritet të aftë për të thyer rezistencën morale dhe fizike të një individi. Mund të mjaftojë që viktimi të poshtërohet në sytë e tij, edhe nëse jo në sytë e të tjerëve (*shih Gäfgen kundër Gjermanisë [DHM], datë 01.06.2010, § 89; Ilaşcu dhe të tjerë kundër Moldavisë dhe Ruisë [DHM], datë 08.07.2004, § 425; M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë [DHM], datë 21.01.2011, § 220*).

126. Në një shoqëri demokratike ky lloj trajtimi nuk është kurrë përgjigjja e duhur ndaj problemeve me të cilat përballen autoritetet. Neni 25 i Kushtetutës kërkon që pretendimet e besueshme për trajtim poshtëruës të trajtohen me prioritet dhe pa vonesa që mund të komprometojnë efektivitetin e mbrojtjes së garantuar. Duke pasur parasysh detyrën e përgjithshme të shtetit, parashikimi i nenit 3 të KEDNJ-së kërkon se duhet të ketë një formë hetimi zyrtar efektiv kur një individ bën një konstatim të besueshëm se ai ka pësuar trajtim që shkel këtë nen. Qëllimi thelbësor i një hetimi të tillë është të sigurojë zbatimin efektiv të ligjeve të brendshme që ndalojnë trajtimin poshtëruës në çështje ku përfshihen agjentët ose autoritetet shtetërore, si dhe të garantojë llogaridhënien për keqtrajtimin e ndodhur nën përgjegjësinë e tyre (*shih Bouyid kundër Belgjikës [DHM], datë 28.09.2015, §§ 115 - 123*).

127. Sipas GJEDNJ-së, vendosja sistematike e pajustificuar e të pandehurve në kafaze ose kabina xhami mundet që, në varësi të rrethanave, të ngrejë një çështje të respektimit të të drejtave

të tyre themelore (*shih Federici kundër Francës, datë 03.04.2025, § 69*). Në kuptim të nenit 3 të Konventës, që sanksionon një nga vlerat më themelore të një shoqërie demokratike, mbajtja e një personi në një kafaz metalik gjatë procesit gjyqësor, duke pasur parasysh natyrën objektivisht degraduese të kësaj mase, e cila është e papajtueshme me standardet e sjelljes së civilizuar që janë shenjë dalluese e një shoqërie demokratike, përbën në vetvete një fyerje ndaj dinjitetit njerëzor (*shih Svinarenko dhe Slyadnev kundër Ruisë [DhM], datë 17.07.2014, § 138, Karachentsev kundër Ruisë, datë 17.04.2018, § 53*). Në të kundërt, vendosja e të pandehurve pas ndarjeve prej xhami ose në kabina prej xhami nuk përfshin në vetvete një element poshtërimi të mjaftueshëm për të arritur nivelin minimal të ashpërsisë. Ky nivel mund të arrihet, megjithatë, nëse rrethanat e izolimit në ndarjet ose kabinat prej xhami, në tërësi, do t'u shkaktonin atyre shqetësim ose vështirësi me një intensitet që tejkalon nivelin e pashmangshëm të vuajtjes së natyrshme në paraburgim (*shih Yaroslav Belousov kundër Ruisë, datë 01.10.2016, § 125*).

128. GJEDNJ-ja vlerëson, në kuptim të nenit 3 të KEDNJ-së, nëse përdorimi i kafazeve metalike në sallën e gjyqit mund të justifikohet në rrethana të veçanta duke pasur parasysh kritere si: personaliteti i aplikantit (*shih Ramishvili dhe Kokhraidze kundër Gjeorgjisë, datë 27.01.2009, § 101*); natyra e veprave penale për të cilat ai akuzohet edhe pse vetëm ky faktor nuk konsiderohet i mjaftueshëm (*shih Piruzyan kundër Armenisë, datë 26.06.2012, § 71*); të dhënat e tij kriminale (*shih Khodorkovskiy dhe Lebedev kundër Ruisë, datë 25.07.2013, §§ 485-486*); sjellja e personit (*shih Ashot Harutyunyan kundër Armenisë, datë 15.06.2010, § 127*); prova të tjera të rrezikut të sigurisë në sallën e gjyqit ose të arratisjes së aplikantit (*po aty*); faktorë të tjerë shtesë si prania e publikut dhe mbulimi mediatik i procedurave (*shih Sarban kundër Moldovës, datë 04.10.2005, § 89*).

129. Për sa i përket parimit të prezumimit të pafajësisë, Gjykata rithekson se ai ndalon fillimin e procesit me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas GJEDNJ-së, fakti që trajtimi i pretenduar në kundërshtim me nenin 3 të Konventës ndodh në sallën e gjyqit, gjatë një procesi gjyqësor, vë në diskutim edhe parimin e prezumimit të pafajësisë në procedurat penale si një nga elementet e një gjykimi të drejtë (*shih Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar [DHM], datë 12.07.2013, § 94*). Kjo në këndvështrim të besimit që

gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të frymëzojnë te publiku dhe veçanërisht në procedurat penale tek i akuzuari (*shih De Cubber kundër Belgjikës, datë 26.10.1984, § 26*). Sipas asaj gjykate, aplikantët duhet të kenë pasur një frikë të justifikuar objektivisht se ekspozimi në një kafaz gjatë seancave gjyqësore do t'u përçonte gjyqtarëve që do merrnin vendim për përgjegjësinë penale dhe lirinë e tyre, një imazh negativ se ata janë të rrezikshëm në atë masë që kërkon një kufizim të tillë ekstrem fizik, duke dëmtuar kështu prezumimin e pafajësisë (*shih Svinarenko dhe Slyadnev kundër Rusisë [DHM], datë 17.07.2014, § 133*).

130. Gjykata, siç ka evidentuar më sipër, nga aktet e dosjes gjyqësore (*shih paragrafin 57 të vendimit*) konstaton se pretendimi për qëndrimin e kërkuesit të izoluar në kabinën e xhamit është ngritur nga mbrojtësi i tij në gjykatën e apelit, duke e konsideruar si trajtim çnjerëzor dhe duke kërkuar dhënien fund të kësaj praktike edhe në kuptim të parimit të prezumimit të pafajësisë. Gjykata e apelit e ka gjetur të pabazuar këtë kërkesë, duke vlerësuar se bëhet fjalë për një praktikë të ndjekur nga GJKKO-të e Shkallës së Parë e të Apelit dhe ka të bëjë me infrastrukturën e gjykatës.

131. Në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë kërkuesi ka ngritur edhe këtë pretendim, duke parashtruar se gjykata e apelit nuk ka përmbushur detyrimin për të siguruar kushte dinjitoze për ushtrimin efektiv të të gjitha të drejtave procedurale të personit nën hetim, duke pasur parasysh, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, edhe se ekspozimi i personit në kafaz/kabinë gjatë seancave gjyqësore krijon imazh negativ të tij si person i rrezikshëm, si dhe një perceptim të gabuar rreth fajësisë së tij. Megjithatë, Kolegji Penal nuk e ka marrë në shqyrtim këtë pretendim, duke mos i dhënë kërkuesit përgjigje në lidhje me të.

132. Gjykata thekson se, në këndvështrim të standardeve që garantojnë nga e drejta për proces të rregullt, standardi i arsytimit është i lidhur edhe me respektimin e së drejtës së aksesit në gjykim dhe së drejtës së ankimit efektiv. Në rastet kur kërkuesi nuk merr përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, i cenohet jo vetëm standardi i arsytimit të vendimit, por edhe e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, si dhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 25, datë 05.03.2026; nr. 1, datë 26.01.2021; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

133. Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për nga natyra e tij, për sa kohë ka të bëjë me dinjitetin të lidhur me trajtimin në sallën e gjyqit përpara gjykatës (autoriteteve publike) por

edhe në sytë e vet publikut, si dhe me parimin e prezumimit të pafajësisë të lidhur me perceptimin në drejtim të fajësisë së tij, argumente këto me natyrë thellësisht kushtetuese, si dhe duke pasur parasysh se edhe rëndësinë që ka një çështje e tillë në përgjithësi dhe në rastin konkret edhe për shkak të interesit të lartë publik që mbart ky proces penal, duhej të ishte shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, e cila duhej të kishte dhënë përgjigje të arsyetuar në këtë drejtim. Në kuptim të parimit të subsidiaritetit dhe natyrës së gjykimit të gjykatës së ligjit, Gjykata vlerëson të mos ndalet në shqyrtimin në themel të këtij pretendimi, për sa kohë çështja do të merret sërish në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila duhet të vlerësojë shkaqet e rekursit të kërkuarit dhe të shprehet lidhur me to, si dhe të mbajë një qëndrim të shprehur dhe të arsyetuar për pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e dinjitetit dhe parimit të prezumimit të pafajësisë për shkak të qëndrimit në kafaz/kabinën e xhamit është i bazuar për shkak të mungesës së arsytimit në këtë drejtim nga Gjykata e Lartë.

134. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit për cenimin e aspektit substancial të lirisë personale, në drejtim të *proporcionalitetit të masës së sigurimit personal* të lidhur edhe me *të drejtën për t'u zgjedhur* dhe me *dinjitetin* janë të bazuara, për sa i përket mungesës së arsytimit në këtë drejtim nga Gjykata e Lartë, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

C. Për shpenzimet gjyqësore

135. Për sa i përket pretendimit të kërkuarit për ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore në ngarkim të subjektit të interesuar, Gjykata vëren se në nenin 28 të Ligjit të saj Organik janë parashikuar rregullat për shpenzimet gjyqësore, sipas të cilave, shpenzimet e procesit gjyqësor përpara saj u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifën gjyqësore, procedurë që është konkretizuar edhe në nenin 14 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës. Çështja e shpenzimeve të përfaqësimit në gjykimin kushtetues të ankimit individual është pjesë e procesit të rregullt ligjor dhe refuzimi për mbulimin e tyre rrezikon të kufizojë në mënyrë të pajustificuar të drejtën e individit për akses në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Po kështu, referuar përmbajtjes së dispozitave si më sipër, *së pari*, disponimi për shpenzimet vihet në lëvizje vetëm me kërkesë formale nga ankuesi dhe, *së dyti*, një kërkesë e tillë mund të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual deri kur deklarohet mbyllja e seancës plenare nga Gjykata. Individit ka të drejtën e mbulimit të shpenzimeve vetëm nëse vërtetohet se ato janë kryer, kanë qenë të

nevojshme dhe në masë të arsyeshme, ndaj ai duhet të paraqesë edhe aktet që dokumentojnë në mënyrë reale dhe të nevojshme masën e shpenzimeve të kryera për qëllim të procesit kushtetues, të cilat në çdo rast duhet të jenë të arsyeshme dhe të shoqëruara me fatura tatimore të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi.

136. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka argumentuar dhe justifikuar shpenzimet gjyqësore që lidhen me ushtrimin e ankimit kushtetues individual, ndaj kërkesa e tij në këtë drejtim është e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72, 73, pika 4, e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-1153 (176), datë 08.07.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 25.05.2026

Shpallur më 01.07.2026

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuarit Erion Veliaj, për kundërshtimin e procesit gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat e posaçme për caktimin dhe lejimin e vazhdimin të masës së sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj tij, ne, gjyqtarët Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahim, në lidhje me pretendimin për cenimin e proporcionalitetit të masës të lidhur me të drejtën e kërkuarit për t’u zgjedhur, kemi votuar për pranimin e këtij pretendimi dhe, për këtë shkak, për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, sipas dispozitivit të këtij vendimi. Në vlerësimin tonë, ashtu siç është arsyetuar edhe në vendimin e Gjykatës, ndonëse kishte detyrimin kushtetues dhe ligjor për të marrë në shqyrtim këtë pretendim të kërkuarit dhe për t’i dhënë atij përgjigje të arsyetuar për shkak të natyrës së tij, Gjykata e Lartë ka dështuar të veprojë në përputhje me rolin dhe funksionin e saj.

2. Megjithatë, përveç këtij argumenti për pranimin e kërkesës, ne jemi edhe të qasjes që në rastin konkret Gjykata duhej të kishte gjetur shkelje edhe të vet parimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes në lirinë personale të lidhur me të drejtën e kërkuarit për t’u zgjedhur. Për këto arsye, vlerësojmë të parashtrijmë në vijim, në mënyrë të përmbledhur, disa argumente ku mbështetim qasjen tonë.

3. Gjykata, në përputhje me kufijtë e juridiksionit të saj kushtetues për shqyrtimin e ankimeve kushtetuese individuale, me qëllim garantimin e mbrojtjes kushtetuese të të drejtave themelore, gjatë ushtrimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore që vendosin kufizime të këtyre të drejtave, synon që t’i trajtojë pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues në drejtim të të drejtave substanciale, ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar. Kjo do të thotë se, në vlerësimin tonë, edhe pse arsyetimi i gjykatave të zakonshme i shërben Gjykatës për të vlerësuar mënyrën dhe masën e trajtimit prej tyre të pretendimeve kushtetuese të ngritura në procesin gjyqësor, në rastin konkret masa “Arresti në burg”, e caktuar ndaj kërkuarit, në situatën që ai vijon të ushtrojë detyrën e kryetarit të Bashkisë së Tiranës, për shkak të shfuqizimit nga Gjykata të VKM-së për shkarkimin e tij nga detyra, e bën caktimin dhe vazhdimin e kësaj mase joproporcionale, në drejtim të ashpërsisë së saj, për shkak se kërkuarit i është pamundësuar

ushtrimi i detyrës për një periudhë të konsiderueshme në raport me kohëzgjatjen e mandatit të fituar përmes zgjedhjeve vendore.

4. Për më tepër, kufizimi i lirisë personale të kërkuesit dhe qëndrimi i tij në paraburgim cenonjë jo vetëm të drejtat e tij kushtetuese si individ, por edhe të drejtat e zgjedhësve për t'u qeverisur nga organi i zgjedhur i njësisë së qeverisjes vendore, të cilit ata i kanë dhënë besimin përmes votës së tyre. Në këto kushte, ne jemi të qasjes se kërkesa ishte e bazuar në këtë drejtim edhe për shkak se masa e arrestit, për sa kohë ka sjellë pamundësinë e kërkuesit që të ushtrojë efektivisht detyrën e tij si kryetar i Bashkisë së Tiranës dhe për sa kohë që nuk rezulton se një masë tjetër nuk do garantonte në të njëjtën mënyrë interesin publik në mbarëvajtjen e procedimit penal, është joproportionale, pasi tejkalon masën e nevojshme të ashpërsisë së pasojave në të drejtat kushtetuese.

5. Për sa më sipër, në vlerësimin tonë, pretendimi i kërkuesit se masa e sigurimit personal “Arresti në burg” është joproportionale në raport me të drejtën e tij për t'u zgjedhur, është i bazuar, ndaj Gjykata duhej të kishte shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Lartë edhe për shkak se nuk ka konstatuar këtë shkelje, duke dështuar në rolin e saj subsidiar të kontrollit të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Anëtarë: **Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahim**

MENDIM PJESËRISHT PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 37 (E) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që i përket kërkuesit Erion Veliaj, me objekt: “*Shfuqizimi i vendimeve nr. 7, datë 09.02.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vleftësuar përmes vendimit nr. 14, datë 12.02.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 13, datë 13.03.2025 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1153 (176), datë 08.07.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*”, edhe pse jam dakord me zgjidhjen e saj, pra për pranimin e pjesshëm të kërkesës,

shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-1153 (176), datë 08.07.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, për shkakun e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor në kontrollin e proporcionalitetit të kufizimit të lirisë personale, të lidhur edhe me të drejtën për t'u zgjedhur, si dhe për shkak të mungesës së arsytimit nga Gjykata e Lartë për pretendimin për cenimin e dinjitetit dhe të parimit të prezumimit të pafajësisë, për shkak të qëndrimit të kërkuesit në kafaz/kabinën e xhamit gjatë seancave gjyqësore, ndaj qëndrim të ndryshëm nga shumica për disa nga pretendimet e tjera të kërkuesit, edhe për të cilat, në vlerësimin tim, vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë duhej të ishte shfuqizuar po për shkak të mungesës së një përgjigjeje të plotë dhe të mjaftueshme ndaj pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs.

2. Konkretisht, qëndrimi im i ndryshëm lidhet me pretendimet e kërkuesit për të cilat vlerësoj se vendimi i Gjykatës së Lartë duhej shfuqizuar, gjithashtu, për shkak të mungesës së një përgjigjeje të plotë dhe të mjaftueshme ndaj tyre. Këto pretendime kanë të bëjnë me: (i) të drejtën e mbrojtjes në gjykimin në apel, në aspektin e kohës dhe mundësisë efektive për t'u njohur me provat e paraqitura në atë gjykim, si dhe të komunikimit efektiv me mbrojtësit; (ii) lirinë personale në aspektin e dyshimit të arsyeshëm të lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë.

3. Në lidhje me të drejtën e mbrojtjes, pretendimet e kërkuesit kishin të bënin me: (i) dhënien e kohës së nevojshme për njohjen efektive të akteve për përgatitjen e mbrojtjes si në gjykimin në shkallë të parë, ashtu edhe në gjykimin në apel; (ii) të drejtën për të komunikuar lirisht me mbrojtësit, në kushtet e mbajtjes në kafaz/kabinën e xhamit, si në gjykimin në shkallë të parë, ashtu edhe në gjykimin në apel. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes për shkak të mosdhënies së kohës së nevojshme për njohjen efektive të akteve për përgatitjen e mbrojtjes në gjykimin në shkallë të parë, kam mbajtur të njëjtin qëndrim me shumicën për pabazueshmërinë e këtij pretendimi. Ndërsa për këtë pretendim në lidhje me gjykimin në apel, kam mbajtur qëndrimin se ai lidhej ngushtë me pretendimin tjetër të kërkuesit për cenimin e parimit *reformatio in peius* për shkak të pranimit të provave të reja të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme në atë shkallë gjykimi. Për këtë të fundit, kam mbajtur qëndrimin se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje të plotë dhe të mjaftueshme pretendimit të kërkuesit për kufijtë e shqyrtimit në apel, bazën ligjore të pranimit të provave të reja të paraqitura nga organi i akuzës dhe ndikimin e tyre mbi pozitën procedurale të kërkuesit. Ky pretendim, edhe pse nuk paraqitet si rast tipik i

reformatio in peius, për sa kohë masa e sigurimit nuk ishte rënduar formalisht, lidhej me logjikën mbrojtëse të këtij parimi, me efektivitetin e ankimit ndaj masës së sigurimit, si dhe me garancitë e mbrojtjes efektive, kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Për këtë arsye, në vlerësimin tim, vendimi i Gjykatës së Lartë duhej të shfuqizohej edhe për këtë shkak (*shih paragrafët 71-76 të vendimit*).

4. Po të njëjtin qëndrim kam mbajtur edhe për argumentin tjetër të kërkuarit në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së mbrojtjes, pra atë për shkeljen e së drejtës për të komunikuar lirisht me mbrojtësit për shkak të mbajtjes në kafaz/kabinën e xhamit. Ky pretendim nuk kishte natyrë thjesht formale, por lidhej me mundësinë reale të kërkuarit për të ndjekur procesin, për të komunikuar në mënyrë efektive me mbrojtësit dhe për të kundërshtuar provat dhe argumentet e paraqitura në gjykim. Shumica ka vlerësuar se nuk rezultonte një pengesë konkrete e tillë që e kishte bërë komunikimin me mbrojtësit objektivisht të pamundur ose joefektiv (*shih paragrafin 58 të vendimit*). Megjithatë, në vlerësimin tim, për sa kohë kërkuari e kishte ngritur këtë pretendim në lidhje me mënyrën konkrete të zhvillimit të seancave, vendosjen fizike të tij në sallë, mundësinë reale për konsultim me mbrojtësit dhe natyrën e procedurës ku shqyrtohej kufizimi i lirisë personale, Gjykata e Lartë duhej të kishte dhënë një përgjigje të veçantë, të plotë dhe të individualizuar ndaj tij. Në këtë kuptim, në respektim të parimit të subsidiaritetit, Gjykata nuk duhej të vlerësonte drejtpërdrejt bazueshmërinë në themel të këtij pretendimi, por duhej të konstatoje mungesën e arsytimit të mjaftueshëm të Gjykatës së Lartë dhe t'ia kthente asaj çështjen për shqyrtim edhe për këtë aspekt.

5. Edhe për pretendimin e kërkuarit për cenimin e lirisë personale në aspekt të dyshimit të arsyeshëm të lidhur me prezumimin e pafajësisë, kam mbajtur të njëjtin qëndrim, pra se Gjykata e Lartë, në cenim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, nuk u ka dhënë përgjigje të mjaftueshme pretendimeve të kërkuarit në të gjitha dimensionet e ngritura prej tij. Në këtë drejtim, kam parasysh se kërkuari në rekurs ka pretenduar jo vetëm mungesën e dyshimit të arsyeshëm në mënyrë të përgjithshme, por edhe se ky dyshim, sipas tij, ishte mbështetur në akte procedurale të pavlefshme dhe prova të papërdorshme, në deklarime të kontestuara për shkak të natyrës së tyre vetinkriminuese, në të dhëna të interpretuara në mënyrë të njëanshme, si dhe në mosmarrjen në konsideratë të provave të paraqitura nga mbrojtja, të cilat, sipas kërkuarit, ishin të afta të zbehnin ose të rrëzonin dyshimin e arsyeshëm. Po kështu, kërkuari ka pretenduar se gjykatat e posaçme

kishin përdorur formulime që, sipas tij, tejkalonin vlerësimin e nevojshëm për fazën e masës së sigurimit dhe krijonin perceptimin e paragjyqimit të fajësisë. Në këto rrethana, në vlerësimin tim, Gjykata e Lartë nuk mund të mjaftohej me pranimin e përgjithshëm se gjykatat e posaçme kishin evidentuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, por duhej t'u jepte përgjigje të mjaftueshme pretendimeve konkrete të kërkuesit për mënyrën e formimit të këtij dyshimi, për pavlefshmërinë e akteve dhe papërdorshmërinë e provave mbi të cilat dyshimi ishte mbështetur, si dhe për ndikimin e mundshëm të formulimeve të përdorura nga gjykatat mbi parimin e prezumimit të pafajësisë.

6. Konkretisht, për sa u përket pretendimeve për pavlefshmërinë e akteve dhe papërdorshmërinë e provave, ndryshe nga shumica, vlerësoj se ato nuk duheshin lënë jashtë shqyrtimit vetëm me arsyetimin se mund të parashtroheshin në gjykimin e themelit dhe se nuk ishin të tilla që, në këtë fazë, të vinin në dyshim formimin e dyshimit të arsyeshëm (*shih paragrafin 24 të vendimit*). Është e vërtetë se vlefshmëria e akteve dhe përdorshmëria e provave, në funksion të vërtetimit ose jo të përgjegjësisë penale, janë çështje që lidhen me procesin penal të themelit, ku provat formësohen dhe debatohen në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve. Megjithatë, në rastin konkret, kërkuesi nuk i kishte ngritur këto pretendime vetëm si çështje që lidhen me përgjegjësinë penale në themel, por edhe si argumente që, sipas tij, vinin në dyshim vetë bazën provuese mbi të cilën ishte formuar dyshimi i arsyeshëm për caktimin dhe konfirmimin e masës “Arresti në burg”. Për këtë arsye, në vlerësimin tim, ato kërkonin shqyrtim për aq sa lidheshin me kushtin kushtetues të dyshimit të arsyeshëm për kufizimin e lirisë personale.

7. Në këtë drejtim, kërkuesi në rekurs kishte pretenduar se, përpara regjistrimit të procedimit penal, hetuesit e BKH-së kishin zhvilluar për një periudhë disamujore një sërë veprimesh verifikimi, vëzhgimi, identifikimi dhe analizimi të të dhënave, të cilat, sipas tij, për nga kohëzgjatja, përmbajtja dhe efekti i tyre, tejkalonin verifikimet paraprake mbi njoftimin e faktit penal dhe përbënin veprime procedurale për mbledhjen e të dhënave ose provave. Për rrjedhojë, sipas kërkuesit, aktet e kryera përpara regjistrimit të procedimit penal ishin të pavlefshme, ndërsa provat e marra deri në atë moment ishin marrë në shkelje të ligjit dhe, si të tilla, të papërdorshme. Gjykata e Lartë e ka çmuar këtë pretendim të pabazuar, duke arsyetuar se veprimet e Policisë Gjyqësore përpara regjistrimit të procedimit penal kryhen në funksion të verifikimit të njoftimit mbi faktin e dyshuar penal, në kuptim të nenit 30 të KPP-së, kanë karakter verifikues, mund të

kryhen lehtësisht, në kohë të shkurtër, nuk kërkojnë ekspertizë të posaçme dhe mbështeten mbi të dhëna të hapura e publike. Sipas saj, në rastin konkret, hetuesit e BKH-së kishin kryer verifikime mbi njoftimin e faktit të ardhur në dijëni, me qëllim sigurimin e elementeve të provës që konfirmonin ose jo vërtetësinë e fakteve të kallëzuara.

8. Megjithatë, në vlerësimin tim, kjo përgjigje nuk ishte e mjaftueshme për dimensionin kushtetues të pretendimit, i cili lidhej edhe me kuadrin procedural për fillimin e procedimit penal. Kërkuesi nuk kishte kundërshtuar në mënyrë abstrakte mundësinë e Policisë Gjyqësore për të kryer veprime verifikuese përpara regjistrimit të procedimit penal, por kishte pretenduar se, në rastin konkret, për shkak të kohëzgjatjes, përmbajtjes dhe efektit të veprimeve të kryera, ato nuk mund të konsideroheshin thjesht verifikime paraprake, por veprime procedurale me efekt provues, të cilat kërkonin ekzistencën e një procedimi penal të regjistruar. Në këtë kuptim, përgjigjja e Gjykatës së Lartë nuk i jepte zgjidhje të plotë dallimit të ngritur nga kërkuesi ndërmjet veprimeve verifikuese të lejueshme përpara regjistrimit të procedimit penal dhe veprimeve procedurale për mbledhjen e të dhënave ose provave. Po kështu, ajo nuk i jepte përgjigje të mjaftueshme ndikimit që pretendimet për pavlefshmërinë e akteve dhe papërdorshmërinë e provave mund të kishin mbi vetë bazën provuese të dyshimit të arsyeshëm, si kusht kushtetues për kufizimin e lirisë personale në fazën e caktimit dhe të verifikimit të masës së sigurimit.

9. Në këtë kuptim, pa vënë në dyshim se vlefshmëria dhe përdorshmëria e akteve mund të jenë objekt shqyrtimi edhe në gjykimin e themelit, në vlerësimin tim, për aq sa këto argumente ishin ngritur për të kundërshtuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në fazën e caktimit dhe të verifikimit të masës së sigurimit personal, ato nuk mund të trajtoheshin vetëm si pretendime që i përkisnin procesit të themelit. Kjo për arsye se kërkesa kushtetuese e dyshimit të arsyeshëm për kufizimin e lirisë nënkupton mbështetjen e tij në të dhëna, informacione ose fakte objekt prove që, në tërësinë e tyre, janë të afta të bindin një vëzhgues objektiv për mundësinë e kryerjes së veprës penale nga personi i dyshuar. Për rrjedhojë, edhe pse në këtë fazë nuk kërkohet i njëjti nivel provueshmërie si në gjykimin e themelit, për sa kohë kërkuesi kishte pretenduar se vetë të dhënat ose provat mbi të cilat ishte formuar dyshimi i arsyeshëm ishin marrë në shkelje të ligjit dhe ishin të papërdorshme, Gjykata e Lartë duhej të jepte një përgjigje më të individualizuar dhe më të plotë për këtë aspekt, pa qenë e nevojshme të zëvendësonte gjykatat e faktit në vlerësimin e provave ose të shprehej përfundimisht për përgjegjësinë penale në themel.

10. Ndërsa për sa u përket formulimeve të përdorura nga gjykatat e zakonshme, të cilat, sipas kërkesit, kanë cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë, shumica ka marrë përsipër ta vlerësojë bazueshmërinë në themel të këtij pretendimi duke çmuar se, ndonëse disa formulime nuk duken plotësisht në linjë me standardet kushtetuese dhe konventore, ato, të lexuara në kontekstin e përgjithshëm të vendimeve, nuk mjaftojnë për të konstatuar cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë (*shih paragrafët 92-98 të vendimit*). Në vlerësimin tim, kjo qasje nuk merr parasysh mjaftueshëm faktin se Gjykata e Lartë nuk i kishte dhënë përgjigje të veçantë dhe të plotë dimensionit të këtij pretendimi, ashtu siç ishte ngritur në rekurs. Gjykata e Lartë ka pranuar se formulimi i gjykatave të posaçme për mungesë pendese nuk ishte korrekt, pasi edhe në këtë fazë të procesit i hetuari prezumohet i pafajshëm dhe ky parim duhet të garantohet efektivisht, megjithatë, sipas saj, ky arsyetim nuk ishte në atë shkallë sa të cenonte vlefshmërinë e disponimit përfundimtar të gjykatave të posaçme.

11. Në vlerësimin tim, kjo përgjigje nuk ishte e mjaftueshme, sepse pretendimi i kërkesit nuk lidhej vetëm me një formulim të veçuar për mungesë pendese, por me mënyrën sesi gjykatat kishin arsyetuar dyshimin e arsyeshëm, rrezikshmërinë e kërkesit, sjelljen e tij dhe të personave të tjerë, si dhe me përdorimin e formulimeve që, sipas kërkesit, krijojnë perceptimin e një qëndrimi të paracaktuar për fajësinë. Në këtë drejtim, kam parasysh se kërkesi kishte pretenduar se gjykatat e posaçme kishin përdorur gjuhën e akuzës si arsyetim gjyqësor, kishin bërë vlerësime që tejkalonin kufijtë e dyshimit procedural dhe kishin mbështetur masën edhe në formulime që, sipas tij, shprehnin bindje për fajësinë ose mungesë bashkëpunimi të tij, përfshirë referencat për mungesë pendese, përfitime të parregullta, sjellje të ardhshme dhe rrezikshmëri të nxjerrë nga statusi publik. Për këtë arsye, në respektim të parimit të subsidiaritetit, Gjykata nuk duhej të vlerësonte drejtpërdrejt në themel nëse këto formulime, qoftë edhe të lexuara në tërësi, cenonin ose jo prezumimin e pafajësisë. Ajo duhej të konstatonte se Gjykata e Lartë nuk kishte dhënë një përgjigje të plotë dhe të mjaftueshme ndaj këtij pretendimi me natyrë kushtetuese dhe, për këtë shkak, çështja duhej t'i kthehej asaj për shqyrtim edhe për këtë aspekt, me qëllim që të verifikoheshin nëse arsyetimi i gjykatave të posaçme kishte mbetur brenda kufijve të dyshimit procedural ose kishte kaluar në formulime që mund të perceptoheshin si paragjykim i fajësisë.

12. Për sa më sipër, edhe pse pajtohem me zgjidhjen e çështjes nga Gjykata, pra me pranimin e pjesshëm të kërkesës së kërkesit dhe shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të

Gjykatës së Lartë për shkak të cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor në kontrollin e proporcionalitetit të kufizimit të lirisë personale, të lidhur edhe me të drejtën për t'u zgjedhur, si dhe për shkak të mungesës së arsytimit nga Gjykata e Lartë për pretendimin për cenimin e dinjitetit dhe të parimit të prezumimit të pafajësisë, për shkak të qëndrimit të kërkuarit në kafaz/kabinën e xhamit gjatë seancave gjyqësore, kam mbajtur qëndrimin se shfuqizimi i këtij vendimi duhej të mbështetej edhe në mungesën e përgjigjes së mjaftueshme ndaj pretendimeve të kërkuarit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes në gjykimin në apel dhe dyshimit të arsyeshëm të lidhur me prezumimin e pafajësisë. Këto pretendime kanë natyrë kushtetuese dhe ishin ngritur në mënyrë të tillë që kërkonin një përgjigje të posaçme nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, në vlerësimin tim, çështja duhej t'i kthehej Gjykatës së Lartë për shqyrtim jo vetëm për shkaqet e pranuar nga Gjykata, por edhe për trajtimin e këtyre pretendimeve të kërkuarit.

Anëtar: Ilir Toska

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuarit Erion Veliaj, me objekt shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit që kanë caktuar dhe kanë lejuar vazhdimin e ekzekutimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj tij, unë, gjyqtarja Sonila Bejtja, kam mbajtur qëndrim të ndryshëm nga shumica për pretendimin për cenimin e lirisë personale në drejtim të standardit të dyshimit të arsyeshëm. Në qasjen time në këtë çështje, në të njëjtën linjë me qasjen e mbajtur në çështjen me kërkuar Ilir Metaj (*shih mendimin e pakicës në vendimin e Gjykatës nr. 48, datë 08.04.2026*), jam e qëndrimit se gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme dhe bindëse në drejtim të ekzistencës së provave që justifikojnë dyshimin se kërkuari mund të ketë kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

2. Pa u ndalur në mënyrë të zgjeruar në standardet kushtetuese të zbatueshme, të cilat janë detajuar në mendimin tim në çështjen tjetër, të sipërcituar, ritheksoj se, në kuptim të nenit 27 të

Kushtetutës, i cili synon të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë, kërkesa “dyshime të arsyeshme” për kryerjen e veprës penale nënkupton ekzistencën e fakteve ose të informacioneve që arrijnë të bindin edhe një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale. Këto dyshime nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato për të cilat nevojitet ngritja e akuzës ose justifikimi i dënimit penal, që i përkasin një shkalle të mëvonshme të procesit të hetimit penal. Në zbatim të dispozitës kushtetuese, neni 228, pika 1, i KPP-së përcakton si kusht të domosdoshëm (*sine qua non*) për caktimin e masës së sigurimit personal, ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në prova se individ i ka kryer një veprë penale.

3. Në rastin konkret dyshohet se kërkuesi, në bashkëpunim me persona të tjerë nën hetim, kanë kryer veprime aktive të kundërligjshme, të cilat konsistojnë në marrjen e përfitimeve të parregullta, në disa episode të veçanta, në formë shumash monetare, por edhe pasurish të paluajjtshme nga shtetas ose subjekte tregtare, të cilat kanë pasur interesa të drejtpërdrejta financiarë me Bashkinë e Tiranës, ku ai është titullar. Sipas gjykatave, deri në këtë fazë të hetimit paraprak ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se roli i kërkuesit ka qenë përcaktues në këto veprime të paligjshme që janë pjesë e një skemë korruptive, me qëllimin kriminal të përfitimit të parregullt që buron nga funksioni i tij. Faktet penale, sipas vendimeve gjyqësore, janë:

3.1. Kërkuesi dhe bashkëshortja e tij kanë përfituar nga shoqëria “A.” sh.p.k. (me administrator G.S.) pasurinë “vilë”, të ndodhur në Qerret, për shkak të detyrës së kërkuesit si titullar i autoritetit kontraktor në procedurat e prokurimit që ka fituar kjo shoqëri. Kjo pasuri është fshehur dhe nuk është deklaruar në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, pasi është rezultat i një përfitimi të parregullt, dhënë kërkuesit për shkak të detyrës.

3.2. Kërkuesi ka përfituar shpenzimet e udhëtimit me bashkëshorten në dhjetor të vitit 2016 në Rotterdam, Holandë nga shoqëria “K.” sh.p.k. (me administrator F.B.), shoqëri që ka përfituar disa leje ndërtimi nga Bashkia e Tiranës. Po kështu, një OJF që dyshohet se kontrollohet nga bashkëshortja e kërkuesit, ka marrë sponsorizime për organizime eventesh të ndryshme nga kjo shoqëri.

3.3. Shoqëria “F.” sh.p.k. (me administrator Sh.F.), që ka përfituar disa leje ndërtimi dhe fonde publike nga Bashkia e Tiranës, është faturuar nga dy persona fizikë të

kontrolluar nga bashkëshortja e kërkuarit për shërbime konsulence ligjore, faturime që kanë qenë fiktive dhe të paracaktuara, pasi më pas këto shuma i kanë kaluar një OJF-je që dyshohet se kontrollohet nga bashkëshortja e kërkuarit.

- 3.4. Shoqëria “P.” sh.p.k. (me përfaqësues M.P.), e cila ka marrë leje ndërtimi nga Bashkia e Tiranës, dyshohet se ka kaluar përfitime të parregullta përmes OJF-ve që kontrollohen *de facto* nga bashkëshortja e kërkuarit, përmes shumave për sponsorizimin e eventeve të ndryshme kulturore.
- 3.5. Shoqëria “G.” sh.p.k. (me administrator S.K.), e cila ka fituar procedura prokurimi me entet në varësi të Bashkisë së Tiranës dhe ka marrë edhe leje ndërtimi nga Bashkia e Tiranës, ka blerë disa piktura nga një shoqëri (galeri arti) që dyshohet se kontrollohet nga bashkëshortja e kërkuarit, me një diferencë të lartë të çmimit me të cilin këto vepra arti janë blerë fillimisht nga galeria.
- 3.6. Përmes OJF-ve që dyshohet se kontrollohen *de facto* dhe *de jure* nga bashkëshortja e kërkuarit, këta të fundit kanë marrë përfitime të paligjshme në shuma të konsiderueshme, me qëllim pasurimin e tyre. Për rrjedhojë, ata janë akuzuar edhe se kanë kryer veprën penale të parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë, i KP-së, përmes integritetit në sistemin bankar të shumave monetare të siguruar si përfitime të parregullta, por edhe të fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë së pasurisë, në kushtet kur këto pasuri dihet se janë produkte të veprës penale, sipas nenit 260 të KP-së.

4. Shumica, pasi ka marrë në analizë vendimet e gjykatave të posaçme, objekt të ankimit kushtetues individual, ka arritur në përfundimin se kufizimi i lirisë personale të kërkuarit është vendosur me vendim gjyqësor dhe mbi bazën e dyshimit se ai mund të ketë kryer veprat penale për të cilat procedohet. Sipas saj, nga arsyetimi i vendimeve të gjykatave të zakonshme rezulton se dyshimi i arsyeshëm nuk është mbështetur në vlerësime të përgjithshme ose abstrakte, por në të dhëna, informacione dhe akte konkrete të administruara në atë fazë të procedimit, të cilat, në tërësinë e tyre, janë vlerësuar si të mjaftueshme për të krijuar një lidhje objektive midis kërkuarit dhe veprave penale për të cilat dyshohet. Po kështu, sipas shumicës, nuk rezulton që gjykatat e zakonshme të kenë vendosur masën e sigurimit në mungesë të çdo baze faktike ose mbi dyshime thjesht hipotetike dhe se në çështjen penale ndaj kërkuarit duket se ka informacione që do të

bindnin një vëzhgues të paanshëm se ai mund të ketë kryer veprat penale për të cilat është i dyshuar, ndaj nuk mund të konkludohet se ai është arrestuar në mungesë të dyshimit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 27, paragrafi 2, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenit 5, pika 1, shkronja “c”, të KEDNJ-së (*shih paragrafin 78 të vendimit*).

5. Në ndryshim nga shumica, duke pasur parasysh se, bazuar në jurisprudencën kushtetuese, kontrolli kushtetues për verifikimin e kushtetutshmërisë së masës kufizuese të lirisë personale ushtrohet përmes verifikimit të arsytimit të vendimeve gjyqësore në drejtim të mënyrës sesi kanë vlerësuar dhe zbatuar kushtet dhe kriteret për caktimin e masës ekstreme “Arresti në burg”, si dhe referuar këtij arsytimi në drejtim të atyre fakteve dhe provave të nevojshme për të justifikuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, si standardi kushtetues që duhet të respektohet në rastet përjashtimore të kufizimit të lirisë, unë kam mbajtur qëndrimin se gjykatat e zakonshme kanë dështuar në këtë drejtim. Kjo sepse, në rastin konkret, gjykatat e zakonshme nuk kanë arritur të justifikojnë kufizimin e lirisë personale të kërkuesit mbi dyshimin e arsyeshëm, për rrjedhojë ai është arrestuar në kundërshtim me nenin 27, paragrafi 2, të Kushtetutës.

6. Referuar vendimeve gjyqësore për veprimet që i atribuohen kërkuesit dhe qëllimit që ai ka pasur për të përfituar në mënyrë të paligjshme pasuri të luajtshme dhe paluajtshme, ato qartazi bazohen mbi fakte të përgjithshme, të pakonkretizuara, sidomos në drejtim të lidhjes së veprave penale individualisht me kërkuesin. Gjykatat janë bazuar në arsytime *de plano*, të përgjithshme, që lidhen me faktin se shoqëritë në fjalë kanë përfituar nga Bashkia e Tiranës leje ndërtimi ose fonde publike përmes pjesëmarrjes në procedura prokurimi, pra, *nga njëra anë*, pranojnë se kjo marrëdhënie ka lindur për shkak të parashikimeve ligjore dhe ushtrimit nga kërkuesi të kompetencave të tij dhe, nga *ana tjetër*, nuk arrijnë të argumentojnë se përfitimi i këtyre lejeve ose kontratave publike ka qenë i parregullt dhe është bërë nga kërkuesi në kundërshtim me kriteret ligjore, për shkak të përftimit të parregullt. Gjykatat e kanë bazuar të gjithë arsytimin në sponsorizimet që shoqëritë në fjalë kanë bërë për disa OJF, me qëllim organizimin e eventeve kulturore apo edhe kalime shumash në forma të tjera, duke i lidhur këto të fundit me bashkëshorten e kërkuesit, e cila dyshohet se ka kontrollin *de facto* të tyre, pa provuar këto dyshime përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Po kështu, qëndrimi i gjykatave bazohet edhe mbi interesimin dhe publicitetin që vetë kërkuesi u ka bërë disa eventeve kulturore, pa e lidhur dot këtë sjellje me paligjshmërinë e veprimeve të tij në drejtim të veprave penale për të cilat akuzohet. Në tërësinë e

tyre vendimeve të gjykatave të zakonshme, edhe pse voluminoze, u mungon arsyetimi për lidhjen mes provave të administruara dhe sjelljeve/veprimeve konkrete që përbëjnë elemente të veprave penale. Kjo analizë, duke qenë kaq formaliste dhe e përgjithshme, bën që kontrolli i gjykatave për verifikimin e kushteve dhe kritereve që lejojnë kufizimin e lirisë personale të jetë tërësisht formal, thjesht duke renditur, listuar dhe evidentuar në mënyrë mekanike provat, por pa kryer ndonjë analizë të thelluar se në ç'mënyrë, për çdo rast, kërkuesi ka ndërhyrë, përmes ushtrimit të funksionit të tij si kryetar i Bashkisë së Tiranës, për përfitimin në mënyrë të parregullt të pasurive për vete dhe familjen e tij. Për rrjedhojë, gjykatat e zakonshme kanë dështuar të arsyetojnë në mënyrë të plotë dhe të mjaftueshme ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, si kërkesa e parë dhe e qenësishme për të lejuar në këndvështrimin kushtetues kufizimin e lirisë individuale.

7. Sipas GJEDNJ-së, “arsyeshmëria” e dyshimit mbi të cilin duhet të bazohet një arrestim përbën një pjesë thelbësore të mbrojtjes së përcaktuar në nenin 5, pika 1, shkronja “c”, të KEDNJ-së (shih *Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2) [DhM], datë 22.11.2020, § 314; Mehmet Hasan Altan kundër Turqisë, datë 20.03.2018, § 124; Fernandes Pedroso kundër Portugalisë, datë 12.06.2018, § 87*). Fakti që një dyshim mbahet me mirëbesim është i pamjaftueshëm në vetvete (shih *Sabuncu dhe të tjerë kundër Turqisë, datë 10.11.2020, § 145*). Po sipas GJEDNJ-së, një “dyshim i arsyeshëm” se është kryer një veprë penale supozon ekzistencën e fakteve ose informacionit që do të bindte një vëzhgues objektiv se personi në fjalë mund të ketë kryer një veprë penale (shih *Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2) [DhM], datë 22.11.2020, § 314; Ilgar Mammadov kundër Azerbajxhanit, datë 22.05.2014, § 88*). Dyshimet duhet të justifikohen me prova të verifikueshme dhe objektive ndërsa referencat e paqarta dhe të përgjithshme në vendimet dhe dokumentet e autoriteteve nuk mund të konsiderohen të mjaftueshme për të justifikuar “arsyeshmërinë” e një dyshimi, në mungesë të ndonjë deklarate, informacioni ose ankese specifike (shih *Akgün kundër Turqisë, datë 20.07.2021, §§ 156 dhe 175*). Si rregull, sipas asaj gjykate, problemet me “arsyeshmërinë e dyshimit” lindin në nivelin e fakteve. Ndaj pyetja që shtrohet është nëse arrestimi dhe ndalimi janë bazuar në elemente të mjaftueshme objektive për të justifikuar një “dyshim të arsyeshëm” se faktet në fjalë kanë ndodhur në të vërtetë. Përveç kësaj, ekzistenca e një “dyshimi të arsyeshëm” kërkon edhe që në lidhje me faktet të arsyetohet në mënyrë të arsyeshme se ato bien në fushën e veprimit të dispozitave të ligjit penal (shih *Selahattin Demirtaş kundër*

Turqisë (nr. 2) [DhM], datë 22.11.2020, § 317; Sabuncu dhe të tjerë kundër Turqisë, datë 10.11.2020, §§ 146-147).

8. Në kontekst të këtyre standardeve dhe referuar arsytimit të gjykatave të zakonshme në vendimet objekt të ankimit kushtetues, ritheksoj se pavarësisht numrit të konsiderueshëm të akteve të mbledhura gjatë hetimeve, të referuara në vendime voluminoze të gjykatave të faktit, ato nuk kanë qenë në gjendje të argumentojnë se cilat janë ato të dhëna që i atribuohen kërkuesit dhe që konsiderohen të mjaftueshme dhe në gjendje të justifikojnë “arsyeshmërinë” e dyshimit se ai mund të ketë kryer veprat penale në fjalë. Në vlerësimin tim, i cili bazohet vetëm mbi sa është arsyetuar/argumentuar/parashtruar nga gjykatat e faktit e të ligjit dhe jo mbi ndonjë vlerësim ose analizë të vet këtyre provave e akteve, duke mos qenë ky as rasti konkret (ndonëse në jurisprudencën kushtetuese është pranuar se në disa raste vlerësimi i provave bën pjesë në juridiksionin kushtetues (*shih vendimin nr. 26, datë 29.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese*), as qëllimi i analizës së çështjes në shqyrtim përpara Gjykatës, edhe në këtë rast, sikundër në shumë raste të tjera të ngjashme, gjykatat sërish nuk kanë mundur të tejkalojnë dhe dalin përtej formalizmit të tepruar që përshkon arsyetimin e këtyre lloj vendimesh për caktimin e masave të sigurimit, pa mundur ato të provojnë dhe arsyetojnë mbi provat e nevojshme mbi të cilat krijohet ajo bindje e arsyeshme se kërkuesi ka kryer ndonjë nga veprat penale për të cilat akuzohet. Në ndryshim nga çfarë pretendohet nga shumica, në referim të vendimeve gjyqësore, është e evidentueshme se ato nuk kanë mundur të dëshmojnë qoftë edhe në nivelin e indicieve minimale faktet penale që i janë ngarkuar kërkuesit.

9. Në situatën që vlerësimi i gjykatave të zakonshme ka qenë formal, i takonte gjykimit kushtetues të bënte kontrollin efektiv të zbatueshmërisë të standardeve kushtetuese në rastin konkret. Në këtë pikë ritheksoj se dyshimet duhet të lindin dhe të bazohen në prova dhe nuk duhet të prezumohen bazuar në natyrën/rëndësinë e veprave penale të dyshuara si të kryera ose në aludimet e paqartësitë e akuzës pasi kanë përfunduar hetimet. Kjo do të thotë se nëse provat mbi të cilat mbështetet fillimisht kërkesa për caktimin e masës së sigurimit e pas kësaj vendimet që kufizojnë lirinë përmes paraburgimit të personit të hetuar janë të mangëta/të paplota/të paqarta ose të paafta të lindin dyshimin e arsyeshëm, masa shndërrohet në haptazi arbitrarë. Kjo shkelje konstatohet edhe në rastin e kërkuesit, për sa kohë gjykatat nuk kanë argumentuar mbi prova të

plota/të mjaftueshme e bindëse që të japin të dhëna se dyshimet kanë bazë të arsyeshme për përfshirjen e tij në një veprimtari kriminale që legjitimon kufizimin e lirisë personale.

10. Parë nga kjo optikë, çmoj se të dhënat që referojnë gjykatat e zakonshme se përbëjnë elemente të mjaftueshme për të vendosur kufizimin e lirisë së kërkuesit nuk arrijnë të përmbushin as atë prag minimal që është i nevojshëm për të lindur dyshimin te një vëzhgues objektiv se ka pasur një veprë penale dhe se autor i saj mund të jetë kërkuesi. Përkundrazi, ritheksoj se veprimet e kërkuesit të analizuara nga gjykatat kanë të bëjnë me mënyrën e ushtrimit të funksionit të tij, gjatë të cilit ai ka nënshkruar edhe disa leje ndërtimi ose kontrata publike me shoqëri të ndryshme, përfshirë ato të referuara nga gjykatat, marrëdhënie të cilat nuk është provuar se kanë qenë të paligjshme ose se veprimet e kërkuesit janë kryer kundrejt premtimit ose shpërblimit. Për më tepër, gjykatat referojnë veprime të kryera mes këtyre shoqërive dhe disa OJF-ve, duke argumentuar se këto të fundit janë nën kontrollin *de facto* të bashkëshortes së kërkuesit, por pa evidentuar lidhjen mes këtyre marrëdhënieve të lindura dhe zhvilluara mes subjekte të së drejtës private.

11. Për sa më sipër, në vlerësimin tim është e dukshme se gjykatat kanë dështuar që të arsyetojnë, në përputhje me praktikën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, në këtë aspekt, pra në këndvështrim të përmbushjes së garancisë kushtetuese sipas nenit 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, që lejon përjashtimisht kufizimin e lirisë personale të individit, duke mos ushtruar ato rolin subsidiar të kontrollit kushtetues të veprimeve të autoriteteve publike dhe të ndalimit të arbitraritetit në ushtrimin e veprimtarisë së këtyre të fundit. Duke iu referuar standardit të përdorur në këto raste, në çështjen e kërkuesit arsyetimi i gjykatave nuk bind qoftë edhe një vëzhgues objektiv se ai mund të ketë kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

12. Po kështu, unë kam mbajtur edhe qasjen (*shih mendimin paralel*) se Gjykata, përveç mungesës së dyshimit të arsyeshëm, duhej të konstatonte edhe cenimin e proporcionalitetit të masës, si shkelje e aspektit substancial të lirisë personale dhe jo të lidhur me mungesën e arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë.

13. Për sa më sipër, për sa kohë që kërkuesi është arrestuar në mungesë të dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprave penale për të cilat ai akuzohet, pasi gjykatat nuk janë bazuar në prova dhe fakte konkrete dhe të individualizuara, si dhe për sa kohë që vetë masa e arrestit është joproporcionale, duke i pamundësuar atij edhe ushtrimin e mandatit të fituar, pra duke i cenuar edhe të drejtën për t'u zgjedhur, unë kam votuar për pranimin e kërkesës dhe prishjen e vendimeve

të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe të GJKKO-së së Apelit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në GJKKO-në e Apelit, e cila, në përputhje me kompetencat e saj, duhet të riparojë shkeljet e konstatuara dhe të rivendosë të drejtat dhe liritë kushtetuese të cenuara kërkuarit.

Anëtare: Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtari Asim Vokshi, në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuarit Erion Veliaj, me objekt kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të posaçme dhe Gjykatës së Lartë që kanë caktuar, lejuar dhe miratuar vazhdimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj tij, njësoj siç kam mbajtur qëndrimin në fazën e shqyrtimit paraprak të çështjes në Gjykatë (në janar të vitit 2026), se ankimi kushtetues i kërkuarit nuk ngrinte shkaqe të rëndësishme për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues, vijoj të kem të njëjtën bindje edhe pas shqyrtimit të çështjes në themel. Për rrjedhojë, në vijim, do të parashtoj argumentet mbi të cilat bazohet qëndrimi im i mbetur në pakicë në këtë çështje, për sa i përket dispozitivit dhe arsyeve të vendimit të Gjykatës me të cilin u shfuqizua vendimi i Gjykatës së Lartë.

2. Paraprakisht vlen të theksohet se, siç Gjykata bëri publike në njoftimin e datës 25.05.2026,⁴ shumica ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës, duke shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Lartë dhe kthyer çështjen për shqyrtim në atë gjykatë, duke dhënë njëkohësisht përgjigjen përkatëse të përmbledhur për secilin nga pretendimet e kërkuarit. Konkretisht, sipas atij njoftimi publik:

⁴ <https://www.gjykatakushtetuese.gov.al/njoftim-vendimmarrjeje-9/>

- Në aspektin procedural, Gjykata shqyrtoi pretendimet për cenimin e:

1. *Së drejtës së mbrojtjes*, për shkak të kohës së pamjaftueshme në dispozicion për njohjen me aktet e dosjes dhe të qëndrimit të kërkuarit në kafaz/kabinën e xhamit gjatë procesit gjyqësor në gjykatat e faktit. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata, me shumicë votash, vendosi rrëzimin e tij si të pabazuar.
2. *Parimit reformatio in peius (mosrëndimit të pozitës)* të lidhur me marrjen e provave të reja në GJKKO-në e Apelit, të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata nuk arriti numrin prej pesë votash për vendimmarrje, për rrjedhojë, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, ai konsiderohet i rrëzuar.

- Në aspektin substancial, Gjykata shqyrtoi pretendimet për cenimin e:

1. *Dinjitetit dhe prezumimit të pafajësisë* të lidhur me qëndrimin e kërkuarit në kafaz/kabinën e xhamit gjatë procesit gjyqësor në gjykatat e faktit. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata, me shumicë votash, vendosi pranimin e tij në drejtim të mungesës së arsytimit nga Gjykata e Lartë të këtij pretendimi të parashtruar në rekurs nga kërkuari.

2. *Lirisë personale në drejtim të:*

- *Dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova* për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuarit të lidhur edhe me parimin e prezumimit të pafajësisë, për shkak të gjuhës së përdorur në arsyetimin e vendimeve të gjykatave. Në lidhje me këtë pretendim Gjykata, me shumicë votash, vendosi rrëzimin e tij si të pabazuar.
- *Proporcionalitetit të masës* të lidhur me të drejtën për t'u zgjedhur, të cilin Gjykata, me shumicë votash, e gjeti të bazuar vetëm në drejtim të faktit që Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje të arsyetuar këtij pretendimi të ngritur në rekurs nga kërkuari.

3. Vlerësoj të mos ndalem te pretendimet e rrëzuara, pasi argumentet për to jepen në vendimin përfundimtar të Gjykatës, për të cilat nuk kam kundërshtime thelbësore, por në vijim do të parashtoj argumentet pse nuk duhej shfuqizuar vendimi i Gjykatës së Lartë në drejtim të:

- a. *Dinjitetit dhe prezumimit të pafajësisë* të lidhur me qëndrimin e kërkuarit pas murit të xhamit gjatë procesit gjyqësor në gjykatat e faktit, në drejtim të mungesës së arsytimit nga Gjykata e Lartë të këtij pretendimi të parashtruar në rekurs nga kërkuari;

b. *Proporcionalitetit të masës të lidhur me të drejtën për t`u zgjedhur*, në drejtim të faktit që Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje të arsyetuar këtij pretendimi të ngritur në rekurs nga kërkuesi.

c. Po ashtu do të paraqes edhe mendimin tim të pakicës për aspektin e pasqyruar në paragrafët 116-118 të vendimit të arsyetuar të Gjykatës në lidhje me *proporcionalitetin e masës* në drejtim të mungesës së arsytimit të Gjykatës së Lartë, për sa i përket *individualizimit të rreziqeve dhe nevojave të sigurimit* si pjesë të kushteve për caktimin e masës së sigurimit konform nenit 228, pika 3, të KPP-së.

4. *Së pari*, vlerësoj se, në të njëjtën mënyrë siç është argumentuar në vendimin e Gjykatës për rrëzimin e pretendimit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes për shkak të qëndrimit të kërkuesit pas një muri xhami, thjesht qëndrimi i kërkuesit pas këtij muri xhami gjatë procesit gjyqësor në gjykatat e faktit, në fazën e caktimit fillestar të masës së sigurimit (që për nga natyra është një gjykim i shpejtë), pa u provuar ardhja e pasojave të rënda që mund të konsiderohen poshtëruese, nuk është i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin e cenimit të dinjitetit të tij. Neni 3 i KEDNJ-së, që sanksionon një nga vlerat më themelore të një shoqërie demokratike, duke ndaluar në mënyrë absolute edhe trajtimin çnjerëzor ose degradues, pavarësisht nga rrethanat dhe sjellja e viktimës, kërkon një nivel minimal ashpërsie, i cili vlerësohet bazuar në rrethanat e çështjes, siç janë kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij dhe në disa raste, seksi, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës (*shih Jalloh kundër Gjermanisë [DhM], nr. 54810/00, datë 11.07.2006, § 67*). GJEDNJ-ja ka pranuar se izolimi në kafaz metalik binte ndesh me nenin 3 të Konventës, për shkak të natyrës degraduese të këtij objekti (*shih Svinarenko dhe Slyadnev kundër Rusisë [DHM], datë 17.07.2014; §§ 135-138*). Nga ana tjetër, GJEDNJ-ja ka konstatuar tashmë se vendosja e të pandehurve pas mureve prej xhami ose në doke prej xhami nuk përfshin në vetvete një element poshtërimi të mjaftueshëm për të arritur nivelin minimal të ashpërsisë (*shih Yaroslav Belousov kundër Rusisë, datë 04.10.2016, §§ 124, 125*).

5. GJEDNJ-ja edhe në jurisprudencën e saj të viteve të fundit (*shih Zinchenko dhe Tamtura kundër Ukrainës, datë 05.03.2026 dhe Federici kundër Francës, datë 03.04.2025*) ka ritheksuar se vendosja e të pandehurit prapa një muri xhami, kur kushtet e qëndrimit aty janë optimale, nuk përbën në vetvete shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së. Për rrjedhojë, ky pretendim, në vlerësimin tim të mbetur në pakicë, është i pabazuar në planin kushtetues, për sa kohë që nga kërkuesi nuk është

arritur të argumentohet mjaftueshëm në nivel kushtetues cenimi i dinjitetit të tij për shkak të qëndrimit në sallën e gjyqit pas një muri xhami, në kushte jo degraduese, gjatë seancës së marrjes në pyetje nga gjykata, e cila përbën një veprimtari të ngutshme procedurale. Vetëm fakti që Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje të detajuar këtij pretendimi nuk vë në dyshim procesin e zhvilluar në atë gjykatë dhe vendimmarrjen e saj e aq më pak masën e sigurimit të caktuar në gjykatat më të ulëta. Edhe nëse Gjykata e Lartë do të konstatonte nëpërmjet arsytimit të saj shkelje, gjithsesi ajo ligjërisht nuk kishte në dispozicion ndonjë opion vendimmarrjeje, çka nuk justifikon cenimin e vendimit të saj dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Fakti në fjalë nuk mund të ndikonte *a priori* në zbutjen e masës së sigurimit ndaj kërkuesit.

6. Masa e zbatuar e sigurimit dhe pretendimi i kërkuesit për trajtim degradues për shkak të qëndrimit pas murit të xhamit, janë dy gjëra të ndryshme që nuk ndikojnë në mënyrë abstrakte te njëra-tjetra. Gjykata i gjeti të pabazuara pretendimet e kërkuesit për kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” ose thënë ndryshe pranoi ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova për caktimin e kësaj mase (*shih paragrafët 80-99 të vendimit*). Ndërsa pretendimi për trajtim poshtërues vetëm për shkak të qëndrimit pas murit të xhamit, për sa kohë që nuk rezulton të jetë tejkaluar një nivel minimal ashpërsie në drejtim të pengimit të kërkuesit në komunikimin me avokatët e tij ose ndjekjen efektive të zhvillimit të seancës dhe pjesëmarrjen aktive në të, përbën një element faktik pa asnjë ndikim në caktimin ose vlefshmërinë e masës. Ajo është çështje që lidhet me organizimin e infrastrukturës gjyqësore në sallat e gjyqimit. GJEDNJ-ja ka pranuar se instalimi i elementeve të sigurisë në sallat e gjyqit, në vetvete, nuk e bën një proces penal të padrejtë. Faktorët vendimtarë janë natyra, shtrirja, mënyra e zbatimit dhe arsytet që qëndrojnë në themel të përdorimit të tyre (*shih Simon Price kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 15.09.2016, § 88*).

7. Pakica vlerëson se parashikimi i nenit 344, pika 1, të KPP-së se “i pandehuri merr pjesë në seancë si person i lirë edhe kur është i paraburgosur [...]”, nuk përjashton marrjen e masave me karakter të përgjithshëm për të shmangur kontaktin e paautorizuar dhe të papërshtatshëm të personit nën hetim me persona të tretë që mund të jenë të pranishëm në sallën e gjyqimit, edhe kur kjo nuk është me dyer të hapura. Parashikim të ngjashëm me këtë ka edhe Direktiva (EU) 2016/343 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 09.03.2016 për forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës për të qenë i pranishëm në seancë në çështjet penale,

konkretisht paragrafi 20 i saj, i cituar nga GJEDNJ-ja në paragrafin 24 të vendimit të saj *Federici kundër Francës*, të datës 03.04.2025, në të cilin kjo gjykatë e të drejtave të njeriut nuk gjeti shkelje për sa i përket mbajtjes së aplikantit pas një muri xhami gjatë gjykimit në gjykatën e krimeve të rënda. Pakica thekson qëndrimin e GJEDNJ-së se pretendimet për cenimin e nenit 3 të KEDNJ-së shihen jo në mënyrë abstrakte, por rast pas rasti dhe kërkuesi duhet të argumentojë mjaftueshëm pretendimet e tij. Në rastin konkret, bazuar në rrethanat e kësaj çështjeje, vlerësohet se nuk është plotësuar kjo barrë e të argumentuarit të shkeljes së pretenduar, ndaj nuk kishte vend për cenimin e vendimit të Gjykatës së Lartë në këtë drejtim.

8. *Së dyti*, për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes të lidhur me të drejtën e kërkuesit për t'u zgjedhur dhe mungesës së arsytimit të Gjykatës së Lartë mbi këtë element, në vlerësimin tim, të shfaqur edhe në fazën e shqyrtimit paraprak, kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, duke qenë kjo një arsye për papranueshmëri të këtij pretendimi në gjykimin kushtetues. Ishte e njohur për gjykatat e zakonshme se kërkuesi ushtronte detyrën e kryetarit të Bashkisë së Tiranës në kohën kur ndaj tij u caktua masa e sigurimit personal “Arresti në burg” (objekt i këtij ankimi kushtetues), por argumentet e parashtruara përpara Gjykatës në lidhje me kuptimin e nenit 242 të KPP-së (që ndalon pezullimin nga detyra të të zgjedhurve sipas Kodit Zgjedhor) dhe efektin e “pezullimit de facto” të tij për shkak të “Arrestit në burg” nuk janë parashtruar më parë përpara gjykatave të zakonshme. Për më tepër, ashtu siç është parashtruar ky argument, që lidhet me interpretimin e harmonizuar të neneve 230 dhe 242 të KPP-së, përbën haptazi një çështje të interpretimit të ligjit, që u përket gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, veçanërisht Gjykatës së Lartë dhe del jashtë juridiksionit kushtetues, nëse nuk shterohet më parë juridiksioni i zakonshëm gjyqësor. Kërkuesi në ngritjen e këtyre argumenteve, të pashteruara më parë përpara gjykatave të zakonshme, ka marrë shkas apo është frymëzuar nga vendimi i Gjykatës për shfuqizimin e aktit të shkarkimit administrativ të tij nga detyra e kryetarit të Bashkisë së Tiranës. Në kohën e ushtrimit të rekursit drejtuar Gjykatës së Lartë prej kërkuesit (para datës 08.07.2025), nuk ishte nxjerrë ende VKM-ja nr. 539/2025 që e shkarkonte kërkuesin nga detyra e kryetarit të Bashkisë së Tiranës, vendim i cili u shfuqizua nga Gjykata vetëm 18 ditë para se kërkuesi t'i drejtohej kësaj Gjykate me ankimin kushtetues individual (i cili mban datën 21.11.2025) për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit “Arresti në burg”, ndaj argumentet e tij për

faktet e ngjara pas dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë nuk mund t'i nënshtrohen juridiksionit kushtetues pa shteruar më parë juridiksionin e zakonshëm. Gjykata e Lartë nuk kishte sesi të merrte në shqyrtim shkaqe që nuk ishin argumentuar nga kërkuesi, pasi ndonëse ishte i njohur fakti se masa e sigurimit "Arresti në burg" ishte vendosur ndaj kryetarit të bashkisë, duke e penguar atë të ushtrojë funksionin, kërkuesi nuk argumentonte në rekurs se kishte ndonjë ndalim ligjor për caktimin e kësaj mase, që Gjykata e Lartë ta analizonte më vete e të mbante qëndrim të posaçëm për të (*shih rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë*). Proporcionaliteti i masës së sigurimit i lidhur me të drejtën e kërkuesit për t'u zgjedhur dhe për të ushtruar detyrën e kryetarit të bashkisë nuk është argumentuar ose ngritur mjaftueshëm në rekursin e tij drejtuar Gjykatës së Lartë, ndaj ai kërkim i ri i paraqitur në juridiksionin kushtetues, për të cilin shumica prishi vendimin e Gjykatës së Lartë, nuk është shteruar më parë në gjykatat e zakonshme e, rrjedhimisht, nuk mund të përbënte shkak për cenimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.

9. Edhe Raporti i Komisionit të Venecias CDL-AD(2025)045, datë 24.10.2025 "Për ndikimin e paraburgimit të kryetarëve të bashkive në ushtrimin e qeverisjes demokratike vendore", i cituar nga kërkuesi përpara Gjykatës, mban një datë më të vonë se vendimi i Gjykatës së Lartë ose vendimet e gjykatave të posaçme. Për rrjedhojë, nuk mund të përdorej si argument para tyre në kohën kur këto vendosën për caktimin dhe vijimin e masës së sigurimit "Arresti në burg". Ky është një faktor tjetër që evidenton faktin se kërkuesi nuk ka shteruar në substancë dhe as formalisht para gjykatave të zakonshme, në lidhje me këtë gjykim kushtetues, argumentet për cenimin e parimit të proporcionalitetit në këndvështrim të së drejtës për t'u zgjedhur. Për këto arsye, Gjykata nuk duhej t'i merrte parasysh ato.

10. Masa e arrestit e caktuar ndaj kërkuesit, ashtu siç pranohet nga Gjykata (*shih paragrafin 91 të vendimit*), është në përputhje me dispozitat procedurale penale dhe gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar në mënyrë të plotë dhe shteruese në këtë drejtim, për sa i përket dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova. Masa "Arresti në burg" në rastin konkret është vendosur për një qëllim të ligjshëm, garantimin e mbarëvajtjes së procesit penal dhe nuk duket të jetë joproporcionale në kontekstin e rrethanave të çështjes dhe në raport me natyrën e veprave penale për të cilat dyshohet kërkuesi. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në vlerësimin e tyre për masën e sigurimit personal të vendosur ndaj kërkuesit, kanë argumentuar gjerësisht dhe në detaje për arsyet të cilat kanë justifikuar kufizimin, duke shfaqur një kujdes të veçantë në këtë drejtim, si

dhe përse kjo masë ishte masa më e përshtatshme për të arritur qëllimin për të cilën ishte kërkuar. Ato kanë analizuar jo vetëm dyshimin e arsyeshëm, të bazuar në prova, se kërkuesi mund të ketë kryer veprat penale për të cilën akuzohet, por edhe ekzistencën e kritereve të tjera që justifikojnë kufizimin e lirisë sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së. Gjykatat e zakonshme madje (*arsye kjo e pakicës për mosdakordësi për sa i përket paragrafëve 116-118 të vendimit të Gjykatës*), ndonëse në kohën e shqyrtimit të çështjes prej tyre nuk kishte dalë ende vendimi penal i datës 04.05.2026 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duket se i kanë paraprirë atij dhe kanë dhënë arsytim shterues në pajtim edhe me orientimet aktuale të këtij vendimi të marrë për ndryshimin e praktikës gjyqësore, referuar vendimit unifikues nr. 7, datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në rastin e kërkuesit, gjykatat e zakonshme kanë shqyrtuar realisht dhe me dilijencë masat e tjera më pak kufizuese të lirisë personale (për shembull “Garancia pasurore”) dhe kanë arsytuar shprehimisht përse ato nuk ishin të mjaftueshme në rastin konkret, duke qenë kësaj arsytimi i tyre brenda hapësirave kushtetuese të vlerësimit gjyqësor. Gjykata e Lartë është pajtuar me arsyet e dhëna prej gjykatave, duke miratuar arsyet e vendimmarrjes së tyre. Nëse gjykatat arsyetojnë brenda hapësirës që u lejon Kushtetuta, atëherë vendimmarrja e tyre bëhet e pacenueshme dhe Gjykata nuk mund të shtrijë kontrollin e saj në aspektet e oportunitetit të vendimmarrjes, për sa kohë nuk argumenton një cenim të qartë dhe të hapur të ndonjë norme kushtetuese.

11. Nga leximi i vendimeve të gjykatave të zakonshme rezulton se në caktimin e masës “Arresti në burg” prokurori, fillimisht, dhe gjykatat, në vijim, kanë dhënë dhe bërë një arsytim jashtëzakonisht të individualizuar, të mbështetur në fakte e rrethana të posaçme të çështjes, që lidhnin nevojën e kësaj mase me rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit në rastin konkret. Ky vlerësim mbështetej në rrethanat specifike të faktit, në mënyrën e kryerjes së veprës dhe në të dhënat që lidhen me personin ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit, përfshirë personalitetin, sjelljen, rrethanat individuale e familjare, si dhe treguesit e tjerë të rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut real procedural ose shoqëror që ai paraqiste në çështjen konkrete, sidomos lidhur me faktin se veprat penale dyshohej se ishin kryer gjatë dhe për shkak të ushtrimit të detyrës si kryebashkiak. Gjatë arsytimit për rrezikshmërinë e veçantë të veprës dhe të autorit, në kuptim të nenit 230, pika 1, të KPP-së, masa e sigurimit “Arresti në burg” është përligjur nga gjykatat si masa më e përshtatshme që garantonte nevojat e sigurimit, konfirmuar edhe gjatë gjykimit në apel.

Rrezikshmëria e veçantë e veprës dhe e autorit nuk është nxjerrë vetëm ose kryesisht nga natyra e kriminit ose nga marzhi i dënimit, por nga vlerësimi i ndërthurur i rrezikshmërisë së veçantë të faktit penal, i mënyrës së kryerjes, pasojave të ardhura, i personalitetit të të pandehurit, i sjelljes së tij, si dhe i rrethanave të tjera të rëndësishme dhe të lidhura ndërmjet tyre për rastin konkret. Në këtë çështje Prokuroria e Posaçme duket se ka përmbushur në mënyrë të detajuar barrën e justifikimit të nevojës për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, ndërsa gjykata ka verifikuar dhe arsyetuar në lidhje me to në atë fazë të procedimit (përfshirë dhe gjykimin e faktit në apel). Prokuroria e Posaçme ka paraqitur dhe argumentuar në mënyrë konkrete faktet dhe rrethanat që mbështesnin nevojën e caktimit të masës “Arresti në burg”, përfshirë rrezikun konkret dhe papërshtatshmërinë e masave më pak kufizuese. Në vendimmarrjen e saj gjykata nuk është kushtëzuar nga paraqitja ose jo e “provave pozitive” nga personi nën hetim, por ka arsyetuar mjaftueshëm edhe për rrethanat faktike personale, familjare dhe rrethanat e tjera të ngritura prej tij në favor të masave më pak kufizuese.

12. Në këtë drejtim, për sa i përket individualizimit të nevojave të sigurimit në rastin konkret, në raport me proporcionalitetin e masës, në parashtrimet e saj të datës 12.03.2026 Prokuroria e Posaçme, pikërisht në lidhje me sa argumenton Gjykata në paragrafët 116-118 të vendimit, ka theksuar se lidhur me pretendimin e kërkuesit se masa e sigurimit personal është bazuar mbi “një rrezik abstrakt”, vlerëson se gjykatat e të gjitha shkallëve kanë pranuar se nga i pandehuri dhe rrethi i tij i afërt janë ndërmarrë tentativa reale për ndikim mbi dëshmitarë; janë shkatërruar, fshehur komunikime ose fabrikuar prova dhe akte shkresore. Gjithashtu, ndërhyrjet procedurale të cilat kanë ndodhur edhe pas arrestimit të shtetasit Erion Veliaj (kërkuesit), nuk janë argumentuar në mënyrë abstrakte, por mbi bazën e provave të mbledhura nga organi procedues dhe të paraqitura në seancë gjyqësore. Në rastin konkret rezulton se: 1) ndaj të pandehurit Erion Veliaj ekziston i konsoliduar tashmë “një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova” se i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet; 2) faktet dhe mënyra me të cilat kanë ndodhur veprat penale janë të tilla që sugjerojnë ekzistencën e një mendimi kriminal për marrjen në vazhdimësi të përfitimeve të parregullta (*modus operandi*), të vënë në zbatim në bashkëpunim me persona të tjerë; 3) kërkuesi disponon dhe shfrytëzon një rrjet të ngjeshur marrëdhëniesh personale, shumica e të cilave burojnë nga funksioni i tij si kryetar i bashkisë, mundësitë e pakufizuara financiare të cilat rriten në mënyrë eksponenciale duke pasur në konsideratë subjektet tregtare të cilat varen nga

vendimmarrjet e tij, si dhe mbulim të gjerë mediatik që ka synuar krijimin e një klime thellësisht intimiduese për mbarëvajtjen e hetimit dhe gjykimin penal. Në këtë kuadër, edhe aktualisht kërkuesi po shfrytëzon funksionin e kryetarit të bashkisë, duke imponuar vullnetin e tij për të përfshirë institucionin që financohet nga taksat e publikut në konflikte ligjore të natyrës administrative, ndërkohë që akuzat penale i janë atribuuar atij individualisht. Kjo gatishmëri për të aktivizuar bashkinë në funksion të një strategjie personale mbrojtjeje, të çon logjikisht te vlerësimi i arsyeshëm se vijon të ekzistojë rreziku se i njëjti mekanizëm mund të përdoret për të ndikuar në integritetin e provave në gjykim; 4) në veprat penale për të cilat është akuzuar kërkuesi, rezultojnë e provuar përfshirja aktive e familjarëve të afërt dhe jo vetëm; 5) profesionistë të fushës së financës, por jo vetëm, rezultojnë gjithashtu të jenë të përfshirë në veprimet e kundërligjshme, veçanërisht në drejtim të pastrimit të produkteve të veprës penale; 6) përfaqësues të nivelit të lartë në organet kushtetuese të karakterit legjislativ rezultojnë të përfshirë dhe të akuzuar, për pasojë, në prishje provash, në interes ekskluziv të kërkuesit dhe të bashkëshortes së tij; 7) punonjës të nivelit të lartë të administratës bashkiake, në varësi të drejtpërdrejtë të kërkuesit, të cilët ishin në detyrë dhe vijuan dhe më pas të ushtronin funksionet e tyre, provohet të kenë marrë kontakt me personat e thirrur si deklarues gjatë hetimit paraprak, me qëllim manipulimin e dëshmive të kërkuara nga organi procedues; 8) persona të afërt me kërkuesin kanë dëshmuar se kanë pranuar të nënshkruajnë aktmarrëveshje me përmbajtje të rreme për të justifikuar *post factum* shuma të hollash të siguruara nga burime të paligjshme. Persona të tjerë kanë pranuar se u është kërkuar dhe kanë fshirë të gjitha mesazhet telefonike që kanë pasur me bashkëshorten e kërkuesit, e bashkëpandehur në proces penal. Gjithashtu, ky i fundit ka paraqitur si provë një dokument shkresor me përmbajtje gjithashtu të rreme, për të mbuluar burimin e paligjshëm të pasurisë të llojit “vilë”, të ndodhur në Qerret, aktualisht nën sekuestro preventive.

13. Faktet e mësipërme, të cilat janë pasqyruar edhe në vendimet e gjykatave të zakonshme, përfshirë Gjykatën e Lartë, që ka bërë të vetin arsyetimin e gjykatave më të ulëta, në këndvështrimin e pakicës argumentojnë mjaftueshëm në aspektin kushtetues proporcionalitetin e masës së sigurimit të caktuar, duke individualizuar po mjaftueshëm nevojat e sigurimit në raport me sjelljen e dyshuar të kërkuesit apo të personave të lidhur ose të influencuar nga ai, në raport me nevojat e procedimit penal. Gjykatat e posaçme dhe Gjykata e Lartë kanë verifikuar dhe arsyetuar në mënyrë konkrete faktin që nevojat e sigurimit nuk mund të plotësoheshin nga masa

më të lehta sigurimi, duke argumentuar edhe se përse masa më e rëndë ishte e vetmja që plotësonte nevojat e sigurimit, referuar dinamikës së hetimit penal dhe rrethanave konkrete të pasqyruara dhe të provuara nga organi i akuzës. Në lidhje me arsyetimin në detaje nga gjykatat e zakonshme edhe Gjykata, në paragrafin 91 të vendimit, pranon se: “[...] Nga arsyetimi i vendimeve të gjykatave të zakonshme rezulton se dyshimi i arsyeshëm nuk është mbështetur në vlerësime të përgjithshme ose abstrakte, por në të dhëna, informacione dhe akte konkrete të administruara në atë fazë të procedimit, të cilat, në tërësinë e tyre, janë vlerësuar si të mjaftueshme për të krijuar një lidhje objektive midis kërkuesit dhe veprave penale për të cilat dyshohet. Gjykata nuk zëvendëson gjykatat e zakonshme në çmuarjen e provave dhe as nuk shprehet për fajësinë ose pafajësinë e kërkuesit, por verifikon nëse përfundimi i tyre për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm është haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar. Në rastin konkret, pavarësisht pretendimeve të kërkuesit për mënyrën e krijimit dhe përdorimit të bazës provuese, nuk rezulton që gjykatat e zakonshme të kenë vendosur masën e sigurimit në mungesë të çdo baze faktike ose mbi dyshime thjesht hipotetike. Gjykata vlerëson se në çështjen penale ndaj kërkuesit duket se ka informacione që do të bindnin një vëzhgues të paanshëm se ai mund të ketë kryer veprat penale për të cilat është i dyshuar, ndaj nuk mund të konkludohet se ai është arrestuar në mungesë të dyshimit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 27, paragrafi 2, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenit 5, pika 1, shkronja “c”, të KEDNJ-së. Arsyetimi i gjykatave të zakonshme në këtë drejtim nuk është abstrakt, por ato gjykata kanë shpjeguar në mënyrë konkrete dhe të mjaftueshme praninë e kriterëve dhe kushteve që lejojnë kufizimin e lirisë personale.”.

14. Përveç sa më sipër, pakica vlerëson se proporcionaliteti i ndërhyrjes në rastin konkret, për sa i përket së drejtës për t’u zgjedhur të kërkuesit, në mungesë të imunitetit kushtetues për funksionin e kryetarit të bashkisë, ka respektuar dhe garantuar në mënyrë të ekuilibruar nevojën e mbrojtjes së ecurisë konform ligjit të procedimit penal, me atë të ushtrimit të detyrës nga kryetari i bashkisë me integritet, transparencë dhe përgjegjësi. Vërtet i zgjedhuri ka detyrimin e përfaqësimit real të zgjedhësve dhe mandatin e besuar nga zgjedhësit është i detyruar ta ushtrojë realisht (shih vendimin nr. 4, datë 23.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese), por kjo nuk i jep imunitet nga masat shtrënguese penale, sidomos kur ato caktohen për shkak të dyshimeve të arsyeshme për abuzimin me detyrën, në përmasa të mëdha. Funkzionari publik i emëruar ose i zgjedhur, mbart edhe detyrimin e ushtrimit të funksioneve të tij publike me integritet profesional dhe moral, si një

element i qenësishëm që ndikon në ushtrimin korrekt të tyre dhe rritjen e besimit publik. Ndërsa Kushtetuta ka parashikuar një regjim imunitetesh të zbatueshëm ndaj disa funksionarëve publikë, duke u dhënë atyre, për shkak të funksioneve të rëndësishme shtetërore që kryejnë, mbrojtje të veçantë ligjore, organet e qeverisjes vendore nuk gëzojnë një imunitet të tillë kushtetues të paprekshmërisë nga ndjekja penale ose arrestimi dhe as nuk barazohen me funksionarë të tjerë publikë për të cilët është i zbatueshëm ky regjim. Megjithatë, edhe imuniteti nuk ka për qëllim që t'u garantojë këtyre funksionarëve paprekshmërinë, por synon, nga njëra anë, të garantojë ushtrimin e qetë dhe të pandikuar të funksioneve të rëndësishme publike dhe, nga tjetër, të garantojë përgjegjshmërinë e tyre nëse në përfundim të verifikimeve përkatëse dhe një procesi të rregullt ligjor, rezulton se veprimet e tyre janë të motivuara nga interesi privat ose keqbesimi (*shih vendimet nr. 1, datë 17.01.2025; nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Vetëm fakti që kërkuesi vazhdon të jetë *de jure* në detyrë si kryetar i Bashkisë së Tiranës, për shkak të shfuqizimit nga Gjykata të VKM-së nr. 539/2025 që kishte vendosur shkarkimin e tij nga detyra për mosparaqitje në detyrë si pasojë e pamundësisë së shkaktuar nga zbatimi i masës së sigurimit “Arresti në burg”, nuk përbën premisë kushtetuese për të vënë në dyshim vendimet gjyqësore që kanë caktuar dhe lejuar zbatimin e kësaj mase, në rast se nuk konstatohet mungesa e arsytimit nga gjykatat e zakonshme në drejtim të ekzistencës së kushteve dhe të kriterëve për kufizimin e lirisë në rastin konkret. Kërkuesi përgjigjet dhe është i barabartë para ligjit, njësoj si çdo qytetar tjetër, të cilit mund t'i cenohet punësimi ose të drejta të tjera të njohura në dispozita të veçanta kushtetuese, për shkak të caktimit ndaj tij/saj të një mase të justifikuar sigurimi personal “Arresti në burg”, kur kjo masë është e nevojshme në një shoqëri demokratike për garantimin e nevojave të sigurimit në procesin penal. Funkcioni publik, edhe në ato raste kur është i veshur me imunitet, nuk mund të jetë garanci për paprekshmëri. Edhe vetë regjimi i imunitetit nuk përbën privilegj personal, por një garanci funksionale që synon të sigurojë ushtrimin e lirë dhe të pavarur të detyrës publike, në ato raste kur ka dyshime të arsyeshme se procedimi penal është i motivuar politikisht. Ai nuk përbën dhe nuk mund të interpretohet si një mburojë ndaj zbatimit të ligjit penal, pasi çdo funksionar publik, sikundër çdo individ tjetër, mbetet subjekt i përgjegjësisë penale dhe është i detyruar t'u nënshtrohet rregullave dhe sanksioneve penale përpara organeve kompetente në rast të kryerjes së një vepre penale.

16. Për më tepër, në rastin konkret, kërkuesi është akuzuar pikërisht për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, të parashikuara përkatësisht nga nenet 260 e 25 dhe 287, paragrafi i dytë, të KP-së, gjatë dhe për shkak të ushtrimit të detyrës së tij si kryetar i Bashkisë së Tiranës. Asnjë indicie nuk është parashtruar se procedimi penal ndaj tij është bërë për motive të dyshuara si politike, në dallim nga shtysat që sollën hartimin e Raportit të Komisionit të Venecias CDL-AD(2025)045, datë 24.10.2025 “Për ndikimin e paraburgimit të kryetarëve të bashkive në ushtrimin e qeverisjes demokratike vendore”. Siç u përmend edhe më sipër, sipas pretendimeve të Prokurorisë së Posaçme dhe vlerësimit të gjykatave të zakonshme (organe këto apolitike), kërkuesi si *modus operandi* dyshohet se kishte ushtruar autoritetin publik në fushën e dhënies së fondeve publike, por edhe të lejeve të ndërtimit në këmbim të përfitimeve të parregullta. Siç është përmendur edhe më sipër, në vendimet e gjykatave të zakonshme është arsyetuar se ka lindur dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se kërkuesi dhe bashkëshortja e tij kanë kryer në bashkëpunim veprime të kundërligjshme që konsistojnë në marrjen e përfitimeve të parregullta në disa episode të veçanta, në formë shumash monetare dhe pasurish të paluajtshme nga shtetas ose subjekte tregtare, të cilët kanë pasur interesa të drejtpërdrejta financiarë në Bashkinë e Tiranës, duke evidentuar episodet të cilave u referohen, si dhe faktet penale që kanë rezultuar deri në atë fazë të hetimeve. Përveç këtyre përfitimeve, ka lindur edhe dyshimi se pasuritë e përfituara nga kërkuesi dhe bashkëshortja e tij janë fshehur dhe nuk janë deklaruar rregullisht. Sipas gjykatave, duke mbajtur në konsideratë mekanizmin e dyshuar që kërkuesi ka ideuar së bashku me bashkëshorten, i vënë në funksion dhe zbatuar për një kohë të gjatë, sa më tepër që të qëndrojnë pa masën e sigurimit “Arresti në burg”, aq më i madh është rreziku që të kryejë krime të rënda, të të njëjtit lloj me ato për të cilat po procedohet, të cilat dyshohet se janë kryer pikërisht për shkak të detyrës. Gjykata nuk ka marrë argumente bindëse nga ana e kërkuesit që të zbehin faktet që kanë konstatuar gjykatat e zakonshme, ndaj nuk mund të gjejë shkelje të ndonjë të drejte kushtetuese të kërkuesit, në drejtim të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë.

17. Po kështu, gjykatat e zakonshme kanë mbajtur parasysht edhe faktin se ushtrimi i funksionit publik nga kërkuesi nëse lihet pa masën e sigurimit “Arresti në burg”, në situatën që ai vijon të jetë kryetar i Bashkisë së Tiranës, përbën rrezik dhe dyshim të arsyeshëm që ai të mund të

vijojë të abuzojë me detyrën në të njëjtën mënyrë. Nga ana tjetër, gjykatat, për të njëjtën arsye, kanë marrë në konsideratë rrezikun që kthimi i kërkuesit në detyrë në rast të caktimit të një mase më të butë ose procedimit të tij në liri mund të ketë në drejtim të provave, për shkak të aksesit të tij në provat dokument dhe mundësisë së ndikimit të dëshmitarët e akuzës dhe integritetin e këtyre provave. Këto dyshime janë përforcuar gjatë gjykimit të zhvilluar në apel, mbi bazën e provave të depozituara nga Prokuroria e Posaçme. Mbi këto argumente, gjykatat e faktit kanë arritur në të njëjtin përfundim se asnjë masë tjetër sigurimi nuk do të ishte e përshtatshme për të garantuar nevojat e sigurimit, në rastin konkret. Gjykata e Lartë, duke u pajtuar me arsyet e detajuara të gjykatave më të ulëta, nuk është e qartë se çfarë duhet të arsyetojë domosdoshmërisht më shumë në këtë drejtim, për sa i përket caktimit fillestar të masës së sigurimit ndaj kërkuesit.

18. Edhe pse masa e arrestit ka sjellë pasojë në ushtrimin efektiv të mandatit nga kërkuesi, kjo nuk është arsye e mjaftueshme kushtetuese për të vënë në dyshim vendimet gjyqësore objekt ankimi kushtetues dhe për të lënë mënjanë parimin kushtetues të barazisë përpara ligjit. Kjo rrethanë nuk është e aftë në vetvete që të përjashtojë *apriori* mundësinë e caktimit të një mase sigurimi siç është “Arresti në burg”, nëse kjo masë argumentohet se synon të përmbushë qëllimin legjitim të procedimit penal dhe justifikohet nga nevojat konkrete të sigurimit. Siç u tha edhe më sipër, gjykatat e zakonshme, në mënyrë të individualizuar dhe jo abstrakte, kanë treguar në vendimet e tyre ekzistencën e rrezikut që kërkuesi, nëse lihej i lirë, mund të kryejë të njëjtat vepra penale, duke pasur parasysh natyrën e atyre për të cilat është akuzuar dhe *modus operandi* të skemës së dyshuar dhe kohëzgjatjen e saj. Po kështu, ato kanë treguar edhe se rreziku për provat është i lidhur me funksionin e kërkuesit si kryetar i Bashkisë së Tiranës dhe faktin së një pjesë e dëshmitarëve janë vartës të tij, si dhe sjelljen e pretenduar pas arrestimit. Ndaj duket i arsyeshëm prapësimi i Prokurorisë së Posaçme në gjykimin kushtetues se rreziku i pengimit të drejtësisë është argumentuar me tentativat e kërkuesit dhe rrethit të tij të afërt për ndikim të dëshmitarët dhe shkatërrimin, fshehjen ose fabrikimin e provave dhe akteve shkresore, si dhe se është provuar se kërkuesi ka kapacitet real për ndikim në hetimin paraprak, pasi disponon burime financiare të konsiderueshme, rrjete ndikimi të fuqishme me kapacitet të plotë funksional, si dhe aftësi për koordinim veprimesh edhe pas arrestimit dhe izolimit. Në lidhje me këtë, përbën fakt të njohur publik edhe tubimi i tensionuar përpara Gjykatës së Posaçme me rastin e marrjes në pyetje të kërkuesit në atë gjykatë, si dhe fushata publike-mediatike targetuese ndaj funksionarëve të

drejtësisë të caktuar sipas ligjit për hetimin dhe gjykimin e çështjes, çka minimalisht në vlerësimin e pakicës nuk zbut nevojat e sigurimit në kuadër të gjykimin kushtetues, për sa i përket parimit të proporcionalitetit të lidhur edhe me të drejtën për t'u zgjedhur.

19. Po kështu, gjykatat e zakonshme nuk janë mbështetur vetëm në ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, por kanë identifikuar edhe nevoja të tjera sigurimi, të lidhura me rrezikun për marrjen ose vërtetësinë e provës, rrezikun e largimit dhe rrezikun e kryerjes së veprave të tjera penale po aq të rënda apo më të rënda, të cilat janë argumentuar konkretisht dhe në mënyrë të individualizuar. Rreziku në vetvete nuk nënkupton se fakti ka ndodhur, dokumentohet si i tillë dhe i paraqitet gjykatës, por se mund të ndodhë me probabilitet të lartë, bazuar mbi të dhënat që ka në dispozicion organi i procedimit. Duhet theksuar se gjykatat e zakonshme, e veçanërisht ato të faktit, janë në pozitë më të mirë se Gjykata për vlerësimin e rreziqeve që justifikojnë caktimin e masave të sigurimit. Gjykatat e zakonshme kanë mbajtur në konsideratë natyrën dhe mënyrën e dyshuar të kryerjes së veprave penale, kohëzgjatjen dhe kompleksitetin e skemës së pretenduar, pozitën publike të kërkuesit, lidhjen e kësaj pozite me mundësinë për të ndikuar mbi persona ose dokumente që mund të shërbenin si burime prove, si dhe sjelljen konkrete të tij pas caktimit të masës, elemente këto që janë vlerësuar se provojnë ekzistencën e rrezikut për mbarëvajtjen e procedimit penal.

20. Edhe Gjykata e Lartë, në situatën që, për më tepër, nuk janë evidentuar edhe qëndrime diametralisht të kundërta të gjykatave të faktit, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit, për atë pjesë që ka qenë e argumentuar dhe relevante për objektin e ankimit, ka vlerësuar se ato janë të pabazuara, duke u dhënë përgjigje të mjaftueshme dhe të individualizuar pretendimeve të kërkuesit që lidhet me ekzistencën e kushteve dhe të kriterëve që lejojnë kufizimin e lirisë, ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, proporcionalitetin e ndërhyrjes, nevojën për vazhdimin e saj, si dhe papërshtatshmërinë e masave të tjera më të buta. Edhe pse ajo gjykatë nuk është ndalur në mënyrë të shprehur në pretendimin për cenimin e së drejtës së kërkuesit për t'u zgjedhur e cila përfshin edhe ushtrimin efektiv të mandatit si kryetar i Bashkisë së Tiranës (për shkak edhe të mosargumentimit sa duhet nga ana e kërkuesit në lidhje me të), arsyetimi në drejtim të ligjshmërisë së masës dhe ekzistencës së kriterëve dhe kushteve që lejojnë caktimin dhe vazhdimin e saj konsiderohet se plotëson kërkesën kushtetuese për një vendim të arsyetuar. Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë e ligjit, ka verifikuar mënyrën e zbatimit të ligjit procedural

nga gjykatat më të ulëta, në funksion të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese që garantojnë lirinë personale, pa qenë e nevojshme analiza e detajuar e faktorit që ka të bëjë me detyrën publike të kërkuesit, e cila është e parëndësishme dhe pa ndikim në raport me zbutjen e nevojave të sigurimit. Madje, përkundrazi, gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar se veprat penale lidhen me detyrën e kërkuesit dhe ekziston rreziku që ai të kryejë të njëjtat vepra apo më të rënda, nëse ndaj tij nuk caktohet masa “Arresti në burg”, sipas nenit 238 të KPP-së. Në aspektin kushtetues, gjykatat e zakonshme kanë treguar kujdesin e shtuar dhe të nevojshëm për arsyetimin e vendimmarrjes së tyre, ndaj në drejtim të arsyetimit nuk mund të cenohej vendimmarrja e tyre.

21. Gjykata ka theksuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 3, datë 21.01.2025; nr. 50, datë 20.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata ka pohuar, gjithashtu, në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyt atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Për sa më sipër, në vlerësimin tim të pakicës, vendimi i Gjykatës së Lartë përmbush dhe tejkalon standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor, për sa kohë rezulton të ketë dhënë përgjigje të mjaftueshme dhe të individualizuar për pretendimet thelbësore të kërkuesit që lidhen me ligjshmërinë e masës së sigurimit dhe proporcionalitetin e saj, në rrethanat konkrete të kësaj çështjeje. Mosdhënia përgjigje e detajuar nga ajo gjykatë e çdo aspekti ose grup fjalësh të paargumentuara, të shkruar në rekurs, nuk cenon të drejtën e aksesit efektiv në Gjykatën e Lartë dhe standardin e arsyetimit të vendimit, sidomos kur nuk preket ndonjë regjim imuniteti i parashikuar në Kushtetutë. Duke pasur parasysh se veprat penale për të cilat dyshohet kërkuesi, janë të lidhura ngushtë me funksionin publik, në kuptimin e dyshimit të keqpërdorimit të tij dhe se arsyeja e paraburgimit lidhet, ndër të tjera, me rrezikun e ushtrimit të ndikimit në prishjen e provave të gjalla ose dokumentare dhe kryerjen e veprave të njëjta penale apo më të rënda, është e qartë se gjykatat e zakonshme kanë analizuar me vëmendje të posaçme dhe të shtuar kushtet dhe kriteret ligjore për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” edhe për shkak të pasjes së qartë të pasojave të mundshme të nënkuptuara, që lidhen me ushtrimin efektiv të funksionit të zgjedhur të kërkuesit si kryetar i Bashkisë së Tiranës, e cila është bashkia kryesore e Republikës së Shqipërisë, si bashkia e kryeqytetit.

24. Në këto kushte, brenda kufijve të kontrollit kushtetues të vendimeve objekt ankimi, nuk rezulton që Gjykata e Lartë, në ushtrimin e funksionit të saj dhe në këndvështrim të të drejtave kushtetuese të zbatueshme, të mos ketë dhënë arsye relevante dhe të mjaftueshme në vendimin e saj në drejtim të pabazueshmërisë së shkaqeve të rekursit, pra që të mos ketë respektuar standardet e një vendimi të arsyetuar, siç kërkohet në të tilla raste.

25. Në përfundim, për sa më sipër, jam i qëndrimit se pretendimet e kërkuesit për cenimin e dinjitetit dhe të lirisë personale në aspektin substancial, në drejtim të proporcionalitetit të ndërhyrjes të lidhur me të drejtën për t`u zgjedhur, por edhe në drejtim të arsyetimit të individualizuar të nevojave të sigurimit nga Gjykata e Lartë, janë të pabazuara, ndaj kërkesa duhej të ishte rrëzuar.

Anëtar: Asim Vokshi

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Erion Veliaj, me objekt kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të posaçme që kanë caktuar dhe lejuar vazhdimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj tij, unë, gjyqtarja Marsida Xhaferllari, kam votuar për rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore dhe konstatimin e cenimit të dinjitetit të kërkuesit për shkak të mbajtjes së tij të izoluar në kabinën e xhamit. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të Ligjit Organik të Gjykatës, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar, parashtoj në vijim qëndrimin tim.

a) Për kërkimin për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore

2. Për sa i përket kërkimit për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, kam mbajtur qëndrim të ndryshëm nga shumica, e cila ka vendosur shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë për shkak të mungesës së arsytimit të pretendimit të kërkuesit të ngritur në rekurs për cenimin e proporcionalitetit të masës së sigurimit “Arresti në burg” të lidhur edhe me të drejtën për t’u zgjedhur. Në lidhje me këtë pretendim, ndaj të njëjtin qëndrim me gjyqtarin Asim Vokshi, sipas të cilit ky pretendim, në mënyrë të përmbledhur, nuk ishte i bazuar për tri arsye kryesore.

3. *Së pari*, argumenti i kërkuesit se gjykatat e zakonshme, nëpërmjet caktimit të masës “Arresti në burg” kanë realizuar *de facto* pezullimin e tij nga detyra e kryetarit të bashkisë në kundërshtim me nenin 242 të KPP-së, nuk duhej të merrej në shqyrtim nga Gjykata. Ky pretendim nuk është ngritur përpara gjykatave të posaçme, megjithëse lidhet drejtpërdrejt me interpretimin dhe harmonizimin e dispozitave të KPP-së, funksion që, sipas rendit kushtetues, u përket në radhë të parë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohej Gjykatës me këtë pretendim.

4. *Së dyti*, prokuroria, fillimisht, dhe gjykatat, në vijim, kanë dhënë një arsyetim të detajuar dhe të individualizuar, të mbështetur në faktet dhe rrethanat konkrete të çështjes, që justifikonin caktimin dhe vazhdimin e masës së arrestit në burg në raport me rrezikshmërinë e veprës penale dhe të autorit. Ky vlerësim është bazuar në mënyrën e kryerjes së veprës, në të dhënat që lidhen

me personin e kërkuesit dhe në elementet konkrete që tregonin ekzistencën e rrezikut procedural, veçanërisht rrezikun e vazhdimit të veprimtarisë kriminale.

5. *Së treti*, nuk mund të thuhet se gjykatat e zakonshme nuk kanë analizuar edhe ndikimin e masës “Arresti në burg” mbi ushtrimin e detyrës së kërkuesit si kryetar i Bashkisë së Tiranës. Duke pasur parasysh se veprat penale për të cilat ai dyshohet lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e funksionit publik, në kuptimin e keqpërdorimit të tij dhe se një nga arsyet kryesore të caktimit të paraburgimit ishte rreziku i vazhdimit të veprimtarisë kriminale, gjykatat kanë kryer balancimin që kërkon edhe standardi i cituar nga shumica, referuar raportit të Komisionit të Venecias, sipas të cilit paraburgimi dhe pezullimi i përkohshëm i përfaqësuesve vendorë të zgjedhur në mënyrë demokratike, përfshirë kryetarët e bashkive, duhet të trajtohen me kujdes të veçantë (*shih paragrafin 107 të vendimit*). Në rrethanat konkrete të çështjes, nevoja për mbrojtjen e interesit publik dhe për shmangien e rrezikut të vazhdimit të veprës penale mbizotëron ndaj interesit të kërkuesit për të ushtruar mandatin e tij zgjedhor. Për rrjedhojë, nuk mund të thuhet se proporcionaliteti i masës së sigurimit në raport me të drejtën e kërkuesit për t’u zgjedhur nuk është marrë në konsideratë apo nuk është arsyetuar.

b) Për pretendimin për cenimin e dinjitetit

6. Në lidhje me pretendimin për cenimin e dinjitetit, kam mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga shumica, jo për sa i përket rezultatit, por për sa i takon shkakut kushtetues mbi të cilin ai mbështetet. Shumica, ashtu si për pretendimin për cenimin e parimit të proporcionalitetit të lidhur edhe me të drejtën për t’u zgjedhur, ka vendosur pranimin edhe të këtij pretendimi për shkak të mungesës së arsyetimit nga Gjykata e Lartë, me pasojë shfuqizimin e atij vendimi. Në vlerësimin tim, ky pretendim është i bazuar në themel jo për shkak të mënyrës sesi gjykatat e kanë trajtuar apo dhënë përgjigje këtij pretendimi, por për shkak të mënyrës sesi gjykatat e kanë trajtuar kërkuesin gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore përpara tyre. Megjithatë, edhe pse jam e qëndrimit se kjo sjellje e autoriteteve përbën shkelje të nivelit kushtetues, sërish jam e qëndrimit se shkelja nuk ishte e tillë që të justifikonte shfuqizimin e vendimeve gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit, për sa kohë këto vendime janë marrë në përputhje me garancitë procedurale dhe substanciale që nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës parashikojnë për kufizimin e lirisë personale. Në

këto rrethana, shkelja e dinjitetit kërkonte konstatim si e tillë, por jo cenimin e vlefshmërisë kushtetuese të vendimeve që kanë caktuar dhe vleftësuar masën e sigurimit.

7. Fillimisht, vlerësoj se, në përputhje me juridiksionin e saj kushtetues, Gjykata duhej ta kishte shqyrtuar këtë pretendim në themel, duke vlerësuar vetë nëse mbajtja e kërkuesit të izoluar në një vend të posaçëm (kabina e xhamit) gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore përbënte cenim të dinjitetit të tij. Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, për shkak të mungesës së arsytimit të atij vendimi në këtë drejtim, përfaqëson një qasje formaliste, e cila rrezikon ta zhveshë ankimin kushtetues individual nga efektiviteti i tij praktik. Në rrethanat e rastit, Gjykata dispononte të gjitha elementet e nevojshme faktike dhe juridike për të ushtruar kontrollin e saj kushtetues dhe për të kryer vetë testin e nevojshëm, me qëllim që të përcaktonte nëse mënyra e vendosjes fizike të kërkuesit në sallën e gjyqit ishte në përputhje me garancitë kushtetuese që burojnë nga mbrojtja e dinjitetit njerëzor.

8. Megjithëse i jam bashkuar shumicës në përfundimin se mbajtja e kërkuesit në kabinën e xhamit nuk ka cenuar të drejtën e tij për mbrojtje efektive, për sa kohë nuk rezultoi se ai ishte penguar të komunikonte me mbrojtësin, t'i jepte atij udhëzime ose të ushtronte personalisht të drejtën e mbrojtjes përpara gjykatës, vlerësimi kushtetues për cenimin e dinjitetit ndjek një standard të ndryshëm dhe më rigoroz. Kjo për shkak se dinjiteti njerëzor përbën një vlerë themelore kushtetuese, mbrojtja e së cilës nuk kushtëzohet nga ekzistenca ose jo e një ndikimi mbi efektivitetin e mbrojtjes procedurale. Për rrjedhojë, fakti që e drejta e mbrojtjes nuk është cenuar nuk përjashton nevojën për të shqyrtuar në mënyrë autonome nëse mënyra e trajtimit të kërkuesit në sallën e gjyqit ka respektuar standardet kushtetuese të mbrojtjes së dinjitetit njerëzor.

9. Dinjiteti i njeriut, si një nga vlerat themelore dhe absolute të sanksionuara në Preambulën dhe në nenin 3 të Kushtetutës, përbën bazën e çdo të drejte dhe lirie kushtetuese. Ai qëndron në themel edhe të garancive dhe rregullave të legjislacionit procedural penal, duke shërbyer si parim udhëheqës për interpretimin dhe zbatimin e tyre në çdo fazë të procedimit penal, përfshirë zhvillimin e procesit gjyqësor.

10. Në këtë kuptim, neni 344, pika 1, i KPP-së parashikon se i pandehuri merr pjesë në seancën gjyqësore si person i lirë, edhe kur ndodhet në paraburgim, përveç rasteve kur është e domosdoshme marrja e masave për të parandaluar rrezikun e ikjes ose të ushtrimit të dhunës. Kjo dispozitë vendos si rregull pjesëmarrjen e të pandehurit në kushte që respektojnë dinjitetin e tij,

pranë mbrojtësit dhe pa kufizime fizike, ndërsa izolimi ose masa të tjera kufizuese lejohen vetëm si përjashtim dhe në prani të rrethanave konkrete që i bëjnë ato të domosdoshme.

11. Për rrjedhojë, edhe në rastet përjashtimore, ekzistenca e rrezikut që justifikon izolimin e të pandehurit në sallën e gjyqit nuk mund të prezumohet. Ajo duhet të identifikohet, të verifikohet dhe të argumentohet mbi bazën e rrethanave konkrete të çështjes nga prokurori dhe të vlerësohet nga gjykata, e cila ka detyrimin të arsyetojë se përse një masë e tillë është e domosdoshme dhe proporcionale për arritjen e qëllimit të saj. Vetëm në këtë mënyrë mund të konsiderohet i justifikuar kufizimi i dinjitetit dhe i lirisë të të pandehurit brenda sallës së gjyqit.

12. Në këtë drejtim, duhet theksuar se rreziku i ikjes i parashikuar nga neni 344, pika 1, i KPP-së është konceptualisht i ndryshëm nga rreziku i ikjes që justifikon caktimin e një mase sigurimi personal sipas nenit 228, pika 3, shkronja "b", të po këtij kodi. Ndërsa ky i fundit lidhet me nevojën për të siguruar praninë e personit gjatë procedimit penal, rreziku i parashikuar nga neni 344 i KPP-së ka të bëjë me sigurinë dhe mbarëvajtjen e zhvillimit të seancës gjyqësore dhe, për këtë arsye, kërkon një vlerësim autonom e konkret nga gjykata.

13. Në rastin konkret, rezulton se, në seancën e datës 11.03.2025 përpara GJKKO-së së Apelit, mbrojtësit e kërkuarit, gjatë parashtrimit të kërkesave paraprake, kërkuar që ai të mos mbahej i izoluar në kabinën e xhamit, por të qëndronte pranë mbrojtësve të tij. Në mbështetje të kësaj kërkesë, ata argumentuan, ndër të tjera, se një trajtim i tillë binte ndesh me dinjitetin e personit dhe me standardet e vendosura nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, duke kërkuar njëkohësisht heqjen dorë nga kjo praktikë e ndjekur nga gjykatat e posaçme.

14. Kjo kërkesë u rrëzua nga GJKKO-ja e Apelit me arsyetimin se mbajtja e të pandehurve në kabinën e xhamit përbënte praktikën e ndjekur nga gjykatat e posaçme dhe lidhej me infrastrukturën e godinës. Nga ky arsyetim rezulton se ajo gjykatë (e apelit) jo vetëm që nuk ka verifikuar ekzistencën e ndonjëres prej rrethanave përjashtimore të parashikuara nga neni 344, pika 1, i KPP-së, të cilat do të mund të justifikonin izolimin e kërkuarit gjatë seancës gjyqësore, por e ka bazuar vendimmarrjen në konsiderata të natyrës organizative dhe rutinore. Një arsyetim i tillë është i papajtuashëm me kërkesat kushtetuese për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, pasi një praktikë e konsoliduar administrative ose veçoritë infrastrukturore të godinës nuk mund të zëvendësojnë detyrimin e gjykatës për të kryer një vlerësim konkret, individual dhe të arsyetuar mbi domosdoshmërinë e kufizimit të të drejtave themelore të personit.

15. Për më tepër, argumenti i bazuar në infrastrukturën e gjykatës nuk qëndron. Dokumentet zyrtare të vet sistemit të drejtësisë tregojnë se godinat e gjykatave të posaçme janë projektuar pikërisht për të garantuar standarde të larta sigurie. Kështu, në Dokumentin e Analizës së Sistemit të Drejtësisë të vitit 2015 është evidentuar se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dispononte kushte të mira sigurie, të siguruara nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm me kamera të të gjitha sallave të gjyqit dhe të mjediseve të përbashkëta, pajisjeve të posaçme të mbikëqyrjes dhe sistemit të kontrollit të hyrje-daljeve⁵. Po në të njëjtën linjë, raporti i Këshillit të Lartë Gjyqësor për gjendjen e sistemit gjyqësor në vitin 2018, i hartuar në vitin 2019, evidenton investimet e kryera për ndërtimin e godinave të reja të gjykatave, përfshirë gjykatat e posaçme, duke theksuar se ndarja e zonave të publikut nga ambientet e sigurisë dhe krijimi i hyrjeve të veçanta për të pandehurit, nëpërmjet kateve të nëndheshme dhe dhomave të izolimit, janë projektuar pikërisht për të garantuar sigurinë e procesit gjyqësor⁶.

16. Në këto rrethana, siguria e sallës së gjyqit mund të garantohej nëpërmjet masave infrastrukturore dhe organizative të parashikuara për këtë qëllim, pa qenë i nevojshëm izolimi i kërkuesit në kabinën e xhamit vetëm për shkak të një praktike rutinore. Për rrjedhojë, mungesa e çdo vlerësimi konkret mbi ekzistencën e rrezikut të ikjes ose të ushtrimit të dhunës e bën të pajustificuar kufizimin e dinjitetit të kërkuesit gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore. Me fjalë të tjera, nuk ishte infrastruktura ajo që impononte mbajtjen e kërkuesit në kabinën e xhamit, përkundrazi, vetë infrastruktura e gjykatës ishte projektuar për të garantuar sigurinë e procesit gjyqësor pa pasur nevojë për një masë të tillë. Kjo e bën edhe më të dukshme se izolimi i kërkuesit nuk ishte rezultat i një domosdoshmërie konkrete dhe të provuar, por i një praktike rutinore, e cila nuk mund të justifikojë kufizimin e dinjitetit njerëzor dhe, për rrjedhojë, nuk përmbush standardin kushtetues të domosdoshmërisë dhe të proporcionalitetit që kërkohet për çdo kufizim të të drejtave themelore.

17. Në të njëjtën linjë, rezulton se edhe Këshilli i Ministrave ka miratuar akte nënligjore të posaçme për garantimin e sigurisë në institucionet e drejtësisë së posaçme. Kështu, me vendimin nr. 479, datë 10.07.2019 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për procedurat në lidhje me

⁵ Shih dokumentin “Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri”, qershor 2015, faqet 305-306, https://www.reformanedrejtesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf

⁶ Shih dokumentin “Raport mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018”, maj 2019, faqet 46-47, <https://klgj.al/media/y0bgrw1p/raporti-vjetor-klgj-2018-shqip-version-perfundimtar.pdf>

garantimin e sigurisë në mjediset e Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të Prokurorisë së Posaçme dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit”, janë përcaktuar procedurat dhe masat konkrete për garantimin e sigurisë në këto institucione. Po kështu, në zbatim të vendimit nr. 507, datë 27.07.2022, që ndryshon vendimin nr. 597, datë 13.10.2021, “Për përcaktimin e personaliteteve dhe objekteve të tjera, që ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë”, ruajtja dhe mbrojtja e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar i është ngarkuar Gardës së Republikës.

18. Ekzistenca e këtij kuadri të posaçëm ligjor dhe institucional konfirmon se siguria e gjykatave të posaçme garantohet nëpërmjet mekanizmave të dedikuar të organizimit, administrimit dhe mbrojtjes fizike të tyre. Për rrjedhojë, nevoja për të izoluar një të pandehur në kabinën e xhamit gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore nuk mund të prezumohet mbi bazën e kërkesave të përgjithshme të sigurisë së institucionit, por duhet të mbështetet në rrethana konkrete të lidhura me sjelljen dhe me rrezikshmërinë e personit në fjalë, të identifikuar dhe të arsyetuara nga gjykata në secilin rast.

19. Në kuptim të sa më sipër, sa herë që vihet në diskutim zbatimi i rasteve përjashtimore të parashikuara nga neni 344, pika 1, i KPP-së, gjykatat e zakonshme kanë detyrimin të kryejnë një vlerësim të individualizuar. Fillimisht, ato duhet të verifikojnë nëse ekziston një rrezik konkret dhe aktual i ikjes nga salla e gjyqit, i ushtrimit të dhunës ose çdo rrethanë tjetër specifike që mund të cenojë sigurinë dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor. Vetëm konstatimi i një rreziku të tillë mund të legjitimojë shqyrtimin e nevojës për marrjen e masave kufizuese. Megjithatë, edhe nëse një rrezik i tillë provohet, gjykatat nuk çlirohen nga detyrimi për të verifikuar nëse izolimi i të pandehurit në kabinën e xhamit është masë e domosdoshme dhe proporcionale në raport me qëllimin e synuar, apo nëse i njëjti qëllim mund të arrihet nëpërmjet masave të tjera më pak kufizuese për dinjitetin dhe të drejtat e tij themelore. Kjo analizë duhet të jetë konkrete, e individualizuar dhe e arsyetuar, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një kufizim të një vlere themelore kushtetuese.

20. Në rastin konkret, nuk është pretenduar dhe as nuk është verifikuar se kërkuesi paraqiste ndonjë rrezik real të ikjes, të ushtrimit të dhunës ose ndonjë rrezik tjetër për sigurinë e procesit gjyqësor. Për rrjedhojë, mbajtja e tij të izoluar në kabinën e xhamit gjatë zhvillimit të seancave në gjykatat e faktit përbën një cenim të pajustificuar të dinjitetit të kërkuesit.

21. Në këtë drejtim, vetëm fakti se ndaj kërkuesit ishte caktuar masa e sigurimit "Arresti në burg" dhe se ai gjykohej nga gjykatat e posaçme për shkak të natyrës së veprave penale për të cilat akuzohej, nuk mund të përbëjë, në vetvete, shkak të mjaftueshëm për ta mbajtur atë të izoluar gjatë seancave gjyqësore. Një qasje e tillë krijon një prezumim të përgjithshëm të rrezikshmërisë, të papajtueshëm me kërkesën për vlerësim individual të çdo rasti dhe ngre njëkohësisht shqetësime serioze edhe në këndvështrim të parimit të prezumimit të pafajësisë.

22. Theksoj se rasti i kërkuesit nuk përbën një episod të izoluar, por pasqyron një praktikë të vazhdueshme të ndjekur nga gjykatat e posaçme, e cila, për shkak edhe të publicitetit që shoqëron disa procese penale me interes të lartë publik, ka marrë një vëmendje të shtuar mediatike. Publikimi i vazhdueshëm në media i fotografive dhe pamjeve filmike të personave nën hetim ose të pandehur, të mbajtur të izoluar në kabinën e xhamit gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, e tejkalon dimensionin e thjeshtë procedural të kësaj mase dhe i shton asaj një efekt të dukshëm stigmatizues dhe poshtërues. Në këto rrethana, izolimi fizik nuk mbetet vetëm një kufizim i mënyrës së pjesëmartjes në gjykim, por shndërrohet edhe në një formë ekspozimi publik që prek dinjitetin e individit si qenie njerëzore.

23. Edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së ka theksuar se natyra publike e trajtimit përbën një element të rëndësishëm në vlerësimin nëse ai arrin pragun e trajtimit poshtërues në kuptim të nenit 3 të Konventës (*shih Tyrer kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 25.04.1978, § 32; Erdoğan Yağız kundër Turqisë, datë 06.03.2007, § 37; Kummer kundër Republikës Çeke, datë 25.07.2013, § 64*). Në situatën që ka konstatuar mungesën e ndonjë të dhëne penale ose provave të tjera që mund të përbënin arsye serioze për të pasur frikë se aplikanti mund të përdorte dhunë gjatë seancave gjyqësore, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se masat e sigurisë gjatë seancës, në atë rast konkret, nuk ishin të justifikuara nga rrethanat e çështjes dhe se ato kishin kontribuar në poshtërimin e aplikantit. Po ashtu, ajo ka marrë parasysh edhe faktin se çështja në fjalë ishte e një natyre të profilit të lartë dhe se aktet/veprimet e konstatuara ndaj kërkuesit ishin kryer, siç mund të pritej, në sytë e publikut dhe të medias (*shih Sarban kundër Moldovës, datë 04.10.2005, § 89; Mouisel kundër Francës, datë 14.11.2002, § 47*).

24. Për sa më sipër, vlerësoj se mbajtja e kërkuesit të izoluar në kabinën e xhamit gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, në mungesë të verifikimit të ndonjëres prej rrethanave përjashtimore, të parashikuara nga neni 344, pika 1, i KPP-së, përbën cenim të dinjitetit të tij.

Megjithatë, siç kam theksuar edhe më sipër, kjo shkelje nuk sjell domosdoshmërisht, si pasojë, shfuqizimin e vendimeve gjyqësore që kanë caktuar dhe lënë në fuqi masën e sigurimit personal. Për sa kohë këto vendime plotësojnë garancitë kushtetuese që lidhen me kufizimin e lirisë personale, mjete i përshtatshëm për rivendosjen e së drejtës së cenuar do të ishte konstatimi i shkeljes së dinjitetit si e drejtë kushtetuese, pa prekur vlefshmërinë e vendimeve për masën e sigurimit.

Anëtare: Marsida Xhaferllari

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Erion Veliaj, me objekt kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të posaçme që kanë caktuar dhe lejuar vazhdimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj tij, unë, gjyqtarja Marjana Semini, kam votuar për pranimin e pjesshëm të kërkesës, duke konstatuar cenimin e së drejtës së mbrojtjes efektive të kërkuesit të lidhur me mënyrën e komunikimit me avokatin e tij, për shkak të qëndrimit në kabinën e xhamit gjatë procesit gjyqësor, si dhe, për të njëjtin shkak (izolimi në kabinën e xhamit), edhe konstatimin e cenimit të dinjitetit të tij.

2. Nuk i jam bashkuar shumicës në qasjen që mbajtja e kërkuesit të izoluar në sallën e gjyqit nuk ka sjellë cenim të së drejtës së mbrojtjes efektive në gjykatë, sepse vlerësoj që një nga aspektet e ushtrimit të së drejtës së mbrojtjes efektive lidhet me komunikimin e lirshëm dhe konfidencial të avokatit me klientin e tij dhe që realizohet praktikisht përmes fjalëve dhe gjesteve, afërsisë fizike dhe simbolikës në komunikim, si dhe përmes përdorimit të toneve të përshtatshme

të zërit, të tilla që shërbejnë për t'u dëgjuar dhe kuptuar vetëm mes tyre. Izolimi në një kabinë xhami në sallën e gjyqit, gjatë procesit gjyqësor në gjykatat e faktit, kufizon afërsinë fizike dhe komunikimin konfidencial, sepse kabina prej xhami mbart premisa që të krijojë praktikisht pengesa fizike dhe vështirësi të karakterit teknik për komunikim të përshtatshëm, të afërt, të drejtpërdrejtë dhe privat.

3. Neni 31, shkronja “ç”, i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera: “ *Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: ... ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë të komunikojë lirisht dhe privatisht me të...*”. Në analizën e qëllimit të normës del e qartë se nënvizohen dy koncepte të rëndësishme: *së pari*, komunikimi “i lirshëm”, domethënë pa pengesa që krijojnë largësi fizike midis avokatit dhe klientit dhe, *së dyti*, komunikimi “privatisht”, ku përfshihet mënyra sesi dialogojnë avokati dhe klienti, mënyra e shkëmbimit të mendimeve dhe sugjerimeve, e dhënies së këshillave juridike, por jo vetëm, mënyra sesi ruhet konfidencialiteti dhe si krijohet afërsia për shkëmbimin e informacioneve në mënyrë të rezervuar midis tyre. Lehtësia dhe privatësia në komunikimin me mbrojtësin janë dy faktorë të rëndësishëm që duhet të përmbushen njëkohësisht që standardi i mbrojtjes efektive të konsiderohet i garantuar në nivel kushtetues.

4. Në kontekstin e rrethanave që lidhen me përdorimin e kabinës prej xhami, jam e mendimit se izolimi, pavarësisht mënyrës sesi është ndërtuar dhe konceptuar ajo kabinë që *prima facie* duket se lejon një transparencë në ndjekjen e procesit gjyqësor, në thelb shfaq probleme në drejtim të garantimit të respektimit të parimit të sekretit profesional mes të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, gjë që ndikon edhe në cilësinë e përfaqësimit ligjor të specializuar. Ky parim synon të lehtësojë dhe sigurojë një komunikim të hapur dhe të ndershëm mes klientit dhe avokatit të tij, duke i lejuar, nga njëra anë, klientit të jetë i hapur dhe transparent me avokatin dhe, nga ana tjetër, i mundëson avokatit që të ofrojë këshilla dhe përfaqësimin e duhur në përputhje me situatën e klientit. Pa këtë konfidencialitet mes tij dhe avokatit, i cili, për shkak të izolimit të të përfaqësuarit në sallën e gjyqit, pengohet të ushtrohet lirisht, klienti mund të hezitojë të japë informacione thelbësore për qëllime të mbrojtjes së tij, mund të bëjë deklaramë të papërshtatshme duke penguar potencialisht edhe aftësinë e avokatit për ta ndihmuar në mënyrë efektive.

5. Ndërkohë, vlen të theksoj që në çdo rast të përdorimit të kabinës së xhamit për mbajtjen e të pandehurve duhet të analizohet dhe evidentohet nga gjykata qëllimi i vendosjes në këtë lloj izolimi. Në vlerësimin tim, në këndvështrim edhe të përmbajtjes së nenit 344, pika 1, të KPP-së,

sipas të cilit i pandehuri merr pjesë në seancë si person i lirë edhe kur është i paraburgosur, me përjashtim të rasteve kur duhen marrë masa të domosdoshme për të parandaluar rrezikun e ikjes a të dhunës, izolimi në kabinën e xhamit është një mjet që ka si qëllim të lehtësojë mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit, sigurinë fizike dhe të minimizojë ose eliminojë rreziqet e pritshme gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor. Ky qëllim lidhet në mënyrë të ndërsjellë me dy skenarë të mundshëm: nga njëra anë, me rrezikun e ikjes të personit dhe, nga ana tjetër, me rrezikshmërinë që vjen nga individët që izoloohen kundrejt pjesëmarrësve ose personave të pranishëm në procesin gjyqësor dhe, anasjelltas, me rrezikshmërinë që mund t'i vijë të pandehurit nga individë që mund të jenë pjesëmarrës në gjykim ose persona të tretë që ndjekin procesin gjyqësor.

6. Në rastin konkret, objekt i këtij gjykimi kushtetues, nuk evidentohet asnjëri nga dy skenarët e mësipërm. Kërkuesi jo vetëm nuk rezulton të paraqiste rrezik ikjeje/shmangieje nga procesi gjyqësor, por as ndonjë rrezikshmëri për pjesëmarrësit në procesin gjyqësor dhe, në të njëjtën kohë, as nuk paraqitej si ndonjë viktimitë e mundshme, e cila rrezikohej nga persona të tretë të pranishëm në procesin gjyqësor. Për rrjedhojë, në parim vlerësoj se në çdo rast izolimi në kabinë xhami rrezikon të sjellë, përveç cenimit të dinjitetit dhe të prezumimit të pafajësisë, edhe cenim të së drejtës së mbrojtjes efektive, në mënyrë të veçantë duke krijuar premisa që potencialisht të ulët cilësinë e kësaj mbrojtjeje. Megjithatë, në situatën konkrete, pavarësisht vështirësive të krijuara mes kërkuesit dhe mbrojtjes për të komunikuar me njëri-tjetrin në konfidencialitet të plotë gjatë seancës gjyqësore, jam e qëndrimit se, për shkak se pasojat për uljen e cilësisë së mbrojtjes nuk janë argumentuar dhe provuar në atë nivel që të vërë në dyshim vetë thelbin e së drejtës së mbrojtjes, pra në atë nivel që ta ketë bërë praktikisht të pamundur apo inekzistente atë, për rrjedhojë edhe vetë rezultatin/përfundimin e atij gjykimi, konstatimi i cenimit të shkeljes kushtetuese do të ishte mjete i përshtatshëm për rivendosjen e së drejtës së kërkuesit për një mbrojtje efektive në drejtim të komunikimit privat me mbrojtësin e zgjedhur.

7. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit për *cenimin e dinjitetit*, unë i bashkohem qëndrimit të gjyqtarës Marsida Xhaferllari në drejtim të argumenteve të saj dhe duke shtuar se dinjiteti duhet të mbrohet për çdo qytetar pavarësisht gjendjes juridike që ndodhet. Nuk është rastësore që Kushtetuta e parashikon mbrojtjen e dinjitetit të individit nga trajtime degraduese dhe poshtëruese në disa dispozita, duke filluar me nenin 3 që sanksionon, ndër të tjera: "*Pavarësia e shtetit ... dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë*

t'i respektojë dhe t'i mbrojë", duke vijuar me nenin 25 që parashikon: "Askush nuk mund t'i nënshtrohet ... trajtimit ... poshtërujes" dhe me nenin 28, pika 5, që parashikon: "Çdo person, të cilit i është hequr liria ..., ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij". Që të kuptojmë qëllimin e këtyre dispozitave kushtetuese duhet që fillimisht të analizojmë konceptin e dinjitetit njerëzor, i cili i referohet vlerës dhe respektit të lindur që çdo person zotëron si qenie njerëzore.

8. Dinjiteti në vetvete i ka rrënjët në ndjenjën për vetërespekt, në barazinë morale dhe në të drejtën për t'u trajtuar në mënyrë etike nga të tretët. *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut* që në *Preambulën* e saj radhit të parën garancinë se "... njohja e dinjitetit të lindur dhe e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë.". Kjo nënkupton se kur nëpërkëmbet ky dinjitet vihet në rrezik themeli i vet lirisë dhe drejtësisë në shoqëri. Mbrojtja e dinjitetit është një garanci kushtetuese që i sigurohet, ndër të tjerët, edhe çdo personi që i është hequr liria. Në rastin në shqyrtim, izolimi në mënyrë të panevojshme dhe të pajustificuar i kërkuesit brenda kabinës prej xhami passjell uljen e dinjitetit të tij, duke krijuar imazhin publik të një njeriu që mbart rrezikshmëri dhe imazhin e një individi që nuk e meriton të trajtohet në mënyrë të barabartë me çdo individ tjetër brenda së njëjtës sallë, duke mos harruar që, në fund të fundit, kërkuesi prezumohet edhe i pafajshëm gjatë gjithë periudhës që zgjat një proces gjyqësor penal. Kjo mënyrë izolimi ndihmon në kultivimin e ndjenjës së pasigurisë dhe të frikës tek i pandehuri. Në këtë linjë, në vlerësimin tim, edhe për këtë shkelje, mjeti i përshtatshëm për rivendosjen e së drejtës së kërkuesit do të ishte konstatimi i cenimit të shkeljes kushtetuese.

9. Për sa i përket pretendimit për *cenimin e proporcionalitetit të masës të lidhur edhe me të drejtën për t'u zgjedhur*, unë kam mbajtur qëndrim të ndryshëm nga shumica dhe në lidhje me këtë pretendim i bashkohem qëndrimit në pakicë të mbajtur nga gjyqtari Asim Vokshi, për shkak se qasjet tona bashkohen në këtë pikë dhe bazohen mbi të njëjtat argumente të parashtruara në mendimin e tij në pakicë. Në shtesë të tyre, dua vetëm të theksoj se në drejtim të arsytimit të vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm më rezultojnë të trajtuara me kujdes të mjaftueshëm shkaqet ligjore që justifikonin caktimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit, mbështetur në dispozitat e KPP-së, si dhe në përputhje me standardin e vendosur për paraburgimin

dhe pezullimin e përkohshëm të përfaqësuesve të pushtetit vendor nga raporti i Komisionit të Venecias, të cilit i referohet shumica në paragrafin 107 të vendimit.

10. Për rrjedhojë, në vlerësimin tim përfundimtar, kërkesa e kërkuarit ishte e bazuar pjesërisht, në drejtim të *cenimit të së drejtës së mbrojtjes efektive* të lidhur me garantimin e komunikimit të kërkuarit me mbrojtësin e tij, si dhe në drejtim të *cenimit të dinjitetit njerëzor*, për shkak të izolimit të kërkuarit gjatë procesit gjyqësor në kabinën prej xhami, ndaj duhej të ishte vendosur pranimi pjesërisht i saj dhe konstatimi i cenimit të këtyre të drejtave kushtetuese.

Anëtare: Marjana Semini